




RAPORTI VJETOR 2013



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE







01 HYRJE

- 08. Profili i korporatës
- 11. Vizioni, misioni dhe strategjia jonë
- 12. Shtyllat kryesore të strategjisë dhe vlerat tona themelore
- 16. Struktura e aksionarëve
- 18. Pasqyra makroekonomike
- 22. Letër nga Kryesuesi
- 24. Nga Kryeshefi Ekzekutiv

02 TEB-I NË VITIN 2013

- 28. TEB-i në shifra
- 32. Indikatorët kyçë financiarë
- 34. Shërbimet bankare individuale
- 38. Shërbimet bankare për NVM
- 40. Shërbimet bankare komerciale dhe për korporata
- 42. Biznesi i kartelave
- 46. Financat tregtare
- 48. Menaxhimi i parasë dhe sistemet e pagesave
- 50. Thesari
- 52. Burimet njerëzore
- 56. Organizimi dhe zhvillimi i proceseve
- 58. Teknologjia informative

03 MENAXHMENTI

- 62. Bordi i drejtorëve
- 64. Komitetet
- 68. Auditimi i brendshëm, kontrolli i brendshëm, menaxhimi i rrezikut
- 72. Pajtvueshmëria

INFORMATË FINANCIARE

Raporti i pavarur i auditimit më 31 dhjetor 2013 dhe Shënimet për llogaritë financiare

Bankë për yjet në ngritje

Logoja prej katër yjeve që transformohen në zog në ngritje shpreh vlerat kryesore të grupit tonë:

Përgjigjet ekspeditive

Përkushtimi

Ambicia

Kreativiteti

Logoja është simbol i dinamizmit dhe progresit.

Përmes qasjes sonë dinamike dhe progresive, ne vazhdimisht ofrojmë zgjidhje të përshtatura (financiare) për Kosovën. Popullata e re është inspirim për ne që të zgjerojmë kufijtë duke zhvilluar produkte dhe shërbime të reja dhe relevante.

Prandaj raportin vjetor të vitit 2013 e kemi përgatitur me temë të këtyre katër vlerave kryesore që, në partneritet me bazën tonë të klientëve të re dhe në rritje, e bëjnë bankën TEB Sh.A. bankë të yjeve që ngritën.

TEB – Ylli bankar në ngritje i Kosovës Në fund të vitit tonë të gjashtë të operimit në Kosovë, ylli i TEB-it vijon të ngrihet.

Sot ne jemi një nga bankat kryesore udhëheqëse në këtë shtet, duke dëshmuar diapazonin e plotë të shërbimeve bankare dhe financiare për bizneset dhe klientët individualë. Por vizioni ynë është të kemi më shumë: ne synojmë të jemi banka më e mirë në Kosovë. Ne e arrijmë atë qëllim dhe e dallojmë bankën TEB në treg duke iu përmbajtur katër vlerave tona themelore: përgjigjet ekspeditive, përkushtimi, kreativiteti dhe ambicia. Këto vlera nuk lidhen vetëm me atë se si ju shërbejmë juve, klientëve tanë. Përmes përgjigjeve ekspeditive, kreativitetit, përkushtimit dhe ambicies, ne edhe punojmë bashkë me juve për të arritur qëllimet dhe ambiciet tuaja.

Çka bëjmë ne?

Në Kosovë ne jemi të njohur për produktet dhe shërbimet e përgjegjshme, qasjen e fokusuar të klienti, modelin afarist dinamik dhe duke marrë parasysh rrezikun, kanalet e sigurta bankare dhe përgjegjësinë sociale. Nga zyra jonë qendrore në Prishtinë dhe rrjeti i degëve në rritje, ne vazhdimisht kërkojmë mënyra të reja për të përmirësuar ofertat tona, për të ofruar shërbime më të shpejta dhe më të mira, për të avancuar marrëdhëniet tona me klientë dhe për të promovuar interesat e aksionarëve tanë.

Si e bëjmë këtë?

Si anëtare e dy grupeve të fuqishme financiare ndërkombëtare – një nga institucionet financiare më të vjetra dhe më me reputacion në Turqi, Türk Ekonomi Bankası A.Ş. (TEB) dhe banka kryesore në Evropë, BNP Paribas-, ne e përkrahim diversitetin tonë dhe shfrytëzojmë plotësisht ekspertizën globale financiare të kompanive amë për të ofruar përvojën më të mirë për klientët. Oferta jonë është krijuar për të ndihmuar që klientët të arrijnë ambiciet e tyre përmes produkteve dhe shërbimeve inovative dhe udhëheqëse në treg. Ne e kuptojmë që ju, klientët tanë, keni nevojë për më shumë sesa përvojë klienti dhe produkte standarde bankare, ofertat tona të përshtatura me kujdes janë të personalizuar për të përkrahur qëllimet tuaja. Prandaj ne nxisim frymën inovative dhe inkurajojmë kreativitetin për të thyer pikëpamjet e vjetra dhe për të menduar me kreativitet, por me kujdes të duhur.

Në TEB, synimi ynë është një kulturë korporative e karakterizuar me komunikim të hapur, të ndershëm dhe që ndërton partneritet afatgjatë me punëtorët tanë kompetentë dhe dinamikë. Ne presim nga punëtorët tanë të jenë më se të aftë. Ne kërkojmë nga ta të jenë ambiciozë kur është puna për të bërë ndryshim në jetën e klientëve tanë dhe ekonominë reale të Kosovës.

Çka përfaqësojmë ne?

Që kur është themeluar në vitin 2008, TEB ka pasur një pozicion udhëheqës në të gjitha segmentet afariste të sektorit bankar dhe financiar të Kosovës. Gjithashtu kemi arritur rritje të qëndrueshme në të gjitha aktivitetet tona. Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm se aktivitetet tona kanë ndikim te klientët, aksionarët, punëtorët, partnerët tanë afaristë dhe në shoqërinë në tërësi. Kjo është arsyeja pse ne përqijemi të ngulisim qëndrueshmërinë korporative në proceset tona afariste dhe të nxisim zhvillimin afarist për të përkrahur rritjen ekonomike. Ne jemi të përkushtuar për një kulturë të përgjegjshme bankare dhe kemi ndikim në përkrahjen e ekonomisë reale duke financuar plane të shëndosha afariste dhe projekte që përkrahin zhvillimin e një ekonomie më të qëndrueshme.

Ne vendosim theks të veçantë në mbrojtjen e mjedisit natyror dhe luftimin e ndryshimit të klimës. Ne kemi prezantuar produkte ekologjike me qëllim përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe vazhdimisht vlerësojmë ridizajnimin e mundshëm të proceseve dhe aktiviteteve tona afariste për të ulur gjurmën tonë të karbonit. Në të njëjtën kohë, ne përkrahim aktivitetet kulturore, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zbatimin e iniciativave bamirëse që i përfitojnë shoqërisë në tërësi.

Si ia dolëm më 2013?

Gjatë vitit 2013, ne kemi vazhduar të ofrojmë gamën e plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare me pasion dhe përkushtim për më se 221,000 klientët tanë. Rrjeti ynë i degëve është rritur në 26 që operohen nga 555 punonjës me orar të plotë. Klientët tanë kanë përfutuar nga qendra e thirrjeve që punon 24 orë në ditë, rrjeti inovativ elektronik bankar dhe kanalet alternative të shpërndarjes. Ne përsëri kemi krijuar zgjidhjet më të mira për klientët individualë bankarë, bizneset e vogla dhe të mesme, agrobizneset, ndërmarrësit, kompanitë e mëdha, institucionet dhe organizatat jo-fitimprurëse. Gjithashtu kemi ofruar produkte dhe shërbime, duke përfshirë menaxhimin e llogarive, biznesin e kartelave, kreditë, financimin, menaxhimin e parave të gatshme dhe sistemet e tjera të pagesave.

Deri në fund të vitit 2013, totali i mjeteve të Bankës arriti në 372.4 milion €, depozitat e klientëve kanë qenë 327.2 milion € dhe kreditë bruto ishin 283.1 milion €.

VIZIONI YNË

Të jemi banka më e mirë në Kosovë.



MISIONI YNË

Në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, nëpunësit dhe shoqërinë tonë.



STRATEGJIA JONË

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë, strategjia jonë është që të ofrojmë një përvojë të jashtëzakonshme dhe efikase bankare për të gjithë klientët tanë. Këtë do ta arrijmë duke ofruar produkte dhe shërbime inovative dhe praktike për të arritur rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Shtyllat kryesore të strategjisë dhe vlerat tona themelore

Punojmë pa ndalur sot sepse nesër duam
të na buzëqeshin fytyra të lumtura të
brezave të nesërm.



Fokusi në klientë

Suksesi ynë bazohet në një përkushtim të plotë për klientët tanë në çdo kohë, duke na sjellë besimin dhe besnikërinë e bazës sonë të klientëve.

Ne e mbajmë besimin duke i vendosur gjithmonë klientët tanë në zemër të çdo gjëje që e bëjmë. Nevojat dhe pritjet e klientëve janë shtytësit tanë përmes qasjes sonë të shpejtë dhe proaktive dhe përgjigjeve ndaj kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo na mundëson të krijojmë dhe të japim vlerën e vërtetë ndërsa u shërbejmë klientëve tanë me shërbime dhe produkte të reja, që i tejkalojnë pritjet e tyre, të përshtatura dhe të trendit të fundit.

Integriteti

Ne kemi përqafuar standardet më të larta të integritetit në çdo gjë që themi dhe e bëjmë dhe jemi të përkushtuar për të krijuar vlerë të shtuar për klientët tanë, aksionarët dhe punonjësit duke bërë gjithmonë më shumë se vetëm atë që është e drejtë.

Ne komunikojnë hapur dhe me ndershmëri, ftojmë dhe vlerësojmë pikëpamjet sfiduese që kanë për qëllim krijimin e ideve më të mira dhe marrjen e vendimeve më të përshtatshme dhe të balancuara.

Performanca e qëndrueshme dhe profitabiliteti

Ne krijojmë vlerë për aksionarët tanë përmes suksesit afatgjatë dhe jo përmes fitimit afatshkurtër.

Pra, qëllimi ynë është që biznesi jonë kryesor të ofrojë profitabilitet të shëndoshë dhe të fortë operativ dhe dividenda përmes një fryme të ndërmarrësisë që balancon rreziqet dhe kthimet me përgjegjësi.

Inovacioni

Aspiratat tona shkojnë kah inovacionet që janë me rëndësi. TEB vlerëson entuziazmin së bashku me kureshtjen intelektuale të popullit tonë ndërsa vazhdimisht synon për të krijuar produkte që do të lehtësojnë suksesin e klientëve tanë dhe të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për nevojat e tyre.

Efikasiteti në punë

Ne krijojmë procese dhe produkte që janë të lehta për përdorim, të lehta për qasje dhe të projektuara për të shtuar vlerën.

Ne përpiqemi për të siguruar që shërbimet që ofrohen për klientët tanë të jenë me çmim që barazohet në mënyrë të drejtë me koston aktuale të ofrimit të tyre.

Disiplina

Ne mendojmë dhe veprojmë si pronarë të Bankës, për të mbrojtur burimet e saj dhe për t'u përqendruar në qëllimet e përbashkëta dhe jo ato individuale.

Ne mburremi me sukseset e TEB-it dhe vlerën që krijojmë për aksionarët dhe klientët tanë. Secili nga 555 punonjësit tanë ndjehet përgjegjës në qoftë se dështojmë për të përmbushur pritjet e klientëve dhe jemi të gjithë përgjegjës për përmbushjen e premtimeve tona - nuk ka justifikime.

Ne synojmë të arrijmë përsosmëri operative duke kryer punën mirë me përpjekjen e parë.

Burimet njerëzore kompetente

Ne synojmë të forcojmë pozitën tonë si punëdhënës i zgjedhur dhe përpiqemi të krijojmë një kulturë që tërheq individë të talentuar, nxit punën ekipore bashkëpunuese ndërmjet personave të ndryshëm por prapë të përgjegjshëm dhe të shkathët, edukojmë dhe investojmë në talentet më të mira, dhe menaxhimin e bazojmë në merita dhe mundësitë e barabarta.

Partneriteti

Ne synojmë të kemi marrëdhënie të qëndrueshme dhe reciprokisht të dobishme me klientët dhe punëtorët në të cilat vlera e krijuar ndahet në mënyrë të drejtë.

Ne jemi partnerë të përgjegjshëm me të gjitha palët e interesuara dhe rregullatorët, dhe i shërbejmë shoqërisë.

Kanalet e fuqishme të shpërndarjes

Ne përpiqemi për të ofruar shërbime dhe përkrahje për klientët tanë siç iu përshtatet atyre, duke ofruar kanale të ndryshme të shpërndarjes, duke përfshirë zyrat tona të degëve, qendrën e thirrjeve, shitjet e drejtpërdrejta dhe kanalet e ndryshme alternative të shpërndarjes.

Struktura e aksionarëve



Kapitali aksionar i TEB Sh.A. është

2,400,000 aksione të emetuara

secila me vlerë nominale prej 10 € (kapitali total i paguar: 24 milion €).

Numri i aksioneve lidhet me aksionet e zakonshme pa të drejta, preferenca apo kufizime të bashkëngjitura me to.

Kapitali aksionar është paguar në para të gatshme.

Struktura e pronësisë më 31 dhjetor 2013



*50%-50% BNP Paribas Fortis Yatırımlar Holding A.Ş.and Çolakoğlu Group Joint Venture.

Pasqyra makroekonomike

Pas 18 muajsh rresht në recesion, zona e valutës së përbashkët shënoi tre tremujorë me rritje pozitive.

Gjatë vitit 2013, ekonomia botërore ka vazhduar trendin e rritjes edhe pse në nivele më të ulëta se në vitin 2012. Si rezultat i kësaj, norma e rritjes globale ishte 3.0% krahasuar me 3.1% në vitin 2012. Kjo ishte një pasojë e drejtpërdrejtë e rritjes më të ulët në vendet në zhvillim, konkretisht në Kinë dhe Indi. Kërkesa e brendshme në të dyja këto shtete ishte më e ulët sesa është parashikuar dhe kjo ndikoi në ngadalësimin e përgjithshëm.

Rritja modeste në eurozonë

Edhe pse vendet e eurozonës e mbyllën vitin me një normë rritjeje negative prej 0.4%, ka pasur shenja të përmirësimit megjithëse modeste në vitin 2013. Pas 18 muajsh rresht në recesion, zona e valutës së përbashkët shënoi tre tremujorë me rritje pozitive. Pavarësisht nga tendencat pozitive, rritja ishte e ngadaltë dhe jo mjaft e fuqishme për të pasur shumë ndikim në problemet e vazhdueshme të papunësisë. Një aspekt pozitiv i rikthimit të rritjes është natyra e saj e gjerë sepse ajo përfshin aspektet qendrore dhe ato të ashtuquajtura periferike. Inflacioni ra nën nivelet e parashikuara dhe arriti 0.7% në fund të tetorit.

Duket se përkushtimi i presidentit të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) Mario Draghi në vitin 2012 për të bërë "gjithçka që

duhet" për të ruajtur valutën euro mund të ketë vonuar pa qëllim reformat duke ulur presionin e tregut, me disa qeveri që kanë ndjerë më pak urgjencë për të trajtuar ndryshimet strukturore. Megjithatë, politikat monetare në eurozonë ka të ngjarë të përshtaten dhe BQE do të mbajë normat e interesit të ulëta për të shmangur ngritjen e vlerës së euros. Gjatë vitit 2013, Banka Qendrore Evropiane ka vazhduar të ulë normat e interesit edhe për shkak se kërkesa në të gjithë zonën ka mbetur e dobët si rezultat i nivelit të lartë të borxheve publike dhe private.

Të gjitha këto trende vlejné për eurozonën si një e tërë. Megjithatë, analizat e mëtejme theksojnë dallimet e rëndësishme në ecurinë ekonomike ndërmjet shteteve anëtare të veçanta. Gjermania (ku është e përqendruar diaspora kosovare) ishte forca kryesore shtytëse prapa rimëkëmbjes së zonës, por shumë vende të tjera mbeten në recesion me uljen e peshës së sektorit privat në aktivitetin ekonomik. Kufizimet fiskale kanë bërë që të ngecë një reagim i fortë, por ne presim që të shohim lehtësime në vitin 2014.

Vendet e Evropës Juglindore kanë vazhduar të përballen me vështirësi gjatë vitit 2013 edhe pse ka pasur një rikthim në gjysmën e dytë të vitit 2013, si rezultat i përmirësimit të performancës së eksporteve.



Çdo situatë kthejeni gjithmonë në pozitive duke
i vënë vetes standarde të larta dhe pak kufizime.

Rritja mesatare e Bruto Produktit Vendor (BPV) shtrihej nga 0,5-2,6%, e përkrahur nga përmirësimi i sapokrijuar në eurozonë.

Pavarësisht kësaj, perspektiva mbetet e dobët sepse kërkesa e brendshme është nën presion të lartë nga një kombinim i papunësisë së lartë dhe rritjes së ngadaltë të të ardhurave të familjeve, ndërsa eksportet përballen me një sfida të qëndrueshmërisë.

Kjo situatë në eurozonë peshon edhe në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Si një rajon shumë i varur nga importi, konsumi vendor dhe aktivitetet e investimeve kanë qenë kryesisht të dobëta. Kjo është për shkak të krizës globale financiare. Por ndërsa mjedisi i jashtëm përmirësohet, eksportet ka gjasa që të rriten, do të ndalet rënia e kredive dhe, nëse politikat monetare janë të duhura, përmirësimet pasuese në besimin e biznesit duhet të nxisin rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike.

Rritja ekonomike e SHBA-ve është e bazuar në një treg të patundshmërive në rimëkëmbje, shpenzimet e klientëve ende elastike dhe një rritje në investimet afariste; megjithatë, pasiguritë që dalin nga bllokimi aktual i debatit për buxhetin janë duke kufizuar rritjen. Deficiti ka rënë me shpejtësi këtë vit, kryesisht për shkak të rritjes së tatimeve në janar dhe uljes së shpenzimeve. Raporti ndërmjet borxhit dhe PVB-së duhet të bjerë gjatë disa viteve ndërsa rritja nominale e PVB-së është parashikuar të rritet dhe deficiti të bjerë edhe më tutje.

Rritja ekonomike në vendet në zhvillim është stabilizuar dhe ka gjasa të vazhdojë të përmirësohet. Rritja ekonomike e Kinës është përshpejtuar në mënyrë modeste kohët e fundit. Sidomos investimet industriale dhe në pasuri fikse janë përmirësuar dhe konsumi ka mbetur solid. Qeveria ka marrë një qasje pragmatike për të përkrahur rritjen ekonomike, duke përfshirë edhe ofrimin e kredive për sektorët e rinj dhe potencialë ndërsa duke shtrënguar kreditimin për sektorët që kanë tepërcë të kapacitetit. Kjo ka mbajtur rritjen e qëndrueshme duke shmangur përshpejtimin e inflacionit. Programi i Japonisë 'Abenomics', i lansuar nga kryeministri Abe në vitin 2012, ka pasur një efekt të menjëhershëm në tregjet financiare. Ai ka shkaktuar dobësim dramatik të jenit japonez, duke rritur zhvillimin dhe inflacionin pa reforma të rëndësishme strukturore, por mbetet të shihet nëse mund të mbahet energjia e fundit ekonomike.

Në përgjithësi, me përjashtim të ndonjë gabimi të madh në politika, rritja globale duhet të jetë më e fuqishme në vitin 2014. Në mjedisin makroekonomik, inflacioni do të mbetet i ndrydhur dhe rendimentet afatgjata mbi obligacionet qeveritare duhet të vazhdojnë të rriten gradualisht, por vetëm në ekonomitë e zhvilluara.





Letër nga Kryesuesi i Bordit

Për TEB Sh.A, dhe në
përputhje me vizionin
tonë për t'u bërë
"Banka më e mirë në
Kosovë", gjatë vitit
2013 kemi mbetur
pjesëmarrësi më aktiv në
sektorin financiar.

Viti i raportimit 2013, vazhdon të karakterizohet nga përpjekjet e bankave qendrore dhe krijuesve tjerë të politikave për të siguruar rritje të qëndrueshme në kohën pas krizës financiare globale. Rezultatet kanë qenë të përziera ndërsa ekonomitë në zhvillim nuk arritën të realizojnë rritjen e parashikuar, ndërsa ekonomitë e zhvilluara, të tilla si SHBA dhe Eurozona, u paraqitën më mirë se sa pritej.

Ngjarja qendrore ekonomike në vitin 2013 rreth së cilës janë sjellë të gjitha zhvillimet e mëvonshme ishte një njoftim në qershor nga Rezerva Federale e SHBA-së (FED) për lehtësimin sasior (rritjen e sasisë së parave). Bazuar në të dhënat më të forta ekonomike dhe perspektivën pozitive ekonomike, FED deklaroi se do marrë në konsiderim zvogëlimin gradual. Si rezultat i kësaj, ka pasur një ndryshim radikal në flukset e kapitalit ndërsa investitorët filluan të orientojnë investimet e tyre drejt tregut financiar amerikan në kurriz të ekonomive në zhvillim. Nga ana tjetër, këto i panë valutat e tyre të zhvlerësohen. Në eurozonë, vendet e mëdha të tilla si Italia, Franca dhe Spanja vazhduan me reformat strukturore ekonomike që synonin reduktimin e borxhit publik deri në nivele të pranueshme dhe rivendosjen e aftësisë konkurruese të tyre. Kështu dhe në kundërshtim me vendimin e FED-së, ka pak gjasa që Banka Qendrore Evropiane (BQE) të zvogëlojë lehtësimin sasior sepse inflacioni në eurozonë vazhdon të mbetet i ulët, ndërsa tregu i punës nuk është duke treguar ndonjë përmirësim të dukshëm.

Duke pasur parasysh këto trende globale, ekonomia e Kosovës ka mbetur relativisht stabile dhe ka vazhduar të zhvillohet edhe pse me një ritëm të shtypur. Të ardhurat e dobëta doganore dhe ngadalësimi i vazhdueshëm në rritjen e kredive janë kompensuar me tejkalimin e performancës në mbledhjen e tatimeve të brendshme. Një zhvillim pozitiv ishte ulja e lehtë e deficitit tregtar prej 2.2 miliard € në 2.1 miliard €. Më parë, trendi i deficitit tregtar shënonte rritje të vazhdueshme. Sa i përket normës së inflacionit, zhvillimet kanë ndjekur nga afër trendët në vendet importuese ndërsa inflacioni mesatar është ulur nga 2.5% në vitin 2012 në 1.8% gjatë vitit 2013.

Edhe pse qeverisë i është paraqitur sfida e të ardhurave në rënie, nëpërmjet masave korrigjuese dhe zgjerimit të mbledhjes së tatimeve të brendshme, ajo ishte në gjendje të mbetet kryesisht në rrugën e duhur me anë të menaxhimit fiskal të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm. Ulja e të ardhurave doganore që rezultoi nga importet më të ulëta u barazua nga një rritje prej 11% në akcizën e duhanit dhe një rritje të kujdesit në shpenzime. Më 20 nëntor, qeveria vendosi të bllokojë 88 milion € në fonde. Si rezultat, projektimi primar i deficitit në 2013 u korrigjua në 1.7% të PVB-së në krahasim me 3.0% në buxhetin fillestar.

Në përputhje me parashikimet më pozitive ekonomike të eurozonës dhe të vendeve të tjera evropiane, më së shumti Gjermania dhe Zvicra (ku ka një diasporë të përqendruar shqiptare), gjatë vitit 2014 edhe në Kosovë pritet të shihet zhvillim i përsheptuar në rangun prej 4%. Rritja e pritshme e fluksit të remitancave nga diaspora do të shkaktojë ngritje të kërkesës së brendshme dhe një burim potencial të financimit për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese. Nga ana tjetër, zgjedhjet parlamentare të ardhshme mund të rrezikojnë angazhimet aktuale për menaxhim fiskal të disiplinuar dhe të paraqesin një sfidë të vërtetë në të ardhmen.

Vendi vazhdoi të mbajë një sistem financiar stabil dhe shumë të kapitalizuar ndërsa raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 16.4% krahasuar me 14.2% në fund të vitit 2012. Zbatimi i ligjit të ri për bankat ka kontribuar në këtë kujdes të shtuar ndërsa bankat kërkohej të përmbushin kërkesa të reja për kapitalin e rrezikut operativ dhe një raport minimal të aseteve likuide. Edhe pse pasuritë e bankës janë rritur dhe arritën në 3.06 miliard € kjo ishte kryesisht rezultat i investimeve në instrumentet financiare ndërsa aktiviteti kreditor është zvogëluar dhe kreditë për bizneset dhe familjet kanë rënë për 2.4% krahasuar me vitin e kaluar. Ky ngadalësim në kredi, në kombinim me rritjen e kredive në vonesë ka kontribuar në rritjen e koeficientit të kredive me probleme.

Për TEB Sh.A, dhe në përputhje me vizionin tonë për t'u bërë "Banka më e mirë në Kosovë", gjatë vitit 2013 kemi mbetur pjesëmarrësi më aktiv në sektorin financiar. Edhe një herë ne kemi treguar ambicie dhe besimin tonë në ekonominë reale. Ndërsa kreditë e përgjithshme neto të sektorit kanë rënë për 51.3 milion €, ne kemi lëvizur në drejtim të kundërt dhe kemi rritur portfolion tonë të kredive në 43.1 milion €. Natyrisht, kjo rritje ambicioze gjithashtu ka paraqitur sfida në kreditë me probleme (NPL), por prapë jemi shumë të sigurt se me rritjen e përqendrimit dhe përpjekjeve çdo rritje do të jetë e menaxhueshme dhe e rikuperueshme. Trendet pozitive të vitit 2013 kanë forcuar më tej reputacionin e TEB-it në treg dhe kemi përfunduar me sukses pesë vitet e para të punës sonë në tregun e Kosovës. Në këtë drejtim, mirënjohja në formën e shpërblimit të Euromoney 'Banka më e mirë në Kosovë' ishte 'krem mbi tortë' sepse kjo më tej e përforcoi përkushtimin tonë të plotë ndaj përsosmërisë.

Duke ecur përpara drejt qëllimeve dhe arritjeve të reja, unë do të doja për një moment të falënderoj klientët tanë, punonjësit, partnerët afaristë dhe aksionarët për kontributin e tyre dhe përkushtimin ndaj ndërmarrjes TEB Sh.A. Unë do të doja të falënderoj zotin Orkun Mungan që gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në TEB ka kontribuar në organizimin dhe objektivat e saj dhe z. Alp Yilmaz, për kontributin e tij si ushtrues detyre i Kryeshefit Ekzekutiv për tremujorin e fundit të vitit 2013. Në të njëjtën kohë, dëshiroj të uroj mirëseardhje për z. Ajhan Albeyoglu si Kryeshefi i ri Ekzekutiv i TEB Sh.A. Ai mori këtë përgjegjësi në vitin 2014 dhe përvoja dhe ekspertiza e tij në sektorin bankar do të konsolidohet më tej dhe të avancojë pozitën e Bankës.

Musa Erden

Kryesues i Bordit të Drejtorëve



Letër nga Kryeshefi ekzekutiv

Ky ka qenë vit
shembullor për bankën
tonë. Gjatë vitit 2013
TEB Sh.A. e përforcoi më
tej pozicionin e vet si
një nga prijësit kyç të
sektorit në këtë vend
dhe ekipi ynë krijoi vlerë
të rëndësishme për ju,
aksionarët dhe klientët
tanë, duke u përqendruar
në çështjet që kanë
rëndësi.

Ekonomia dhe sektori bankar i

Kosovës vazhdojnë të përmirësohen

Aktiviteti ekonomik në Kosovë u përmirësua gjatë vitit 2013 me një rritje të paralogaritur ekonomike në 3.1%. Efekti më i ndjeshëm në rritjen ekonomike është ngushtimi i deficitit tregtar me ç'rast mallrat e importuara po zëvendësohen me prodhime të vendit. Ky efekt, i shoqëruar nga rritja e konsumit, mund të ofrojë përnxitjen e nevojshme për ta përshpejtuar rritjen e prodhimit vendor si dhe sektorin e bujqësisë.

Sa i përket lehtësisë për bërje biznesi, Kosova është ndër shtetet që u përmirësuan më së shumti më 2012/2013. Rangimi ynë u ngjit në vendin e 86-të nga vendi i 98-të në raportin për Bërje Biznesi të Bankës Botërore. Përmirësimet më të ndjeshme janë në fushën e kërkesave minimale kapitale, one-stop-shopet (zyrat për inicimet dhe çështjet e bizneseve) të krijuara dhe të përmirësuara, pagesat e ulura, nisjen e sistemit të ri të noterisë që i ka thjeshtuar procedurat për hartimin dhe legalizimin e marrëveshjeve të shitblerjeve, si dhe trajtimin e lejeve të ndërtimeve.

Me gjithë pasiguritë në tregun global, sektori bankar ka shënuar zhvillime pozitive dhe rritje të qëndrueshme. Me një sektor shërbimesh financiare mirëfilli të kapitalizuar dhe të forcuar, bankat kanë vazhduar të formojnë një gur themeli të fortë për veprimtaritë ekonomike. Shumica e veprimtarive huadhënëse vazhdojnë të përqendrohen në kredi për ndërmarrjet. Sektori tregtar ende mbizotëron, me 52% të të gjitha kredive, por ka edhe shtime të dukshme në kredidhënie për sektorin bujqësor. Sektori i prodhimit dhe ai i ndërtimtarisë tregojnë njëfarë rënieje në 1% dhe 5.2% respektivisht. Kjo e pasqyron faktin se Kosova ende varet së tepërmi nga tregtia dhe prodhimi vijon të stagnojë.

Banka Qendrore e Kosovës e rrit sektorin nëpërmjet mbikëqyrjes vigjilente financiare dhe përditësimit të mëtejshëm të kornizës rregullative.

Performanca jonë këtë vit

Gjatë vitit 2013 i mbetëm besnikë vizionit, misionit dhe strategjisë sonë. Dëshmuam sërish se TEB është bankë e përgjegjshme që u shërben klientëve dhe shoqërisë, ndërkohë që ofron rezultate të fuqishme në një mjedis të vështirë. Më 2013, gjeneruam rezultate mjaft solide me të ardhura prej €37.534 milionë dhe fitime neto prej €3.786 milion. Të gjitha njësitë tona afariste u kontribuan këtyre rezultateve, duke e shpalosur kështu dinamizmin përpos suksesit, zotimit dhe qëndrueshmërisë sonë.

Si një partner i dijshtëm për klientët tanë dhe nëpërmjet përkushtimit tonë për partneritet afatgjatë, vazhduam të ofronim një ofertë të vlerës së rumbullakosur të produkteve dhe të shërbimeve bankare. Të gjitha kanë ndikim pozitiv në cilësinë e jetës së klientëve tanë dhe do ta përnxisin një rritje sociale e ekonomike në këtë vend. Llojllojshmëria e produkteve tona të thjeshta por të përshtatura kundrejt nevojave të klientëve, cilësia e shërbimeve që ofrojmë, marrëdhëniet që ndërtojmë me klientët si dhe kontributi pozitiv ndaj shoqërisë, vazhdojnë të na japin përparësi konkurruese dhe ta përforcojnë pozicionimin e brendit tonë si njëri ndër më të besueshmit në Kosovë.

Kredencialet dhe zotimet tona janë shpërblyer me besimin e 43.000 klientëve të rinj që zgjodhën të bankonin me ne gjatë këtij viti raportues. Depozitat që iu besuan bankës sonë u shtuan 21%, duke na dhënë një pjesë tregu prej 14% krahasuar me 11.7% më 2012.

Baza e plotë e aseteve u ngrit në €372.401 milionë ose një rritje prej 24,1%, ndërsa asetet e gjithëmbarshme të sektorit bankar u shtuan me 8%. Ndonëse aktivitetet huadhënëse në sektorin bankar shënuan njëfarë ngritjeje prej 2,4%, vazhduam me racionalizimin e produkteve të kredive, duke u përqendruar në nevojat thelbësore të klientëve dhe në përmirësimin e qasjes së klientëve ndaj mundësive të kredive. Kjo gjeneroi një rritje prej 21,8% në portfolion e kredisë. Tani kemi 17.24% të hises së tregut. Ndonëse portfolio jonë e kredive po rritet, pjesa e kredive joperformuese është 6,54%, dukshëm më ulët sesa mesatarja e sektorit dhe kufizimet statutare. Kjo për shkak të menaxhimit të kujdesshëm të rrezikut të kredisë dhe vlerësimit dhe analizës së shtuar të vlefshmërisë së kredisë.

Rezultatet dhe qasjet tona garantojnë qartazi perceptimin e klientëve ndaj nesh. Kjo u kuptua edhe nga gazeta autoritative ndërkombëtare e financave, Euromoney, e cila e shpërbleu TEB-in me çmimin e shkëlqesisë 'Banka më e mirë në Kosovë' më 2013. Kjo është veçanërisht përmbushëse meqë këto shihen si çmimet më të mira për shërbimet financiare globalisht. Ky çmim është njohja ndërkombëtare e pozitës së fortë dhe arritjeve të mahnitshme të TEB-it në tregun e Kosovës. Ajo na e riafirmon suksesin për krijimin e vlerave për klientët, aksionarët, punonjësit dhe vendin tonë.

Çka ka të re?

Të gjitha aktivitetet tona përqendrohen dhe përkushtohen që të arrijnë rritje të qëndrueshme organike duke i tejkaluar nevojat dhe pritshmëritë e klientëve dhe të shoqërisë në të cilën operojmë. Përpjekjet tona prandaj udhëhiqen nga dëshira që kemi për të ofruar shërbime relevante dhe kyçe për nevojat e klientëve personalë dhe të bizneseve.

Për klientët individualë, i kemi revolucionarizuar ofrimet e kredive që të jenë më të qasshme dhe madje edhe financiarisht më të leverdishme. Një ndër propozimet më të fundit të vlerave që kemi u mundëson klientëve të bëjnë hapin e parë në shkallën e pronësisë së pronës. Kjo është arritur nëpërmjet partneriteteve me kompanitë kryesore dhe më në zë të ndërtimit në Kosovë. Blerësit e shtëpive e banesave përfitojnë nga interesa më të ulët dhe procese vendimmarrëse më të shpejta, ndërsa TEB-i ishte në gjendje të arrinte shtim të trefishtë në portfolion e kredive të hipotekave.

Si korporatë qytetare e përgjegjshme me përqendrim në mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin efikas të energjisë, më 2013 TEB i zgjeroi bashkëpunimet me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD). Ky bashkëpunim na mundësoi të prezantonim produktin e kredisë së gjelbër. Produkti është përshtatur për të financuar projekte të cilat do të përmirësojnë efikasitetin e energjisë. Për klientët, ka një varg avantazhesh. Kredia ofrohet me interesa shumë të leverdishëm ndërsa EBRD ofron nxitje financiare për huamarrësit.

Vazhdojmë t'i përkrahim klientët tanë biznesorë me produkte dhe shërbime inovative që janë përshtatur për ta përkrahur rritjen e bizneseve të tyre. Si një sektor tejet i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, kemi prezantuar agrokredi të synuara për mirëmbajtjen e investimeve dhe të zhvillimit në sektorin bujqësor. Oferta mund të përshtatet me natyrën ciklike të agrobiznesit.

Qasja më e lehtë e klientëve ndaj produkteve e shërbimeve të thjeshta, të përshtatura dhe transparente bankare përsëri na e frymëzoi ekipin më 2013. Kjo na bëri të prezantojmë disa produkte e shërbime të reja për t'i shtuar pagesat dhe transferet e klientëve. E kemi zgjeruar edhe rrjetin me tri filiale të reja dhe vazhdimisht po i shtojmë rrjetet e terminaleve ATM dhe POS. Njëkohësisht, ngulmojmë me përpjekjet për t'i bindur klientët mbi avantazhet e përvojave të avancuara bankare nëpërmjet kanaleve tona alternative të shpërndarjes që vazhdimisht ofrojnë shërbime të reja dhe inovative.

Ndërtojmë për të ardhmen

Performanca dhe rritja e qëndrueshme nuk do të ishin të mundshme pa përkushtimin dhe zotimin e të gjithë punonjësve. Më 2014 do të mbetemi të përkushtuar që të investojmë në ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës. Kjo është jetike meqë do të frymëzojë evoluimin e mëtejshëm të vlerave të duhura ndërkohë që na i stimulon kolegët ta sfidojnë vetveten për ta përmbushë potencialin dhe talentin vetjak. Mbetemi të përkushtuar që të ofrojmë programe trajnimi, mundësi dhe ta shpërblejmë performancën e jashtëzakontë në mënyrë konkurruese. Presim nga kjo zotim të plotë për ofrimin e shërbimeve të shkëlqyera për klientët.

Do të këmbëngulim në vizionin tonë për të qenë forca motorike për klientët tanë nëpërmjet produkteve dhe shërbimeve të thjeshta, transparente, të përgjegjshme, kosto-efektive dhe të qëndrueshme. Përvoja e klientëve është ndër prioritetet kyçe për vitin e ardhshëm meqë synojmë të ofrojmë përvojë përtej pritshmërive për të gjithë.

Jemi krejt të vetëdijshëm për reliefet rregullative financiare përherë në evoluim që do të kërkojnë të mishërohen në biznesin tonë dhe mbetemi krejt të vëmendshëm ndaj ndryshimeve. Për më tej, zotohemi të vazhdojmë me financimin e matur të sektorëve, vitalë për përparimin socio-ekonomik të Kosovës, me një theks të veçantë ndaj projekteve që do të mbështesin gjenerimin e punësimit dhe të prodhimit.

Çka më tutje?

Duke shikuar drejt vitit 2014, jemi të bindur se do të vazhdojmë të ndërtojmë mbi përparimin e bërë sivjet. Do të përqendrohemi në optimalizimin e bilanceve që do të sjellin kthime të qëndrueshme ndërkohë që ndjekim një rritje të përzgjedhur të bilancit. Për më tej, reduktimi i kostove dhe rritja e efikasitetit operacional mbeten sfida dhe prioriteti jonë për të ecur përpara.

Jemi duke i vënë vetes caqe ambicioze dhe kemi mjaft për të bërë. Megjithatë, kemi çdo arsye për t'u ndier pozitivë dhe konfidentë lidhur me drejtimin e një institucioni financiarisht stabil dhe të vëmendshëm ndaj rreziqeve ndërsa ofrojmë vlera për klientët, aksionarët dhe punonjësit.

Dua të përfitoj nga rasti dhe t'i falënderoj klientët për besimin e tyre. Kjo është ajo që na motivon të mendojmë jashtë kornizave dhe të krijojmë produkte e shërbime inovative që e bëjnë diferencën. U jemi mirënjohës aksionarëve për përkrahjen e pandalshme. Falënderime të veçanta edhe punonjësve tanë për besnikërinë dhe entuziazmin që ambicien dhe kureshtjen e tyre e shndërrovan në produkte dhe shërbime inovative dhe përvojë të shkëlqyer për klientët.

Alp Yilmaz

Kryeshef ekzekutiv




TEB-i në shifra



Nuk ka ashensor për te suksesi.
Gjithmonë synojini yjet.



Indikatorët e bilancit të gjendjes

2013


2012



Rritje/ (Rënie) - 72,229
Përqindja - 24.1%




Rritje/ (Rënie) - 50,650
Përqindja - 21.8%




Rritje/ (Rënie) - 56,863
Përqindja - 21.0%



Rritje/ (Rënie) - 4,786
Përqindja - 22.1%



Rritje/ (Rënie) - 1.5%
Përqindja - 30.4%




Rritje/ (Rënie) - (-1.4%)
Përqindja - (-1.8%)



Rritje/ (Rënie) - 12.7%
Përqindja - 18.7%


Indikatorët e pasqyrës së të hyrave



Rritje/ (Rënie) - 3,165
Përqindja - 17.9%



Rritje/ (Rënie) - 1,035
Përqindja - 25.5%



Rritje/ (Rënie) - (-3.8%)
Përqindja - (-6.5%)



Rritje/ (Rënie) - 4,225
Përqindja - 19.1%



Rritje/ (Rënie) - (-505)
Përqindja - (-11.8%)

Raportet e profitit

2013

2012

Kthimi në ekuitet




Rritje/ (Rënie) - (-7.9%)
Përqindja - (-30.9%)

Kthimi nga mjetet



Rritje/ (Rënie) - (-0.4%)
Përqindja - (-28.9%)

Mjetet



Rritje/ (Rënie) - 0.2%
Përqindja - (-2.4%)

Raportet e likuiditetit

Raporti i
mjaftueshmërisë
së kapitalit

Rritje/ (Rënie) - 0.4%
Përqindja - 3.3%

Mjetet likuide/
Gjithsej mjetet

Rritje/ (Rënie) - 2.5%
Përqindja - 10.4%

Mjetet e ponderuara
sipas rrezikut

Rritje/ (Rënie) - 23,964
Përqindja - 9.1%

Indikatorë tjerë

Degët



Rritje/ (Rënie) - 3
Përqindja - 13.0%

Punonjësit



Rritje/ (Rënie) - 119
Përqindja - 27.3%

INDIKATORËT KYÇ FINANCIAR

Në fund të vitit 2013,
totali i pasurive të
Bankës arriti 372.4€
milion, i rritur për 72.2€
milion ose 24.1% në
krahasim me vitin 2012.

Viti i raportimit 2013, mund të konsiderohet si një pikë referimi në profit për bankën TEB. Banka ishte në gjendje të arrijë në pikën kumulative të kthimit të investimit duke kthyer të gjitha humbjet e bartura nga vitet e mëparshme. Për më tepër, kemi arritur rritje të qëndrueshme në portfolion tonë të depozitave kreditore dhe bazën e klientëve. Rezultati përfundimtar është një rritje e konsiderueshme në pjesën e tregut të TEB-it në sektorin e shërbimeve financiare të Kosovës.

Në fund të vitit 2013, totali i pasurive të Bankës arriti 372.4 milion €, i rritur për 72.2 milion ose 24.1% në krahasim me vitin 2012. Portfolio bruto i kredive u rrit në 283.1 milion €, një rritje prej 21.8%, ose një rritje e volumit prej 50.6 milion € mbi performancën e vitit të kaluar dhe që përfaqëson rritjen më të lartë të kredive në sektorin bankar në vitin 2013.

Kreditë bruto tani përbëjnë 76% të totalit të pasurive të Bankës në bilancin e gjendjes së TEB-it.

Asgjë s'është e pamundshme - vetë fjala thotë se jam e pamundshme - duhet t'u besosh ëndrrave në mënyrë që t'i realizosh



Raporti i kredive joperformuese (NPL) (kreditë mbi 60 ditë në vonesë) në fund të vitit 2013 ishte 6.5% krahasuar me 5.0% në vitin 2012. Me gjithë rritjen prej 152 pikë bazë, TEB ka pasur një ndër koeficientet e kredive joperformuese më të ulëta në sektorin bankar. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese është rritur nga 67.8% në vitin 2012- në 80.5% në fund të vitit 2013. Raporti i kredive joperformuese me kredi më shumë se 90 ditë në vonesë është rritur në 5.9% ose një rritje prej 172 pikë bazë në krahasim me vitin e kaluar (2012: 4.2%) .

Zëri kryesor i bilancit të gjendjes në anën e detyrimeve që ka vazhduar të rritet ishte depozitat e klientëve që lehtësojnë rritjen e kreditimit të klientëve. Depozitat totale të klientëve në fund të vitit 2013 arritën në 327.2 milion €, një rritje prej 56.9 milion € ose 21.0% në krahasim me fundin e vitit 2012.

Gjatë vitit 2013, Banka ka hyrë edhe në një marrëveshje të kredisë së varur me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) për një shumë prej 4.5 milion € me afat 10-vjeçar. Ky transaksion i ri sjell totalin e kredive të varura nga IFC në 11 milion €. Përveç kësaj, një marrëveshje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për nën-financimin e projekteve të eficiencës së energjisë në shumë prej 5 milion € është nënshkruar gjatë vitit 2013, nga të cilat 2.5 milion € ishin marrë nga BERZH gjatë vitit raportues. Kapitali i aksionarëve u rrit nga 21.6 milion € në vitin 2012 në 26.4 milion € në vitin 2013, për shkak të 3.8 milion € të fitimit të pashpërndarë dhe 1 milion € në kapitalin shtesë të paguar nga aksionarët. Në tërësi kjo paraqet një rritje prej 22.1% të kapitalit të aksionarëve në krahasim me vitin 2012.

Treguesit e pasqyrës së të hyrave gjithashtu tregojnë përmirësim të dukshëm në performancë në krahasim me vitin e kaluar. Të hyrat neto nga interesi arritën 20.9 milion €, duke u rritur për 3.2 milion € ose 17.9% në krahasim me vitin 2012, me gjithë trendin e vazhdueshëm në rënie në normat mesatare të interesit të kredive dhe depozitave

gjatë vitit 2013. Të ardhurat neto jo nga interesat kanë arritur në 5.1 milion €, një rritje prej 1.0 milion € ose një rritje prej 25.5% në krahasim me vitin 2012.

Raporti kosto të ardhura në vitin 2013 është ulur më tej në 55.1% nga 58.9% në vitin 2012, duke treguar rritjen e efikasitetit të Bankës dhe menaxhimit të vazhdueshëm të kujdesshëm të shpenzimeve operative. Të ardhurat neto nga shërbimet bankare në fund të vitit ishin 26.3 milion € në krahasim me 22.0 milion € të realizuara në vitin 2012.

Banka përfundoi vitin me 3.8 milion € fitim pas tatimeve në krahasim me 4.3 milion € në vitin 2012, ose një rënie prej 11.8%.

Sa i përket treguesve të profitabilitetit, në fund të vitit 2013 Banka ka krijuar kthim nga kapitali (ROE) në rendiment prej 17.7% krahasuar me 25.6% në vitin 2012, ndërsa kthimi nga asetet (ROA) qëndroi në 1.0% në krahasim me 1.4% në vitin paraprak. Interesi neto mbi asetet mesatare që krijojnë interes ishte 8.0%, një rritje nga 8.2% në vitin 2012.

Sa i përket menaxhimit të kapitalit të bankës në fund të vitit 2013, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës (CAR) ishte 13.4%, duke tejkaluar kërkesën minimale të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) prej 12%, dhe është rritur nga 13.0% në fund të vitit 2012 për shkak të rritjes së fitimeve të pashpërndara gjatë vitit.

Asetet likuide në krahasim me raportin e aseteve totale ishin 26.8% në fund të vitit 2013 në krahasim me 24.3% në vitin 2012, ndërsa asetet e ponderuara sipas rrezikut (RWA) arritën 287.1 milion €, të rritura nga 263.2 milion € në vitin paraprak pas rritjes në portfolion e kredive gjatë vitit 2013.

Në vitin 2013, Banka hapi tri degë të reja, duke rritur numrin e përgjithshëm të degëve në 26 (2012: 23), ndërsa numri i punonjësve është rritur në 555 në krahasim me 436 në fund të vitit 2012.

SHËRBIMET BANKARE INDIVIDUALE

Sivjet, më 2013,
vazhduam ta pasurojmë
ofertën për produkte e
shërbime tejet inovative
dhe komplementare, për
t'i mbështetur klientët
tanë në të gjithë hapat
kyçë të jetës së tyre.



Lidhja e partneritetit me klientët tanë

Ne jemi bankë e orientuar me vendosmëri në shërbim të klientëve. Dëgjimi i klientëve është prioritet i përditshëm për zyrtarët tanë të portfolios. Ne kemi për qëllim për të ndërtuar marrëdhënie gjithnjë e më të afërta me klientët tanë duke ofruar shërbime superiore dhe duke ofruar propozime që plotësojnë saktësisht nevojat dhe planet e tyre.

Këtë vit 2013, ne kemi vazhduar të diversifikojmë ofertën tonë me oferta për produkte dhe shërbime shumë inovative dhe plotësuese për të përkrahur klientët tanë në të gjitha qëllimet e jetës së tyre.

Arsimi është thelbësor për arritjen e ambicieve personale ndërsa kontribuon në rritjen ekonomike të vendit. Kjo është arsyeja pse ne kemi revolucionarizuar kreditë tona arsimore. Në partneritet me shkollat dhe universitetet, ne kemi prezantuar financim për pagesën e shkollës pa fare interes për studentët.

Një tjetër ofertë ekskluzive ndihmon klientët të bëjnë hapin e tyre të parë në blerjen e pronës. Ne tani ofrojmë kredi hipotekare me norma shumë të volitshme të interesit dhe me maturitet të përshtatur me të ardhurat e klientëve. Kjo do të thotë se pagesat nuk e mbingarkojnë buxhetin shtëpiak.

Në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ne kemi prezantuar një produkt të gjelbër kreditor. Produkti është përshtatur për të financuar projekte të cilat do të përmirësojnë efikasitetin e energjisë. Normat e interesit janë shumë të volitshme dhe klientët që marrin këto kredi kanë të drejtë për stimulim financiar nga BERZH-i.

Gjatë gjithë vitit, ne kemi nisur një numër fushatash që ofrojnë norma të volitshme dhe konkurruese, veçanërisht në tregun aktual. Klientëve afaristë u janë ofruar kredi konsumuese duke filluar pa interes dhe duke u mundësuar që të financojnë nevojat e tyre personale, duke përfshirë pajisjet shtëpiake, automjetet dhe projekte të tjera që kontribuojnë në mirëqenien e tyre. Për më tepër, ne vazhdojmë të ofrojmë mundësi të tilla si pushim nga pagesa për klientë të caktuar.

Të gjithëve u japim më shumë nga çka presin.

Besimi i klientëve – pasuria jonë më e vlefshme

Besimi dhe besnikëria e klientëve tanë janë pasuritë tona më të vlefshme. Besimi i tyre nuk është i rastit; ne kemi investuar dhe vazhdojmë të investojmë shumë në ndërtimin dhe ruajtjen e atij besimi gjatë viteve.

Në mjedisin e tanishëm bankar, zhargoni dhe terminologjia e sektorit janë zakonisht normë për të komunikuar me një bankë. Ne mbrojmë komunikimin përmes dialogut të bazuar në transparencë, ndershmëri, këshilla të paanshme dhe informacion të paanshëm dhe të sigurtë. Ne e bëjmë këtë në gjuhë të drejtpërdrejtë, duke fuqizuar klientin për të marrë vendime të informuara.

Ndërsa mbrojmë komunikimin e hapur, ne kemi përditësuar kushtet tona të përgjithshme që formojnë

bazën për shërbime bankare individuale. Dokumenti tashmë është shkruar në gjuhë të kuptueshme dhe është lehtësisht në dispozicion në faqen tonë të internetit dhe në degët tona për referim në të ardhmen.

Këtë vit, hynë në fuqi ligjet dhe rregullat e reja për aktivitetet bankare. Përveç që i jemi përgjigjur të gjitha dispozitave të reja, ne kemi mbajtur klientët tanë të informuar për ndryshimet dhe pasojat e tyre praktike në aktivitetet bankare.

Performanca jonë këtë vit

Duke ndjekur strategjinë tonë afariste, ne kemi vazhduar të rritemi. Në vitin 2013, përkushtimi dhe angazhimi jonë fituan besimin e më shumë se 40.000 shfrytëzuesish të rinj, që paraqet rritje prej 27% krahasuar me vitin e kaluar. Një prej kanaleve të rëndësishme për përvetësimin e qëndrueshëm të klientëve është numri i klientëve që marrin pagën e tyre përmes TEB-it - numri është rritur për 31% në vitin 2013.

Portfolio ynë i depozitave është rritur për 46.8 milion € ose 30% në krahasim me vitin e kaluar, duke tejkaluar rritjen e sektorit. Përpjekjet tona për të nxitur një kulturë kursimi, si një faktor i rëndësishëm në sigurinë e ardhshme financiare të klientëve tanë kanë rezultuar me rritje prej 49% të portfolios së llogarisë sonë të kursimeve. Në përgjithësi, numri i klientëve me llogari depozite në TEB është rritur për 38%.

Paraqitja e produkteve të reja kreditore dhe kapitalizimi në marketingun kreativ që synon grupe të caktuara ka rezultuar në një portfolio të mbetur të kredive prej 17.6 milion € ose një rritje prej 29% ndërsa portfolio e kredive hipotekare është trefishuar. Këtë vit, ne kemi lëshuar kredi për 46% më shumë klientë se sa në vitin e kaluar.

Menaxherët tanë të portfolios janë gjithmonë në dispozicion për të ofruar këshilla dhe ndihmë personale. Megjithatë, ne përpigemi për ta lehtësuar punën për klientët tanë duke ofruar shërbime që u përshtaten atyre pa pasur nevojë për të vizituar degët tona ose për të pritur në radhë për të kryer transaksionet e përditshme. Në fund të vitit, 56% e klientëve kanë filluar të përdorin platformën tonë të shërbimeve elektronike e-banking. Numri i përdoruesve të rinj të SMS mbushjeve dhe SMS shërbimeve bankare është rritur për 23% dhe e fundit 24%.

Çka më tutje?

Për të përkrahur rritjen tonë, në vitin 2014 dhe më tutje, ne do të vazhdojmë të rivlerësojmë sistematikisht politikat tona të çmimit të depozitave dhe të zhvillojmë portfolion kreditore. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë përvoja të shkëlqyera për klientë dhe të vendosim bazat për të ardhmen. Ne do të vazhdojmë gjithashtu të shtojmë kanalet tona të besueshme dhe inovative alternative të shpërndarjes për t'u shërbyer nevojave

të përditshme bankare të klientëve. Në të njëjtën kohë, ne do të ndajmë më shumë resurse për rrjetin e degëve për përkrahje këshillëdhënëse me vlerë të shtuar për zgjidhje më komplekse.



Personeli ynë ju trajton në
mënyrë që t'ju bëjë krenarë.

SHËRBIMET BANKARE PËR NVM

Falë përkushtimit ndaj klientëve, ishim në gjendje ta përforconim më tej pozitën tonë si bankë kryesore për bizneset, sidomos në segmentin e NVM-ve.

Në vitin 2013, njësia e bankës për biznesin e NVM përsëri demonstroi besimin tonë të fortë në këtë segment si një komponent jetik në ekonominë e Kosovës dhe aftësinë e saj për të krijuar vlerë të shtuar dhe për të hapur vende të reja të punës. Në një vit kur kishte pakësim të financimit të sektorit bankar për këtë segment, TEB ishte një nga pak banka që i rezistoi trendit. Falë përkushtimit të klientëve tanë, ne ishim në gjendje ta forcojmë më tej pozitën tonë si bankë kryesore për bizneset, sidomos në segmentin e NVM-ve.

Si në vitet e mëparshme, gjatë vitit 2013 aktivitetet tona bankare për NVM vazhduan të rriten. Ishte një nga vitet më të mira, me rritje 32.2% në kreditë e mbetura. Në fund të vitit, portfolio kreditore ka arritur në 97.3 milion €. Kredi janë dhënë edhe për kapital punës edhe për financim të investimeve.

Shitja e produkteve të ndryshme është një element qendror në kulturën afariste të Bankës dhe përmes marrëdhënieve tona të afërta me klientët, ne ishim në gjendje të rrisim numrin e kartelave, Pikave të Shitjes, e-banking dhe shërbimeve me SMS. Të gjitha këto mundësi rrisin efikasitetin e biznesit dhe u ndihmojnë klientëve

për të konsoliduar më tej rrjedhën e parasë. Një produkt i ri, i lansuar në fund të vitit, do të dëshmohej si një tjetër mjet i dobishëm i biznesit. TEB ka dizajnuar 'Star Cash', një kredit kartelë me mundësi të tërheqjes së parave 100%, për t'u dhënë klientëve të NVM-ve likuiditet themelor shtesë.

TEB gjithashtu synon të përkrahë përgjegjësinë sociale dhe mjedisore të NVM-ve. Kjo është arsyeja pse në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ne kemi prezantuar "kreditë e gjelbra". Ky është një lloj shumë i veçantë i kredisë që, përmes stimulimeve financiare, inkurajon bizneset për të investuar në projekte për efikasitet energjetik. Në fund të vitit 2012, TEB shpalli ambiciet e saj për të hyrë në sektorin e bujqësisë për shkak të rëndësisë së tij strategjike për zhvillimin e vendit.

Në fund të vitit 2013, ne mund të raportojnë se hyrja jonë ka pasur sukses. Portofoli agro arriti 5 milion € në kredi të mbetura. Portfolio i agro kredive është përkrahur nga fondi i garancisë i USAID-it, i cili i mundëson Bankës për ta zhvilluar këtë sektor shumë premtues në një mënyrë më të sigurt.



U kushtojmë rëndësi detajeve.

Çka më tutje?

Në të ardhmen, njësia bankare e NVM-ve ka për qëllim të ruajë ritmin e saj aktual gjatë vitit 2014. Duke vazhduar të financojmë klientët tanë NVM, qëllimi ynë është që të bëhemi sinonim me financimin e NVM-ve në treg, edhe në agro-biznes. Si gjithmonë, ne do të mbetemi të përqendruar në shërbimin për klientë, kënaqësinë e klientëve dhe rritjen e qasjes në kanale alternative për shërbimet bankare. Një risi e rezervuar për klientët tanë agro do të futet në vitin 2014. 'Agro Kartela' është një kartelë e përshtatshme për bujqit që merr parasysh sezonalitetin dhe specifikat tjera të biznesit të tyre. Duke ofruar 'Agro kartelën' ne kemi për qëllim të fuqizojmë klientët tanë bujqësorë dhe të rrisim në maksimum përpjekjet e tyre për prodhim.

Shërbimet bankare komerciale dhe për korporata

Performanca afariste e TEB-it ishte në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit, meqë portfolioja e kredive arriti në 76.4 milion €, duke vazhduar trendin e ngritjes.

Gjatë vitit 2013, TEB ka vazhduar të mbajë një prani të fortë në tregun komercial dhe të korporatave. Duke kombinuar dhe zbatuar një strategji të fokusuar te klienti dhe të orientuar kah zgjidhjet, shërbimet bankare komerciale dhe të korporatave siguruan përkrahje për këtë segment të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Thëks i veçantë u vu në cilësinë e marrëdhënieve dhe ndërveprimeve tona afariste. Ne ofrojmë një gamë të plotë të produkteve dhe shërbimeve tradicionale, dhe ne gjithashtu ofrojmë një gamë të gjerë të zgjidhjeve të përshtatura, plotësimin e nevojave të biznesit dokumentar dhe të menaxhimit të parave të gatshme, zbritje në të arkëtueshmet tregtare dhe një kartelë të kreditit multi-funksionale të biznesit. Njësia e shërbimeve bankare për korporata në TEB vazhdimisht synon të dallojë ofertën e saj. Ne e bëjmë këtë duke plotësuar propozimet kryesore bankare me produkte dhe shërbime të reja, të modernizuara dhe me teknologji të avancuar.

Performanca afariste e TEB-it ka qenë në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit, kur portfolio e kredive arriti në 76.4 milion €, duke vazhduar trendin rritës. Projektet për klientët e rinj dhe ekzistues të korporatave janë përkrahur. Duke njohur përgjegjësinë sociale dhe mjedisore të korporatave, ne kemi nisur të

ofrojmë 'kreditin e gjelbër' në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Kjo është një kredi specifike që ofron stimule financiare për të inkurajuar bizneset të investojnë në efikasitetin e energjisë. Këtu prapë, ofrimi i një produkti të tillë unik në tregun e Kosovës tregon interesin tonë për rritje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ishte futja e skontimit të SDD. Ky zhvillim ishte një progresion logjik nga sistemi ekzistues i SDD që garanton të arkëtueshmet. Kur zbatohet skontimi SDD, klienti korporatë konsolidon financat dhe fitimet përmes mbledhjes së hershme së të arkëtueshmeve ekzistuese. Një produkt me karakteristika të ngjashme është zhvilluar për biznesin dokumentar dhe është lansuar në treg si skontimi i LK.

Në të njëjtën kohë, kanalet alternative u përmirësuan ndërsa janë zhvilluar karakteristika të reja. Në këtë mënyrë, kredit kartela për biznese u bë edhe më e lehtë të menaxhohet në Biznes E-Banking. Për më tepër, mundësia e pagimit të komunalive me kredit kartelë u prezantua në përputhje me strategjinë tonë të integruar të zhvillimit të produkteve. Të gjitha këto risi kontribuan në menaxhimin më efektiv financiar të korporatave, të mundshëm 24 orë në ditë.



**E çmojmë marrëdhënien me klientin.
Jemi gjithmonë të disponueshëm për ju.**

Çka më tutje?

Në vitin 2014, ne do të forcojmë më tej lidhjet tona me klientët afatgjatë dhe në të njëjtën kohë të krijojmë raporte me klientë të rinj. Zhvillimi i qëndrueshëm do të mbetet në qendër të vëmendjes, demonstruar nga përpjekjet tona të vazhdueshme për të promovuar 'kreditë e gjelbër'. Ne do të vazhdojmë qasjen tonë inovative duke zhvilluar sisteme të reja të pagesave, procese të reja të biznesit, ndërsa duke kërkuar mënyra të shfrytëzimit të sinergjisë. Ne besojmë fuqimisht se, duke ofruar të gjitha këto produkte të kombinuara me shërbimin më të mirë për klientë, ne do të mbetemi banka e zgjedhur në segmentin e korporatave.

BIZNESI I KARTELAVE

Sivjet e kemi prezantuar
kartelën e re Starcard
Premium, një tjetër
kartelë krediti revolvuese
e licencuar nga Visa dhe
e përshtatur për nevojat
e klientëve tanë premium.

100,000

pagesa të bëra

€500,000

pagesa nga klubi i besnikërisë

45%

të pjesës së tregut të transaksioneve

Pasqyrimi i pasionit tonë për inovacion

Pasqyrimi i pasionit tonë për inovacion
Duke ndjekur qëllimin tonë për një shoqëri pa para të gatshme, ne vazhdimisht synojmë të ofrojmë produkte dhe shërbime më të mirat në kategorinë e tyre që pasqyrojnë pasionin tonë për risi. Ky fokus ka pasur si rezultat një shumëllojshmëri të produkteve dhe shërbimeve të reja që na frymëzojnë të punojmë edhe më shumë për ndërtimin e të ardhmes për klientët tanë dhe për Bankën.

Këtë vit ne kemi prezantuar kartelën e re Starcard Premium, që gjithashtu është kartelë revolvuese e licencuar nga Visa dhe e përshtatur për nevojat e klientëve tanë premium. Kartela ka të gjitha tiparet standarde të Starcard por ka vlerë të shtuar, si bonuse shtesë për besnikëri të klientit dhe zbritje në sektorët e zgjedhur.

Si Bankë në ballë të promovimit të një kulture të kursimit dhe për të nxitur shprehitë e kursimit, TEB ka prezantuar një produkt të ri - kursimet nëpërmjet kredit kartelës. Ky funksion u mundëson klientëve ta përdorin kartelën si mjet kursimi dhe të krijojnë urdhra të përhershëm për të ndarë rregullisht mënjane para në llogaritë e tyre ose të fëmijëve të tyre.

Çdo gjë që e bëjmë është e përqendruar që t'u përshtatemi më shumë klientëve. Në vend se të presin në radhë në degë, klientët tani mund të barazojnë Starcardën e tyre duke përdorur bankomatin. Ky është një opsion i ri përveç mundësisë për ta barazuar kartelën duke përdorur e-banking. Klientët tanë mund të paguajnë deklaratat e tyre dhe të barazojnë Starcardën për klientët e tjerë në çdo kohë, kudo që janë.

Për të ofruar shërbim edhe më të mirë për klientë, ne kemi zgjeruar ekipin dhe aktivitetet e shitjes direkte. Ne jemi tani edhe më afër klientëve dhe të aftë për t'iu përgjigjur më shpejt dhe më besueshëm nevojave të tyre. Ekipi i shitjes direkte është gjithashtu në dispozicion për të ofruar informacion për oferta speciale për të cilat mund të ketë të drejtë klienti dhe për produktet dhe shërbimet e reja të vëna në dispozicion nga Banka dhe të cilat TEB mendon që mund të jenë me interes dhe në dobi të klientit.

Qendra jonë e thirrjeve vazhdon të ofrojë shërbim të shkëlqyer për klientë 24 orë në ditë. Gjatë vitit 2013, qendra e thirrjeve ka trajtuar më shumë se 80,000 telefonata me kohë mesatare të trajtimit prej 95 sekondash.

Flamurtar në biznesin e kartelave

Në botën e sotme afariste me teknologji të përparuar, transaksionet e sigurta elektronike që i përshtaten edhe klientit dhe tregtarit kanë qenë një nevojë themelore. Dhe kjo është thelbësore për të krijuar një mjedis për rritjen ekonomike.

TEB është krenare jo vetëm për lëshimin e kredit kartelave me këste të para nga të gjitha në Kosovë por edhe për ruajtjen e pozitës udhëheqëse në treg. Në fund të vitit 2013, ne patëm lëshuar 100,000 kredit kartela që shërbehen me një sistem të pagesave mbarëkombëtar dhe vazhdimisht në zgjerim të përbërë nga 49 bankomate dhe 3,434 terminale POS.

Starcard, një kredit kartelë revolvuese e licencuar nga Visa, mbetet kartela që ka revolucionarizuar dhe vazhdon të revolucionarizojë shpenzimet e klientëve në Kosovë. Përveç se është kredit kartela e parë me këste në Kosovë, karakteristikat tjera 'të para' janë gjithmonë duke u shtuar ashtuqë Starcard mbetet flamurtare në treg.

Performanca jonë si Yll këtë vit

Banka ka vazhduar të gjenerojë rritje në numrin e transaksioneve dhe vëllim për të gjitha kartelat. Vetëm numri i transaksioneve përmes terminaleve POS është rritur për 24% në krahasim me vitin e kaluar, duke i dhënë TEB-it 45% të tregut. Qarkullimi i përgjithshëm është rritur për 38%. Tarifat dhe komisionet që lidhen me mirëmbajtjen dhe përdorimin e kartelave janë shumë konkurruese dhe ne gjithashtu ofrojmë një gamë të transaksioneve ku nuk ngarkohet fare tarifë, të tilla si pagesat online dhe blerjet ndërkombëtare me kredit kartelë.

Në partneritet me klientët tanë tregtarë, TEB ka vazhduar të shpërblejë klientët e saj të rregullt përmes një programi të bonusit të besnikërisë. Gjatë vitit 2013, ky program ka krijuar mbi 500,000 € që janë shpërndarë më pas si pikë bonus për kartela apo në forma të tjera. Pikët bonus të kredituara në kartelë mund të përdoren si pagesë për mallra dhe shërbime.

Gjatë vitit 2013, TEB ka vazhduar të organizojë fushata të përshtatura që përmbajnë këste shtesë, periudhë mospagimi (grejs periudhë), dhe produkte bonus, si dhe aktivitetet me partnerë.

Futja në treg e kartelave dhe pagesave me kartelë po arrin rezultate të jashtëzakonshme. Megjithatë, mangësia është natyrisht, mashtrimi me kartela që vazhdon të përhapet në mbarë botën. Departamenti ynë vigjilent i kartelave kryen monitorimin në kohë reale për të identifikuar çdo përpjekje për mashtrim. Kjo është një situatë dyfish e favorshme sepse i mbron mbajtësit e kartelave ndërsa duke siguruar standardet më të larta të parandalimit të mashtrimit. Numri i tentimeve të transaksioneve me kartelat tona është nën limitin e sektorit; megjithatë, si një masë shtesë, teknologjia e çipave në debit kartela është zëvendësuar me autentifikimin dinamik të të dhënave (DDA).

Si korporatë qytetare e përgjegjshme dhe në përputhje me aspiratat tona për të qenë model në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, TEB rekomandon fuqimisht e-deklaratat për klientët për të ulur përdorimin e letrës. Kjo përpjekje ka arritur një rritje të përdorimit të e-deklaratave në 53%. Ne parashikojmë që kjo rritje do të kursejë rreth 220 drunj në vit.

Plotësojini dëshirat duke
e çliruar imagjinatën

Çka më tutje?

Në vitin 2014, ne me siguri do të mbetemi udhëheqës në biznesin e kartelave. Qëllimi ynë kryesor do të jetë për të zhvilluar dhe lehtësuar mënyrat se si njerëzit bëjnë dhe pranojnë pagesa duke futur produkte dhe shërbime të reja dhe të zgjeruara për biznesin tonë dhe për klientët individualë. Për më tepër, programi ynë i bonuseve për besnikëri do të zgjerohet për të përfshirë transaksionet me debit kartela përmes terminaleve tona POS, duke gjeneruar përfitime shtesë për mbajtësit e debit kartelave tona.

FINANCAT TREGTARE

Në TEB, e dimë rëndësinë dhe sfidat e bizneseve në një botë të globalizuar. Prandaj, ofrojmë një gamë të plotë të produkteve dhe shërbimeve financiare tregtare për klientët me aspirata që tejkalojnë kufijtë.

Të bësh ndryshim

Eksportuesit duhet të sigurojnë se paguhet për mallrat që ata dërgojnë dhe importuesit duhet të sigurojnë që i marrin mallrat për të cilat kanë paguar. Ky shkëmbim është i bazuar në pagesa dhe transaksione të sigurta. Dhe kjo është arsyeja pse të gjitha produktet dhe shërbimet tona janë të dizajnuara për të lehtësuar transaksionet efikase dhe transparente. Klientët tanë më tej përfitojnë nga qasja jonë në përvijën e gjerë ndërkombëtare dhe në rrjetet e TEB AS dhe BNP Paribas. BNP Paribas renditet ndër tre bankat më të mira në botë dhe është institucioni kryesor financiar i Evropës në drejtim të financave të tregtisë ndërkombëtare. Sot, ai është aktiv në 80 vende dhe ka krijuar qendra tregtare në më shumë se 100 vende.

Ashtu si gjithë personeli ynë, ekipi ynë i financave tregtare është i angazhuar në arsim të përhershëm, duke përfshirë programet e mësimi elektronik (e-learning) të krijuara nga BERZH dhe Oda Ndërkombëtare Tregtare (ONT). Qëllimi i këtyre programeve është që të arrijnë

praktikat më të mira ndërkombëtare në financat tregtare edhe duke i kuptuar plotësisht rregullat tregtare të ONT-së.

Nga produktet dhe shërbimet tradicionale të financimit të tregtisë deri te zgjidhjet e përshtatura sipas rastit, ne ofrojmë një gamë të gjerë të produkteve për operacionet e biznesit dokumentar, duke përfshirë edhe letër kreditë e importit dhe eksportit, skontim në letër kredi, garanci vendore dhe ndërkombëtare, letër kredi në pritje (stand-by) dhe arkëtime dokumentare. Për më tepër, ekspertiza jonë e gjerë do të thotë që ne mund të krijojmë produkte inovative dhe fleksibile sipas nevojave të tregut. Strategjia jonë është që t'u ofrojmë klientëve zgjidhje të kuptueshme dhe të zbatueshme lehtë që ulin rrezikun dhe shpenzimet. Nëpërmjet kësaj qasjeje, ne kemi krijuar tashmë një reputacion të fortë si një partner i besueshëm i biznesit, siç tregon rritja e vazhdueshme e portfolios dhe numrit të transaksioneve.

Gjithmonë ju ofrojmë zgjidhjen e duhur.

Performanca jonë këtë vit

Në vitin 2013, ne kemi vazhduar të përkrahim klientët tanë, duke krijuar dhe përshtatur zgjidhje të financave të tregtisë për nevojat e tyre të biznesit. Për më tepër, ne kemi punuar vazhdimisht në zgjerimin e rrjeteve tona, forcimin e marrëdhënieve me bankat e tjera, dhe ngritjen e mëtejme të standardeve tona të larta të profesionalizmit dhe kompetencës. Përkrahur nga prania globale dhe ekspertiza në tregtinë ndërkombëtare e BNP Paribas dhe TEB A.Ş., ne vazhdimisht zgjerojmë mbulimin tonë gjeografik dhe gamën e produkteve tona. Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2011 me programin e tregtisë së Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC-së) na ka dhënë një mundësi të mirë dhe më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur kërkesës në lidhje me letër kreditë e konfirmuara dhe kundër garancitë. Gjatë vitit raportues, ne gjithashtu kemi zgjeruar më tej marrëdhëniet tona me banka të reja korrespondente.

Në vitin 2013, transaksionet e kryera për klientët tanë të financave tregtare u rritën për 32% në krahasim me vitin 2012. Ka pasur një rritje të letër kredive prej 27% dhe rritje të letërgarancive prej 32%.

Çka më tutje?

Në përputhje me qëllimet tona strategjike të qëndrueshmërisë, ne do të vazhdojmë të rrisim në maksimum potencialin tregtar të klientëve tanë duke investuar në zhvillimin dhe financimin e produkteve tregtare. Këto produkte mund të veprojnë edhe si ulje e rrezikut në kohë reale.

Duke përmirësuar vazhdimisht efikasitetin e shërbimeve tona, ne zvogëlojmë kërkesat e klientëve tanë për para dhe përkrahim përmirësimin e menaxhimit të likuiditetit. Ne synojmë që të kemi produkte më efektive dhe produktive të tregtisë së jashtme dhe po vazhdojmë të rrisim rrjetin tonë të bankave korrespondente për të zgjeruar kanalet tona.

MENAXHIMI I PARASË DHE SISTEMET E PAGESAVE

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse ne jemi duke investuar shumë në kanalet alternative të shpërndarjes duke zhvilluar dhe përmirësuar platformën tonë të shërbimeve bankare elektronike e-banking.

Në një kohë të progresit të shpejtë teknologjik, TEB është duke e mbajtur ritmin me të dhe duke parashikuar progres në menaxhimin e parasë dhe sistemet e pagesave duke vazhduar të shtojë kanale të reja të pagesave dhe mundësi për shërbime më të mira.

Menaxhimi ynë i parave dhe zgjidhjet për pagesa janë përshtatur për t'i ofruar klientëve tanë afaristë një gamë të produkteve dhe shërbimeve që do ta rrisë likuiditetin. Ne sigurojmë infrastrukturën e duhur për përpunim të shpejtë dhe të sigurt të pagesave. Për më tepër, duke shfrytëzuar zgjidhjet tona të teknologjisë së fundit klientët tanë krijojnë kursime të kostos dhe përfitojnë nga optimalizimi i shpenzimeve operative direkte dhe indirekte.

TEB ka futur e para sistemin e debitimit direkt (SDD). SDD është një produkt unik në tregun e Kosovës që është projektuar për të përkrahur bashkëpunimin komercial B2B (biznes me biznes). Funksioni i tij kryesor është për të përmirësuar likuiditetin financiar të klientëve tanë të biznesit duke ofruar menaxhimin e plotë të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme. Ai konsiderohet si sistemi më efektiv i menaxhimit të rrjedhës së parasë pasi përkrahet nga teknologjia e fundit dhe ndërlihdhet ndërmjet sistemeve për të lehtësuar procesimin e plotë dhe automatik të pagesës së faturave. Kjo i mundëson klientëve që të na autorizojnë për të debituar (tërhequr) automatikisht mjete direkt nga llogaria e tyre bankare për të bërë pagesa të ndryshme mujore për kompani të ndryshme publike dhe private. Nevojitet vetëm një formular i autorizimit (i nënshkruar nga klienti) dhe transaksioni përkatës do të kryhet automatikisht. Klientët me SDD marrin linjë kreditore të dedikuara që mundëson pagesat për furnizuesit dhe garanton se kushtet e pagesës së faturës respektohen plotësisht. Hapi tjetër logjik ishte futja e skontimit të SDD që garanton të arkëtueshmet. Duke zbatuar skontimin SDD, klienti konsolidon financat dhe përfiton nga inkasimi i hershëm i të arkëtueshmeve.

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse ne jemi duke investuar shumë në kanalet alternative të shpërndarjes duke zhvilluar dhe përmirësuar platformën tonë të shërbimeve bankare elektronike e-banking. Shërbimi ynë ultra-modern online shfrytëzon sistemet më të avancuara të sigurisë dhe jep qasje në shërbimet bankare të sigurta, të përshtatshme dhe të shpejta 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Klientët tanë mund të transferojnë fondet në mënyrë elektronike te përfituesit në mbarë botën dhe të procesojnë pagesa vendore, duke përfshirë pagesën e komunalive dhe debi të tjera të rregullta, (si rryma, uji dhe telefoni). Për më tepër, klientët mund të zgjedhin edhe për të bërë pagesat për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) automatikisht duke përdorur e-banking.

Sot, transferet e shpejta dhe të sigurta ndërkombëtare të parave janë me rëndësi të madhe për klientët me ambicie që tejkalojnë kufijtë. Kjo është arsyeja pse ne ofrojmë një shërbim që është mënyra më e lehtë, më e shpejtë dhe më e besueshme për të bërë pagesa ndërkombëtare. Nëpërmjet rrjetit tonë të gjerë të mbi 150 marrëdhënieve korrespondente të huaja dhe 30 bankave për plasim, pagesat ndërkombëtare dalëse mund të kryhen për përfituesit e huaj në të gjithë botën. Si anëtar i SWIFT-it, rrjetit më të madh në botë të pagesave, klientët tanë gëzojnë një përparësi të qartë, sidomos në pagesat ndërkombëtare dalëse. Pagesat ndërkombëtare hyrëse mund të menaxhohen duke përdorur të njëjtin sistem. Kjo do të thotë që ne jemi në gjendje të ofrojmë shërbime të pagesave që janë udhëheqëse në treg, gjithashtu nëpërmjet aktiviteteve të brendshme shumë efektive dhe përmes zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit tonë global.

Jeta nuk ka të bëjë me gjetjen e vetvetes.
Ajo ka të bëjë me krijimin e vetvetes.



Performanca jonë këtë vit

Në vitin 2013, ne rritëm vëllimin dhe numrin e pagesave, edhe si rezultat i më shumë transaksioneve të procesuara direkt. Ne besojmë se kjo rritje tregon një nivel në rritje të vlerësimit të shërbimeve tona nga klientët tanë. TEB përsëri ka marrë njohje ndërkombëtare kur Deutsche Bank na shpërbleu me Çmimin e Ekselencës STP për pagesat dalëse në vitin 2012 me përqindjen e jashtëzakonshëm të 100% për vitin e tretë radhazi.

Gjatë vitit raportues, Shoqata për telekomunikimin botëror ndërbankar financiar (SWIFT) ka caktuar një kod të veçantë të përkohshëm të shtetit për identifikimin e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës. Ne menjëherë filluam të përshtatim sistemin tonë për SWIFT kodin e ri, duke planifikuar zbatimin për të siguruar se nuk do të ketë ndërprerje të shërbimeve. Që nga data 9 dhjetor 2013, kodi ynë është TEBKXKPR.

Çka më tutje?

Ne jemi të përkushtuar për të përmirësuar më tej përvojën e klientëve duke ofruar zgjidhje superiore të menaxhimit të parasë dhe pagesave të ndërtuara në infrastrukturën tonë të avancuar teknologjike. Pra, ne do të përqendrohemi në zhvillimin dhe përmirësimin e kanaleve alternative të shpërndarjes si platforma për zgjidhje dhe shërbime fleksibile që do ta lehtësojnë punën për klientët tanë.

Kemi vetëdije të mirëzhvilluar për rreziqet dhe vazhdimisht monitorojmë dhe menaxhojmë rreziqet e likuiditetit, palëve të tjera, valutave të huaja, portfolios së të ardhurave fikse dhe normës së interesit që mund të shfaqen nga operacionet rutinore.

Edhe pse 2013 ishte një vit me shumë ndodhi dhe sfidues për sektorin bankar, Departamenti i MPD dhe i Thesarit ishte prapë në gjendje për të dhënë rezultate të suksesshme. Ky departament ka për detyrë të financojë detyrimet tona dhe të menaxhojë çmimet standarde në tregje, si dhe të monitorojë rrezikun operacional dhe strukturor të likuiditetit, rrezikun e valutës së huaj dhe rrezikun e normës së interesit.

Një nga qëllimet tona kryesore është të sigurojmë që Banka ka një sasi të mjaftueshme të likuiditetit – para në dispozicion - për financimin e transaksioneve dhe detyrimeve dhe që ne mund të paguajmë detyrimet për klientët ndërsa të rrisim në maksimum kthimin e përshtatur sipas rrezikut në afat më të gjatë. Kjo është arsyeja pse ne krijojmë strategji investuese dhe të financimit në bazë të kushteve mbizotëruese të tregut, normave të interesit, trendëve të vëllimit të zërave të bilancit të gjendjes dhe parametrave të rrezikut. Financimi ynë është i mirë dhe kapaciteti ynë për të bartur rrezikun është brenda kërkesave të udhëzimeve të përcaktuara me ligj dhe rregullatorë. Përveç kësaj, Banka ka plane të zbatueshme për raste emergjente për të menaxhuar zhvillimet e paparashikuara të tregut ose ndikimet e tjera të jashtme të ndryshueshme.

Menaxhimi i rrezikut

Ne kemi vetëdije të zhvilluar mirë për rreziqet e mundshme dhe vazhdimisht monitorojmë dhe menaxhojmë rrezikun e likuiditetit, palëve tjera, valutës së huaj, portfolios së të ardhurave fikse dhe normës së interesit që mund të shfaqet nga aktivitetet tona

rutinore. Ne vazhdojmë të punojmë afër me TEB A.Ş., duke përfutur nga parashikimet e sakta të tregut, veçanërisht për menaxhimin e normave të interesit dhe dallimit të likuiditetit. Kontrolli i brendshëm i rreptë është çelësi për të gjitha aktivitetet tona të thesarit. Ne kemi zhvilluar dhe vendosur praktika të kujdesshme që zvogëlojnë dhe zbusin rrezikun në aktivitetet tona të menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve. Këto kryhen në përputhje me strategjinë e Bankës dhe biznesin e përgjithshëm me qëllim kryesor rritjen në maksimum të kthimit në kapital të rregulluar sipas rrezikut në TEB.

Në aspektin e menaxhimit të rrezikut, menaxhimi i likuiditetit dhe rreziqeve të lidhura me strukturën tonë të aseteve dhe borxheve vazhdojnë të monitorohen nga afër nga Komisioni i aseteve dhe borxheve dhe Komisioni i MPD. Komisionet takohen rregullisht për të monitoruar performancën dhe aktivitetet, për të diskutuar zhvillimet e tregut dhe trendet e parashikuara, dhe për të na udhëzuar për uljen e rreziqeve në kornizën e caktuar nga Bordi i Drejtorëve dhe në përputhje me kërkesat rregullative; Banka i është përgjigjur të gjitha ndryshimeve në kërkesa dhe vepron në përputhje të plotë me të gjitha dispozitat rregullative.

Në vitin 2013, Qeveria e Kosovës ka vazhduar të nxjerrë bono thesari me kohëzgjatje deri në një vit. Shuma totale në ankand ishte 80.2 milion € dhe portfolio totale e mbetur arriti në 154.2 milion €. Banka përsëri mori pjesë si tregtar primar. Qeveria ka shpallur se do të fillojë lëshimin e letrave afatmesme me vlerë (deri në dy vjet) të qeverisë në vitin 2014 dhe ne jemi duke paraparë pjesëmarrjen si tregtar primar.

E ardhmja krijohet nga ajo që bëni sot,
jo nesër

TEATRI KOMBËTAR

NATIONAL THEATRE

Çka më tutje?

Kur shikojmë përpara, aspirata jonë është që të përqendrohen përpjekjet dhe përkushtimi ynë në zhvillimin e produkteve dhe mundësive të reja për Bankën dhe klientët tanë. Me ekspertizën tonë të kombinuar dhe përvojën në tregun e brendshëm dhe njohuritë ndërkombëtare dhe forcën e grupit, ne po shikojmë përpara për të krijuar një treg sekondar. Kjo do t'u japë klientëve tanë mundësi për të blerë bono thesari dhe letra me vlerë në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare. Një sfidë për vitet e ardhshme është shfrytëzimi i transaksioneve potencialisht më komplekse, të tilla si transaksionet e riblerjes-të anasjellta të riblerjes, dhe krijimi i mundësive atraktive të biznesit në tregjet e parave ose të kapitalit.



BURIMET NJERËZORE

Ndjenja e përkatësisë

Banka operon në një mjedis me ritëm të shpejtë që vazhdimisht evoluon dhe nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë ndryshojnë me të njëjtin ritëm. Në vitet e fundit, zhvillimet në sektorin bankar kanë pësuar ndryshime të mëdha dhe dinamike që kanë pasur gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në një nga pasuritë tona më të vlefshme, punonjësit tanë.

Në këtë sfond, kohezioni, krenaria e përkatësisë dhe ndarja e vlerave thelbësore - kreativiteti, përgjigjet ekspeditive, ambicia dhe përkushtimi - janë bërë një përparësi kryesore strategjike. Ato na kanë ndihmuar të konsolidohemi më tej si një organizatë dhe kanë hapur rrugën për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme. Kolegët tanë kanë treguar elasticitet të madh dhe janë ngritur para sfidave me produkte të reja, udhëheqëse në treg dhe shërbime të shkëlqyera drejtpërdrejt me klientët.

Promovimi i diversitetit përfshirës

Si një punëdhënës me përgjegjësi sociale dhe mbrojtës aktiv i diversitetit, ne ofrojmë qasje të barabartë në punësim për të gjithë, pavarësisht nga gjinia ose etnia. Diversiteti i prejardhjes së të punësuarve tanë, përvoja, perspektiva dhe të menduarit kritik formon bazën e rritjes dhe ndikon pozitivisht në performancën organizative. Rekrutimi është vetëm hapi i parë. Gjatë gjithë marrëdhënies sonë të punës, ne përkrahim ambiciet e punonjësve tanë që të rriten dhe të zhvillohen

përmes një kulture proaktive dhe të veçantë të korporatës që refuzon paragjykimin, madje edhe atë të pavetëdijshëm. Mjedisi ynë i larmishëm dhe gjithëpërfshirës i punës stimulon kolegët për të përmbushur potencialin e tyre duke siguruar trajtim të barabartë. Ne besojmë se punonjësit e angazhuar janë entuziastë, të përkushtuar për një qëllim të përbashkët dhe një grup të vlerave dhe sjelljeve, dhe janë krenarë që kontribuojnë në suksesin e Bankës.

Punësimi aktiv

Pavarësisht mjedisit sfidues operativ, ne kemi vazhduar të punësojmë kolegë të rinj. Në vitin 2013, ne kemi marrë 177 talentë të rinj, dinamike e energjik me moshë të re dhe me përvojë. Ata tashmë kanë dëshmuar se përshtaten vërtet me kulturën tonë afariste dhe janë duke kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të Bankës. Nga ana tjetër, ne ofrojmë një paketë konkurruese të përfitimeve dhe mundësi reale për karrierë. Në fund të vitit 2013, TEB përfshinte 555 të punësuar me orar të plotë.

Si pjesë e shtytjes sonë për të punësuar studentët më të talentuar dhe të diplomuarit e fundit, ne kemi nisur një program të praktikantëve. Në vitin 2013, si pjesë e këtij programi për punë-studim, ne kemi prezantuar sektorin bankar të 100 pjesëmarrës në vitin 2013. Qëllimi ynë ishte që të shpjegojmë rolin e bankave në ekonomi dhe ndikimin e tyre të mundshëm në shoqëri. Më tutje pjesëmarrësit ishin në gjendje të njihen me produktet bankare dhe konceptet kryesore.



Kurrë s'do ta dini sa të fortë jeni pa u bërë pjesë e jona.

Ndërtimi i kompetencave individuale dhe organizative

Qasja e TEB-it e fokusuar te klienti do të thotë që ne duhet të tërheqim dhe të mbajmë talentin më të mirë. Ne e përkthejmë këtë në veprim duke u dhënë njerëzve mundësi për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe çuar përpara perspektivën e karrierës së tyre. TEB ka krijuar një program të strukturuar të zhvillimit për këtë qëllim. Për më tepër, vlerësimi i performancës merr formën e një dialogu dhe diskutimeve me reagime në mënyrë që ne të punojmë me punonjësit individualë për të vendosur prioritetet e fushave për zhvillim apo përmirësim. Ne gjithashtu ofrojmë stimulime për sukses dhe avancim në karrierë. Një shtytës i vazhdueshëm i programit tonë të trajnimit dhe zhvillimit të aftësive është ndërtimi i besnikërisë dhe motivimit afatgjatë të punonjësve.

Gjatë vitit 2013, ne kemi ofruar përfshirjen për të punësuarit e rinj dhe kurse për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive për punonjësit tanë. Në total, ka pasur 14,500 orë të programeve të brendshme dhe të ngjarjeve të jashtme. Mesatarisht, çdo punonjës mori pjesë në 3.5 ditë trajnimi brenda vendit të punës.

Përveç trajnimit në vend të punës, ne kemi prezantuar mundësi të reja mësimi, duke përfshirë mësimin elektronik (e-learning) dhe hyrjen në portalet e intranetit të Grupit si mjete ndër-funksionale për të përkrahur qasjen dinamike dhe të personalizuar në burimet e trajnimit dhe zhvillimit.

Politika konkurruese e kompensimit

Performanca, talenti, idetë, risitë dhe zhvillimi i çdo punonjësi gjithmonë atribuohet dhe njihet në TEB. Njerëzit tanë shpërblehen për kontributin e tyre në suksesin e Bankës nëpërmjet një kombinimi të pagesës së fiksuar, stimulime në bazë të arritjes së caqeve (target-eve), një shumëllojshmëri të përfitimeve të tjera dhe stimulime dhe mundësi të tjera afatshkurtra dhe afatgjata.

Politika jonë e kompensimit është e bazuar në parimet e drejtësisë dhe transparencës që pasqyrojnë përkushtimin

tonë për ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me punonjësit tanë.

Punonjësit tanë përfitojnë edhe nga qasja në disa produkte dhe shërbime bankare me terma dhe kushte preferenciale. Në këtë mënyrë, ne kontribuojmë për mirëqenien e tyre dhe familjeve të tyre duke çmuar përkushtimin dhe besnikërinë e tyre. Dhe duke u bërë vetë 'klientë', ata vihen gjithashtu në situatë për të përjetuar përvojën e plotë të TEB-it.

Fryma inovative

Inovacioni është një nga komponentët tona kryesorë strategjike. Ne presim që të punësuarit tanë të zhvillojnë produkte dhe shërbime inovative nëpërmjet kontaktit të tyre të përditshëm me klientët. Megjithatë, ne mbajmë dyert e hapura për inovacion të përgjegjshëm nëpërmjet konkurseve në të cilët mund të marrin pjesë të gjithë të punësuarit, pavarësisht nga pozita e tyre në Bankë.

Ne shohim inovacionin jo vetëm si një mjet për të shtuar vlerë për klientët tanë, por edhe si një mundësi për të përmirësuar ndikimin e mjedisit - një nga projektet e propozuara nga punonjësit ishte përmirësimi i performancës së energjisë dhe zvogëlimi i gjurmëve të karbonit.

Ju kursejmë kohë që ta
shijoni bukurinë e jetës.

Çka më tutje?

Punonjësit tanë formojnë themelet e Bankës që kemi aspirata të jemi. Duke jetuar vlerat tona dhe duke respektuar në çdo kohë etikën tonë, ne jemi bërë një partner i besuar për klientët tanë dhe një vend ku njerëzit e talentuar dhe dinamikë preferojnë të punojnë. Duke krijuar një mjedis pune stimulues me mundësi reale për zhvillimin e karrierës, ne bëhemi një organizatë që inspiron shërbim të gjatë dhe një dëshirë për të kontribuar në objektivat e përbashkëta.

Kur shikojmë përpara, fokusi ynë do të mbetet në strategjitë dhe investimet zhvillimore për të rritur motivimin dhe besnikërinë e punonjësve për afat të gjatë. Ne do të përqendrohemi në zhvillimin dhe ofrimin e mundësive për trajnim dhe mjeteve tjera të zhvillimit që përqendrohen në aftësitë e drejtpërdrejta dhe rritjen e lëvizshmërisë së brendshme. Një nga prioritetet kryesore është krijimi i një programi për identifikimin e talentëve dhe zhvillimin e orientuar për të siguruar vazhdimësinë e aftësive dhe ekspertizës dhe që do të na ndihmojë të krijojmë një plan të fuqishëm të vazhdimësisë së punës.

Për shkak se ne e vlerësojmë dhe synojmë të frymëzojmë motivimin dhe ndjenjën e përkatësisë, ne do të shfrytëzojmë çdo mundësi për të bartur kulturën tonë dhe për të shpërndarë vizionin strategjik të Grupit, duke i mbajtur kolegët tanë të informuar mbi zhvillimet në tregjet ku ne punojmë.

ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I PROCESHEVE

Në një botë me ndryshime marramendëse, është genësore që Banka të ketë largpamësi dhe pjekuri për të parashikuar dhe për t'iu përshtatur ndryshimeve të rrethanave.

TEB me të drejtë mburret me reputacionin dhe pozitën e saj udhëheqëse në Kosovë.

Ne besojmë se të fitosh besimin e klientëve është shumë e vështirë, por ta mbash atë është edhe më e vështirë. Kjo është arsyeja pse ne jemi të motivuar vazhdimisht për të fituar besimin dhe besnikërinë. Dhe ne besojmë se ky është fokusi i vazhdueshëm që na dallon nga kolegët tanë. Ne jemi të angazhuar në një kërkim të pafund për të krijuar procese edhe më të mira që na ndihmojnë për të arritur përsosmërinë për klientë në bazë të efikasitetit të pashembullt dhe të drejtuar kah krijimi i vlerës më të mirë për klientët tanë.

Kryesore për këtë arritje është zhvillimi i një strukture organizative elastike dhe të shkathët që është në gjendje të përshtatet dhe të bëjë ndryshime lehtësisht në të gjitha proceset e biznesit. Një strukturë e tillë organizative formon bazat për një kulturë pozitive dhe produktive që në mënyrë eksplicite inkurajon diversitetin e mendimeve dhe ideve që nxisin krijimtarinë dhe inovacionin. Duke pasur këtë në mendje ndërsa ne hapim rrugën për rritje në të ardhmen, në vitin 2013 TEB ka ngritur një njësi të re organizative përgjegjësie kryesore e së cilës është të sigurojë infrastrukturën dhe kapacitetet e domosdoshme për zbatimin

e këtyre aktiviteteve. Kjo njësi do të punojë në mënyrë proaktive për të kuptuar dinamikën e së ardhmes. Kjo pastaj do të formojë bazën për zhvillimin organizativ dhe do të veprojë si një katalizator për analiza të vazhdueshme dhe ridizajnim të proceseve, në përputhje me strategjinë e biznesit të Bankës. Puna e njësisë ka filluar tashmë, por më shumë vull do të fitohet në vitin 2014. Si një kontribues në profitabilitetin e Bankës dhe si palë e interesuar për të bërë që klientët të jenë të kënaqur, aktivitetet në fokus të njësisë do të jenë ridizajnimi i proceseve që ndikon te klientët tanë dhe mund të shkaktojnë vonesa në shërbimin tonë. Proceset aktuale të biznesit do të analizohen për të identifikuar pengesat, komponentet e panevojshme me kosto dhe detyrat që nuk shtojnë vlerë. Më pas, ne do të ridizajnojmë proceset për të rritur efikasitetin (e koston), për të zvogëluar në minimum pengesat operative, dhe për të parandaluar rrezikun e pakënaqësisë së klientit. Ne kemi identifikuar tashmë një proces prioritar për të përmirësuar efikasitetin. Do ta shkurtojmë kohën tashmë të shkurtër për transaksione për të arritur një situatë të favorshme për të gjithë që përmirëson përvojën dhe kënaqësinë e klientit duke kontribuar pozitivisht në produktivitetin dhe profitabilitetin e brendshëm.

15



TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Teknologjia është bërë me shpejtësi një pjesë përbërëse e mënyrës se si ne kryejmë shërbimet bankare. TEB ka qenë një forcë shtytëse dhe pioniere në avancimet e teknologjisë së fundit për klientët tanë në Kosovë. Ne kemi nisur sistematikisht inovacione të integruara teknologjike për të siguruar që klientët tanë kanë qasjen e fundit në gamën e plotë të kanaleve të ofrimit të shërbimeve dhe shërbimeve bankare elektronike e-banking. Për klientët e TEB-it, kryerja e shërbimeve bankare te ne do të thotë se e ardhmja është këtu sot.

Inovacioni i sigurt teknologjik

Që kur TEB është themeluar në Kosovë, ne kemi qenë në ballë të inovacioneve teknologjike. Qëllimi ynë ka qenë gjithmonë për të përmirësuar përvojën e klientit duke parashikuar nevojat dhe produktet dhe shërbimet inovative për t'i përmbushur nevojat. Ky përkushtim për shërbimin për klientë na ka dhënë një pozicion udhëheqës në treg në Kosovë. Ne zhvillojmë produktet dhe shërbimet tona në bazë të zgjidhjeve të qarta që shtojnë vlerë që do të bëjë ndryshim për klientët tanë. Në të njëjtën kohë, të gjitha zgjidhjet janë të dizajnuara në mënyrë që të mos rezultojnë në kompleksitet infrastrukturë në rritje

që mund ta komprometojë sigurinë dhe besueshmërinë e sistemeve tona të informacionit. Ne kemi miratuar standardet ndërkombëtare më të mira në kategorinë e vet që na ndihmojnë të monitorojmë dhe sistematikisht të përmirësojmë arkitekturën dhe infrastrukturën e TI. Kjo siguron që të na ofrohet një mjet i integruar që siguron procesim të pandërprerë. Siguria është pjesë e sistemeve tona në mënyrë që klientët të jenë të mbrojtur nga qasja e paautorizuar ose depërtimi dhe ne të jemi të mbrojtur nga humbja e të dhënave.

Performanca jonë këtë vit

Në vitin 2013, ne kemi vazhduar të fusim risi në sistemet e pagesave. Tani, mbajtësit e kartelave tona mund të urdhërojnë transferimin e parave nëpërmjet rrjetit tonë të bankomateve gjatë 24 orëve ashtu siç iu përshtatet, pa pasur nevojë të presin në radhë në degë. Përveç kësaj, mbajtësit e kredit kartelave tona janë tani në gjendje për të barazuar kredit kartelën në bankomatet tona. Ne zbatuam ndryshimet e sistemit të aplikacioneve dhe infrastrukturës sonë të kartelave në mënyrë që të jemi në gjendje për ta futur kartelën e re Starcard Premium. Si një bankë përgjegjëse e përkushtuar për mirëqenien (e ardhme) të klientëve tanë, ne gjithashtu zbatuam një funksion të ri që u mundëson klientëve të ndajnë rregullisht para mënjanë në një llogari të kursimeve nëpërmjet urdhrat të përhershëm në kredit kartelë. Një tjetër shërbim i përshtatshëm është pagesa e faturave përmes një transferi ose shumë transference nga limiti i kredit kartelës së tyre përmes platformës e-banking.

Gjithashtu në vitin 2013, Shoqata për Telekomunikim Botëror Ndërbankar Financiar (SWIFT) ka caktuar një kod të veçantë të shtetit që do të përdoret për identifikimin e institucioneve

financiare të Kosovës. Ne i kemi përshtatur sistemet tona për të lansuar lidhjet me SWIFT pa asnjë ndërprerje në shërbimet për klientët.

Përsosmëria e shërbimit për klientë dhe ofrimi i produkteve dhe shërbimeve bankare pa të meta kërkon optimizimin e vazhdueshëm të proceseve dhe efikasitetin operativ. Përveç rritjes së efikasitetit dhe të shërbimit, TEB është gjithashtu plotësisht e përqendruar në sigurinë e sistemeve të informacionit dhe infrastrukturës. Gjatë vitit, janë zbatuar disa projekte për të siguruar disponueshmërinë, elasticitetin dhe aftësinë për të kthyer të dhënat me ndërprerje minimale në aktivitetet e biznesit. Për më tepër, këto projekte kanë zgjeruar më tej menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës sonë të TI. Ne kryejmë monitorim në kohë reale për zbulimin e hershëm të shkeljeve të sigurisë dhe kontrollimin e dëmeve bazuar në praktikatat më të mira në këtë industri. Në këtë mënyrë, ne mbrojmë klientët tanë dhe Bankën.

Qëndroni në lidhje, kurdo dhe kudo

Çka më tutje?

Në vitin 2014, TEB do të rrisë më tej pozitën tonë si banka me teknologjinë më të avancuar në Kosovë dhe aftësinë tonë për të përdorur për herë të parë produktet dhe shërbimet më të reja. Ne e shohim sfidën tonë të vazhdueshme si integrimin e njerëzve, proceseve dhe teknologjisë për të ofruar një përvojë superiore për klientët dhe për efikasitetin operacional.

Ne jemi të përkushtuar për të investuar në infrastrukturën tonë të TI si një gurthemel i rëndësishëm për përpjekjet dhe suksesin e bankës në të ardhmen. Në vitin 2013, kemi filluar një përmirësim sistematik të pajisjeve harduerike të TI në mënyrë që të rrisim performancën dhe efikasitetin duke rritur sigurinë dhe besueshmërinë e infrastrukturës. Ky program vazhdon në vitin 2014.

Ne planifikojmë të integrojmë më tej sistemet tona me institucionet për të përmirësuar më tej punën e klientëve dhe efikasitetin e shërbimit. Nëpërmjet marrëdhënieve tona të afërta me klientët, ne e kuptojmë jetën e tyre dinamike dhe jeta e shpejtë kërkon qasje 24 orë në shërbimet bankare. Si në të kaluarën, edhe në të ardhmen ne do të vazhdojmë të përkthejmë këto nevoja në zgjidhje dhe produkte të reja dhe kanale alternative të ofrimit të shërbimeve.

SIGURIA E INFORMACIONIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Sot, të gjitha aktivitetet afariste janë gjithnjë e më të varura nga disponueshmëria e informacionit dhe siguria e sistemeve të informacionit për të ruajtur dhe procesuar të dhënat e ndjeshme dhe të vlefshme. Kjo është arsyeja pse mbrojtja e duhur dhe saktësia e informacionit në pronësi të Bankës apo që i është besuar asaj në rrjedhën normale të punës sonë është një parakusht dhe një përparësi e madhe për TEB-in.

Qeverisja e informatave e bazuar në përgjegjësi

Për të siguruar fshehtësinë, integritetin dhe disponueshmërinë e informatave dhe sistemeve të informacionit, Banka përdor qeverisjen e informacionit të bazuar në përgjegjësi. Sipas këtij programi, ne përpiqemi për të balancuar mbrojtjen e informacionit, sigurinë dhe biznesin, ndërsa duke vepruar konform dhe duke respektuar të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe standardet më të larta ndërkombëtare.

Ne kemi vendosur rregulloret e brendshme të plota për të mbrojtur informatat dhe kemi përfshirë mbrojtjen e informacionit në të gjitha proceset e punës që direkt ose indirekt kërkojnë mbledhjen, përpunimin, qasjen, analizën, shpalosjen ose shkatërrimin e çdo informacioni. Qasja në informacion është rreptësisht e kufizuar vetëm për punë ose në bazë të nevojës për ta ditur ndërsa shpalosja dhe shpërndarja e të dhënave është e rregulluar në përputhje me kërkesat ligjore dhe miratimin dhe autorizimin individual.

Mbrojtja e të dhënave personale

Një sasi e madhe e informacionit që ne e ruajmë janë të dhënat personale të klientëve tanë. Ato mbledhen, përpunohen dhe ruhen si pjesë e marrëveshjes kontraktuale të Bankës me klientin për të ofruar dhe për të përdorur produktet dhe shërbimet bankare. Ne me zell i mbrojmë të gjitha të dhënat tona dhe kemi vendosur kontrolle të përpikta për të mbrojtur të drejtën e individit për privatesi, dinjitet dhe siguri.

Ne mbrojmë të dhënat personale me të gjitha mjetet në dispozicion dhe kemi qëllim ta bëjmë këtë për aq kohë sa të dhënat të jenë nën përkujdesjen tonë. Megjithatë, ne mund të shpalosim të dhënat nëse dhe kur kërkohet me ligj, ose me pëlqimin e individit, por jo përtej asaj që është e nevojshme për të ofruar një produkt apo shërbim. Klientët individualë mund të autorizojnë edhe delegimin e informacionit për një individ tjetër.

Gjatë vitit 2013, vetëm një ankesë nga klienti është dorëzuar në Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga një bazë e klientëve prej mbi 221,000. Agjencia arriti në përfundimin se Banka nuk ka dështuar për të siguruar mbrojtjen duke zbuluar të dhënat personale të ankuesit. Për më tepër, Agjencia kryen inspektime të rregullta mbi zbatimin e dispozitave ligjore për vëzhgimin me kamerë, përdorimin e pajisjeve biometrike, transferimin e të dhënave personale dhe hyrje-daljet nga lokalet tona. Ajo arriti në përfundimin se Banka i përmbahet të gjitha kërkesave ligjore dhe rregullative.



Përpiqemi t'ju ofrojmë rehati për
gjithçka që bëni.

BORDI I DREJTORËVE

MUSA ERDEN

Kryesues

Lindur në Hatay, Turqi në vitin 1950, Musa Erden ka diplomuar në Akademinë e Ankarasë të Shkencave Ekonomike dhe Tregtare, Departamenti Bankar. Ai e filloi karrierën e tij në Yapi Kredi Bank në vitin 1972. Filloi të punojë në Bankën Osmanli në vitin 1973, ku mbajti poste të ndryshme deri në vitin 2001, duke përfshirë Asistent Menaxher i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm (BD/CM), dhe Koordinator. Ai shërbeu si anëtar i Komitetit të Arbitrimit të Shoqatës së Bankave Turke nga 2002 deri në 2003; si drejtor i MNG Bankës në vitin 2003; si Kryesues i katër kompanive të Ndërtimit të Strukturave të Turizmit; dhe si drejtor i Ottoman Fund Ltd ndërmjet vitit 2006 dhe 2008. Ai hyri në TEB Group në vitin 2005 si Auditor i TEB A.Ş. dhe TEB Investimeve financiare dhe ka shërbyer si konsulent nga viti 2006 deri në emërimin e tij të tanishëm si anëtar i Bordit Ekzekutiv të TEB A.Ş. në vitin 2008. Z. Erden u emërua Kryetar i Bordit të Drejtorëve të TEB Sh.A. në dhjetor 2010. Nga marsi 2011, ai është edhe ushtrues detyre i kryetarit të TEB Factoring dhe, nga viti 2010, anëtar i Bordit të BNP Paribas Leasing.

ALP YILMAZ

Kryeshef ekzekutiv

I lindur në Stamboll, Turqi në vitin 1965, Alp Yılmaz diplomoi në Fakultetin për Administrim Biznesi të Universitetit Dokuz Eylul, dhe mori Diplomën Master i Arteve (Master of Arts – MA) në Fakultetin e Shkencave Administrative (Administrim Biznesi) në Universitetin e Stambollit. Ai e filloi karrierën e tij profesionale në Bankën Turke për Zhvillim Industrial si analist financiar në vitin 1991. Ai ka shërbyer si Auditor në Kocbank A.Ş. nga viti 1992 deri në vitin 1995. Në TEB A.Ş. hyri në vitin 1997 dhe ka punuar në departamente të ndryshme, duke përfshirë Shitjet & Marketingun, Buxhetin dhe Kontrollin Financiar dhe Menaxhimin e Parave. Nga viti 2007 deri në vitin 2012, ai shërbeu si anëtar i Bordit dhe Kryeshef Ekzekutiv i TEB Sh.A, dhe gjatë qëndrimit të tij ka qenë edhe zëvendës-kryetar i Odës Ekonomike Kosovaro-Turke, anëtar i Bordit të Odës Ekonomike Kosovaro-Franceze dhe anëtar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës. Në janar 2013, ai dha dorëheqjen si Kryeshef Ekzekutiv i TEB Sh.A. për të marrë një emërim si Këshilltar i KE të TEB A.S (Turqi). Që nga 11 prilli 2013, ai u emërua si Zëvendës-Kryesues i TEB Sh.A. dhe Kryesues i Komitetit të Kompensimit i TEB Sh.A.

AYSE ASARDAG

Anëtare e Bordit

E lindur në Ankara, Turqi në vitin 1964, Ayse Aşardağ u diplomua nga Departamenti i Administrimit të Biznesit të Universitetit Bogazici në vitin 1987. Ajo u certifikua si kontabiliste e certifikuar nga Instituti i Kontabilistëve i Anglisë dhe Uellsit, ACCA, në vitin 1992. E filloi karrierën e saj profesionale në Price Waterhouse dhe punoi në Njësinë e Auditimit në zyrat në Stamboll dhe Londër ndërmjet vitit 1987 dhe 1994. Znj. Aşardağ ishte ligjëruese e kontabilitetit në Universitetin e Glamorgan nga viti 1994 deri në 1995. Në vitin 1995, ajo hyri në Njësinë e Buxhetit dhe Kontrollit Financiar në TEB deri në vitin 2001. Që nga ajo kohë, ajo ka qenë Zyrtares Kryesor Financiar i TEB Group në TEB Holding. Znj Aşardağ aktualisht shërben si anëtare e bordit të TEB A.Ş., anëtare e Bordit dhe anëtare e Komitetit të Auditimit të TEB NV, TEB Factoring dhe TEB Investimet, dhe është anëtare e Bordit të Menaxhimit të Aseteve të TEB. Ajo u emërua si Zëvendës-Kryesuese e TEB Sh.A. në vitin 2007. Nga dhjetori 2007, Znj Aşardağ është Anëtare e Bordit dhe Kryesuese e Komitetit të Auditimit të TEB Sh.A.

DIDIER A.N. VAN HECKE

Anëtar i Bordit

I lindur në Bruksel, Belgjikë në vitin 1970, Didier Van Hecke u diplomua në Inxhinieri Biznesi në Universitetin Katolik të Leuvenit. Ai e filloi karrierën e tij profesionale si praktikant i menaxhmentit në Generale Bank në vitin 1992. Ai ka shërbyer si Analist Kreditor (Kreditë për korporata) nga 1993 deri në 1996 dhe si shef i analizës kreditore (kreditë për korporata) nga 1996 deri 1999 në Generale Bank. Pas bashkimit në Fortis Bank, ai mbajti poste të ndryshme deri në vitin 2011, duke përfshirë Ndihmës Shef i Analizës Kreditore - Departamenti Qendror i Kredive, Tregtar i Derivateve Kreditore, Shef i Tregtimit të Derivateve Kreditore, Shef i Rrezikut Kreditor (Fortis Azi) dhe Zyrtar Kryesor i Rrezikut (Fortis A. Ş. Turqi). Ai hyri në TEB A.Ş. si Zyrtar Kryesor i Rrezikut në vitin 2011. Që nga prilli 2011, Z. Van Hecke është anëtar i Bordit dhe anëtar i Komitetit të Auditimit. Nga 11 prilli 2013, ai u emërua si kryetar i Komisionit të Menaxhimit të Rrezikut të TEB Sh.A.



SABRİ DAVAZ

Anëtar i Bordit

I lindur në Bandirma, Turqi në vitin 1963, Sabri Davaz ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Ankarasë dhe ka marrë diplomën MA në Ekonomi Financiare nga Universiteti i Bostonit në vitin 2000. Ai filloi karrierën e tij profesionale në vitin 1985 në Nën-sekretariatit e Thesarit në Turqi ku shërbeu në disa poste deri në vitin 2004, duke përfshirë Auditor Kryesor i Betuar i Bankës, Zëvendës Kryesues i Bordit të Auditorëve të Betuar të Bankës, Auditor i Betuar i Bankës. Nga viti 2004 deri 2009, ai ishte Zëvendës Kryesues i Agjencisë së Rregullimit dhe Mbikëqyrjes Bankare të Turqisë, gjithashtu ka vepruar si konsulent deri në vitin 2011 kur u bashkua me Grupin TEB si Këshilltar Kryesor i Kryesuesit në TEB Holding A.Ş.

Nga marsi 2012, ai është anëtar i Bordit të TEB A.Ş. dhe nga shkurti 2013 shërben si Anëtar i Komitetit të Auditimit i TEB A.Ş. Në prill 2013, ai u emërua si anëtar i Bordit dhe Zëvendës Kryesues i Komitetit të Auditimit të TEB Sh.A.



TUGBAY KUMOGLU

Anëtar i Bordit

Lindur në Antalia, Turqi në vitin 1974, Tugbay Kumoglu ka diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave Administrative të Universitetit Gazi. Ai e filloi karrierën e tij profesionale në Garanti Bank si praktikant në menaxhment në vitin 1998. Pas mbajtjes së disa posteve në degët dhe organizatat rajonale në Garanti, ai u emërua Menaxher i Planifikimit Strategjik të Shërbimeve Bankare për NVM. Posti i tij i fundit në Garanti Bank ishte menaxher i degës. Ai filloi në Grupin TEB në vitin 2006 si Menaxher Rajonal i Shitjeve për Evropë 2. Në vitin 2007, ai u gradua Drejtor i Menaxhimit të Shitjeve për Shërbime Bankare Individuale në TEB. Nga viti 2011, ai është përgjegjës edhe për menaxhimin e performancës së shërbimeve bankare individuale dhe Star, financave të klientëve, ekipit të shitjeve direkte dhe pagesave të pagave. Nga shkurti 2013, Z. Kumoglu është emëruar si anëtar i bordit të TEB Sh.A.



MEHMET OZKAYA

Anëtar i Bordit

I lindur në Konya, Turqi në vitin 1969, Dr. Mehmet Ozkaya mori doktoraturën në Financat Ndërkombëtare (1999) dhe diplomën MBA në Vendimmarrjen Financiare (1994) nga Universiteti George Washington në SHBA, dhe diplomën e tij BSc (Baçelor) në Inxhinieri Kompjuterike (1992) nga Universiteti Bogazici në Turqi.

Z. Ozkaya ka kaluar pjesën e hershme të karrierës së tij në Thesarin e Bankës Botërore në SHBA. Gjatë qëndrimit të tij atje nga viti 1995 deri në vitin 2006, ai mbajti poste të ndryshme, duke përfshirë edhe Shefin e të Ardhurave Globale Fikse në Investimet e Fondit Pensional (2003-2006), zyrtar i lartë financiar në tregjet e kapitalit (2000-2002), zyrtar financiar në financat e strukturuar dhe instrumentet derivative (1998-1999), dhe analist financiar në menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve (1995-1997). Z. Ozkaya filloi në Grupin TEB në fillim të vitit 2006 si zyrtar kryesor për Investime i Menaxhimit të Pasurive në TEB ku ai gjithashtu e këshillonte Kryesuesin dhe Kryeshefin Ekzekutiv të Grupit TEB në tregjet globale, ekonomi ndërkombëtare, dhe menaxhimin e portfolios së investimeve të TEB-it. Në vitin 2011, ai u emërua si zyrtar kryesor për investime në TEB A.Ş. Duke filluar nga prilli 2013, Z. Ozkaya ka shërbyer si anëtar i Bordit dhe Kryesues i Komitetit MPD të TEB Sh.A.



AYHAN ALBEYOĞLU

Drejtor Menaxhues dhe Anëtar i Bordit

I lindur në Izmir, Turqi në vitin 1966, Ayhan Albeyoğlu ka diplomuar nga ODTU (Universiteti Teknik i Lindjes së Mesme), Fakulteti i Shkencave Administrative në vitin 1989. Karriera e tij bankare filloi si auditor dhe vazhdoi si Menaxher i Degës dhe Menaxher Regjional. Ai filloi në TEB A.Ş. në vitin 2005 dhe u emërua menaxher i zonës për Rajonin Marmara të Turqisë. Ai vazhdoi duke u bërë drejtor rajonal i Rajonit Istanbul Anadolu në vitin 2011.

Në dhjetor 2013 është emëruar si anëtar i Bordit dhe Drejtor Menaxhues i TEB Sh.A.

KOMITETET

BORDI I DREJTORËVE I TEB Sh.A.

<i>Kryesues:</i>	<i>Musa Erden</i>
<i>Zv. Kryesues:</i>	<i>Alp Yilmaz</i>
<i>Anëtare:</i>	<i>Ayşe Aşardağ</i>
<i>Anëtar:</i>	<i>Didier Albert Nicole Van Hecke</i>
<i>Anëtar:</i>	<i>Sabri Davaz</i>
<i>Anëtar:</i>	<i>Tugbay Kumoglu</i>
<i>Anëtar:</i>	<i>Mehmet Ozkaya</i>
<i>Anëtar:</i>	<i>Ayhan Albeyoğlu (ex-officio)</i>

Menaxhimi

TEB Sh.A. (Banka) ka një bord të drejtorëve aktualisht të përbërë nga tetë anëtarë, të gjithë me përvojë të gjerë bankare (ju lutem shihni biografitë e anëtarëve). Ai kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me kërkesat e përcaktuara në statutin e Bankës dhe ligjet anësore të Bordit të Drejtorëve dhe në përputhje me të gjithë legjislacionin përkatës dhe kërkesat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullatorët. Bordi mbledhet të paktën çdo tre muaj.

Roli i Bordit të Drejtorëve

Detyra kryesore e Bordit është të mbikëqyrë aktivitetet financiare dhe afariste të Bankës. Ai është përgjegjës për përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Bankës, politikës afariste të saj duke përfshirë njësitë operative dhe administrative, nën-njësitë dhe funksionet e tyre, pozitat mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese. Për më tepër, Bordi është i ngarkuar edhe me mbikëqyrjen e aktiviteteve të menaxhmentit të lartë.

Bordi i Drejtorëve përcakton politikën e biznesit të Bankës, përcakton strukturën bankare dhe nivelet e ekspozimit, rishikon dhe miraton rregullimet dhe masat e nevojshme. Për më tepër, Bordi është përgjegjës për miratimin e raportit të menaxhmentit të lartë për aktivitetet e biznesit në bazë të bilancit gjashtëmuor të gjendjes, pasqyrës së fitimit dhe humbjes, bilancit vjetor të gjendjes dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Vendimet e marra nga Bordi kërkojnë shumicën e votave nga anëtarët të cilët ose janë të pranishëm ose votojnë me ndërmjetës.

KOMISIONET E BORDIT TË TEB Sh.A.

Në përputhje me statutin dhe rregulloret e saj, Bordi ynë ka emëruar një komitet auditimi, një komision të menaxhimit të rrezikut, një komision për asetë dhe borxhe, një komision të kompensimit dhe komisione të tjera të përhershme të përbëra nga anëtarët e Bordit dhe ekspertët e jashtëm. Komisioni i kompensimit dhe komisioni i menaxhimit të rrezikut janë caktuar në takimet e Bordit të Drejtorëve më 2 nëntor dhe 20 dhjetor 2012, respektivisht. Bordi gjithashtu mund të krijojë komisione ad hoc dhe të përcaktojë përbërjen dhe detyrat e tyre, aty ku duhet dhe është e përshtatshme.

Komiteti i auditimit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Komisioni i Auditimit ka detyrat dhe përgjegjësitë e qarta që janë të përcaktuara në aktet nënligjore të komiteteve të auditimit dhe janë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregulloret. Detyrat e tij përfshijnë:

- Rekomandimi i kontrolleve adekuate të brendshme të kontabilitetit, operative dhe administrative
 - Mbikëqyrja e përputhshmërisë së Bankës me politikën dhe procedurat;
 - Kërkesa dhe rishikimi i raporteve nga shefi i departamentit të auditimit të brendshëm të Bankës;
 - Rekomandimi i kompensimit për shefin e departamentit të auditimit të brendshëm;
 - Monitorimi i përputhshmërisë me legjislacionin bankar përkatës dhe rregulloret e aplikueshme ose kërkesat;
 - Rekomandimi për emërimin e një auditori të jashtëm;
 - Monitorimi i performancës së auditorit të jashtëm, rishikimi i raportit të auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të Bankës dhe raportimi i të gjitha gjetjeve tek Bordi i Drejtorëve;
 - Shpërndarja e opinioneve tek Bordi i Drejtorëve në lidhje me çdo çështje që i kërkohet atij nga Bordi i Drejtorëve, ose që komisioni dëshiron ta adresojë; dhe
 - Miratimi i planit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm të TEB Sh.A.
- Komiteti i auditimit takohet së paku çdo tre muaj.

Kryesues:	Ayşe Aşardağ
Zv/ Kryesues:	Sabri Davaz
Anëtar:	Didier Van Hecke
Anëtar:	Ardiana Gashi (anëtar ekspert i jashtëm)

Komisioni për menaxhimin e rrezikut të kredive

Kryesues: Jean-Milan Givadinovitch
Zv/ Kryesues: Murat Akşam
Anëtar: Alp Yılmaz
Anëtar: Haluk Kırçalı
Anëtar: Ali İhsan Arıdaşır

Detyrat dhe përgjegjësitë:

I autorizuar për vendime të kredive në vlerë prej 500,000 euro deri 2.5 milion euro.

Komisioni për Asete dhe Borxhe (KAB)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitorimi i tregjeve financiare, duke kontrolluar situatën, lëvizjet dhe ndryshimet në bilancin e gjendjes së bankës dhe marrjen e vendimeve, të gjitha në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Bankës;
- Udhëzimi dhe monitorimi i veprimeve të Departamentit të Thesarit dhe KAB në mënyrë të vazhdueshme dhe duke vepruar si organ vendim-marrës, siç përcaktohet në aktet nënligjore të Komisionit për KAB.
- Mbikëqyrja e menaxhimit të aseteve dhe (borxheve) detyrimeve nga ana e Departamentit të Thesarit dhe KAB në drejtim të kritereve të mëposhtme:
 - Për të siguruar respektimin e raporteve (shkallës) të jashtme (rregullative) të përcaktuara nga BQK-ja dhe rregullave të brendshme të përcaktuara nga Bordi ose KAB; dhe
 - Monitorimi i rezervës së domosdoshme minimale të përcaktuar nga BQK.

Komisioni për asete dhe borxhe takohet së paku çdo tre muaj.

Kryesues: Mehmet Ozkaya
Zv/Kryesues: Ayhan Albeyoglu
Anëtar: Tolga Gürdem
Anëtar: Alp Yılmaz
Anëtar: Didier Van Hecke
Anëtar: Dukagjin Shylemaja
Anëtar: Arianit Dehiri

Komisioni për menaxhimin e rrezikut

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Komisioni për Menaxhimin e Rrezikut është përgjegjës për monitorimin e të gjitha komponentëve të lidhura me rrezikun dhe funksionet që kanë të bëjnë me kredi, tregun, likuiditetin, çështjet operacionale, përputhshmërinë, reputacionin, çështjet ligjore, mosshlyerjen e pagesave, mjaftueshmërinë e kapitalit të Bankës dhe rreziqeve të tjera.

Komisioni për Menaxhimin e Rrezikut takohet së paku çdo tre muaj.

Kryesues: Didier Van Hecke
Zv/Kryesues: Alp Yilmaz
Anëtar: Musa Erden

Komisioni i kompensimit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Përgjegjësitë e këtij komisioni përfshijnë detyrat e mëposhtme:

- Propozimet për zbatimin e Politikës së Bankës për kompensimin në të holla për Bordin;
- Propozon një politikë/sistem para Bordit në lidhje me vlerësimin e performancës dhe caktimin e synimeve për menaxhmentin e lartë;
- Propozon për Bordin kriteret e vlerësimit të performancës vjetore dhe afatgjatë dhe objektivat për menaxhmentin e lartë;
- Të paktën një herë në vit (mundësisht në tremujorin e parë të çdo viti), shqyrton dhe miraton vlerësimet përmblledhëse të performancës, objektivat dhe propozimin për pakon kompensuese për menaxhmentin e lartë;
- Jep propozime për Bordin në lidhje me pakon e kompensimit për drejtuesit ekzekutivë; dhe
- Jep raportet për Bordin e Drejtorëve mbi kompensimin në baza vjetore ose sipas kërkesës.

Komisioni i kompensimit takohet së paku një herë në vit.

Kryesues: Alp Yilmaz
Zv/Kryesues: Ayşe Aşardağ

MENAXHIMI I RREZIKUT, AUDITIMI I BRENDSHËM, KONTROLLI I BRENDSHËM

Menaxhimi i rrezikut

TEB Sh.A. ka një qasje gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme sa i përket rrezikut, identifikimit dhe menaxhimit të tij. TEB Sh.A. monitoron dhe vlerëson rrezikun e tregut, likuiditetit, të normave të interesit, rrezikun operacional dhe rreziqe tjera përkatëse (financiare) duke përdorur metodat që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Procesi i menaxhimit të rrezikut është i organizuar në strukturën e metodologjive të menaxhimit të rrezikut të TEB dhe BNP Paribas dhe favorizon një kulturë të përbashkët të menaxhimit të rrezikut. Procesi është i përbërë nga përkufizimi dhe matjet e rrezikut, themelimi i politikave dhe procedurave të rrezikut, analiza e rrezikut dhe monitorimi, raportimi, si dhe fazat e auditimit, të gjitha në përputhje me parimet e menaxhimit të rrezikut. Menaxhmenti i Rrezikut në Grup (MRrG) mbikëqyr procesin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut në kuadër të TEB Group. Puna e departamentit të menaxhimit të rrezikut në TEB Sh.A. është të punojë në bashkëpunim me menaxhmentin ekzekutiv për të siguruar se rreziqet që i merr TEB Sh.A. janë në pajtim me politikat e MRrG-së dhe se janë në përputhje me objektivat e profitabilitetit dhe të klasifikimit kreditor. Menaxhimi i Rrezikut raporton rregullisht pranë Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut duke paraqitur raportet e rrezikut në të gjitha rreziqet relevante financiare. Kjo është një pasqyrë e rreziqeve më të rëndësishme dhe veprimeve që ne i bëjmë për t'i ulur ato.

Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normave të interesit vjen nga mundësia që ndryshimet në normat e interesit mund të ndikojnë në fitimin e ardhshëm ose vlerën e instrumenteve financiare. Mbrojtja ndaj ndryshimeve në normat e interesit është një prioritet i lartë për TEB Sh.A.

Ulja: Rreziku i normave të interesit përcaktohet duke matur shkallën e ndjeshmërisë së mjeteve, detyrimeve dhe zërave jashtë-bilancorë. Rreziku i normave të interesit monitorohet nga afër përmes analizave të gap-it dhe të kohëzgjatjes. Simulimet mbi të ardhurat nga interesi kryhen në lidhje me treguesit e parashikuar ekonomikë të përdorur në buxhetin e Bankës. Efektet e mundshme negative të luhatjes së normës së interesit në pozicionin financiar dhe rrjedhën e parave minimizohen me anë të vendimeve të shpejta. Në përcaktimin e strategjive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate të çmimeve, Komisioni i aseteve dhe borxheve të TEB Sh.A. menaxhon mospërputhjen e maturimeve dhe përdorë parimin e punës me margjina pozitive të bilancit të gjendjes si politikën e saj të çmimeve.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin humbjet e mundshme që një bankë mund të pësojë si pasojë e ekspozimit të zërave të bilancit të gjendjes dhe zërave jashtë-bilancorë të saj ndaj rrezikut të normës së interesit, rrezikut të pozicionit të kapitalit apo rrezikut të kursit të këmbimit që rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare.

Ulja: Menaxhmenti i rrezikut të tregut në TEB Sh.A. është dizajnuar që të kontrollojë dhe menaxhojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut, në mënyrë që të optimalizohen kthimet duke e ruajtur profilin konservativ të Bankës sa i përket rrezikut.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit ndodh kur nuk ka para të mjaftueshme ose rrjedhë të mjaftueshme të parasë për t'i përmbushur kërkesat neto të fondeve në kohën e duhur. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen shpejt me çmime të përshtatshme.

Ulja: Politika e Bankës është të krijojë një strukturë të mjeteve që është mjaft likuide për t'i përmbushur të gjitha llojet e detyrimeve kur ato duhen paguar. Bordi i Drejtorëve rregullisht monitoron dhe përcakton normat e likuiditetit dhe standardet përkatëse për ruajtjen e likuiditetit të lartë gjatë gjithë kohës. TEB Sh.A. ka një sistem efikas të raportimit menaxherial sa i përket raportimit me kohë të pozicionit të likuiditetit në Bordin e Drejtorëve, të Menaxhmenti i lartë dhe të gjitha njësitë përkatëse.

Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është humbja që mund të ndodhë nëse pala tjetër në marrëdhënie të kredisë dështon, pjesërisht ose tërësisht, për t'i përmbushur detyrimet e saj në kohë. TEB Group është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nëpërmjet kreditimit të saj, të financimit të tregtisë, dhe aktiviteteve të thesarit, por rreziku i kredive mund të lindë edhe në rrethana të tjera.

Ulja: Bordi i Drejtorëve ka autoritetin vendimtar në lëshimin e kredive. Kjo fuqi i është deleguar Komitetit të Kredive dhe kryeshefit ekzekutiv në kushte të caktuara. Ushtrimi i këtyre kompetencave të deleguara monitorohet dhe raportohet rregullisht nga auditimi i brendshëm dhe menaxhimi i rrezikut. Ekspozimi primar ndaj rrezikut të kredisë në TEB Sh.A. lind nëpërmjet kredive të saj dhe paradhënieve për klientët. Shuma e ekspozimit në këtë drejtim është një funksion i mbajtjes së mjeteve në bilancin e gjendjes të konsoliduar. Përqendrimet e rrezikut të kredisë lindin kur një numër i klientëve janë të angazhuar në aktivitetet e ngjashme të biznesit, apo aktivitete në të njëjtin rajon gjeografik, ose kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të shkaktonin që aftësitë e tyre për t'i përmbushur detyrimet kontraktuese të ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet ekonomike, politike ose kushte të tjera.

Zyrtarët e degës vizitojnë aplikantët e kredisë dhe marrin pasqyrat financiare dhe informacionin në lidhje me aktivitetet dhe planet e klientit potencial. Përgatitet një propozim kredi që përmban një koment mbi pozicionin financiar të kompanisë, një analizë të industrisë, informacion në lidhje me partnerët dhe menaxherët, si dhe referenca nga bankat e tjera dhe kompanitë me të cilat aplikanti është duke bërë biznes. Ky informacion më pas i dorëzohet Divizionit për Alokim dhe Monitorim të Kredive që vlerëson besueshmërinë e aplikuesit dhe raportin e tij e dërgon në Komitetin Kreditor për aprovim.

Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut rregullisht vlerëson dhe menaxhon të gjitha rreziqet financiare, përfshirë rrezikun kreditor. Bën vlerësimin e rrezikut intern në nivel të bankës dhe në nivel të njësive punese të paktën dy herë në vit. Analiza e nivelit të bankës duhet të ndryshohet sa herë që ekziston një ndryshim i rëndësishëm në mjedisin operativ që mund të ndikojë në TEB Sh.A. Zhvillimet në treg monitorohen nga afër për ta minimizuar rrezikun kreditor. Si rezultat i politikës së kujdesshme që Banka ka miratuar, kredia më e madhe që një klient mund të marrë është nën kufijtë ligjor, duke minimizuar kështu rrezikun e përqendrimit të kredisë. Kufijtë e vendosur nga Bordi i Drejtorëve monitorohen dhe raportohen rregullisht.

Divizioni për Lëshimin dhe Monitorimin e Kredive bën vlerësime të portofolit të kredisë për Komitetin e kredisë dhe menaxhimit të rrezikut si dhe raportojnë rastet e rrezikut të lartë dhe kreditë hhv. Pasi ofrohet një produkt kreditor, Departamenti për Monitorim të Kredive monitoron aftësinë e klientit për shlyerje dhe mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e kolateralit. Në këtë mënyrë, çdo hua problematike identifikohet në një fazë të hershme. Nëse vlerësimi kreditor dhe/ose cilësia e kolateralit ka ngritur ndonjë dyshim, klienti shqyrtohet më hollësisht.

Rreziku gjatë këmbimit

Rrezikut i këmbimit valutor përcaktohet si një humbje e mundshme që një bankë mund të pësojë me të gjitha mjetet dhe detyrimet e saj në valuta tjera në rast të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Ulja: Kufijtë e pozitave të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve monitorohen në baza ditore dhe ndryshimet e mundshme në pozitat monetare të Bankës që mund të vijnë si rezultat i transaksioneve rutinore në valuta të huaja gjithashtu kontrollohen.

Mjaftueshmëria e kapitalit

Qëllimi i bankës është që vazhdimisht të sigurohet se ka kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet që shoqërojnë punën e bankës. Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut monitoron dhe raporton normat e mjaftueshmërisë së kapitalit pranë Menaxhmentit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut. Sipas ligjit mbi bankat dhe sipas rregulloreve të BQK-së, janë tri norma të mjaftueshmërisë së kapitalit të cilat duhet të përmbushen në çdo kohë: kapitali i klasit të parë në raport me mjetet e peshuara me rrezik duhet të jetë të paktën 8%, kapitali total në raport me mjetet e peshuara me rrezik duhet të jetë së paku 12% dhe totali i ekuitetit në raport me mjetet totale prej më së paku 7%.

Auditimi i brendshëm

Bordi i Drejtorëve të TEB Sh.A. ka themeluar Departamentin e Auditimit të Brendshëm në shkurt 2013 si një nga faktorët kryesorë në strukturën qeverisëse të Bankës. Para kësaj date, Banka kishte kontraktuar funksionin e saj të auditimit të brendshëm te Turk Ekonomi Bankasi A.Ş., në bazë të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (SLA) të nënshkruar në vitin 2008. Banka vazhdon të marrë përkrahje për auditim nga Turk Ekonomi Bankasi A.Ş. përmes këshillave të auditimit për Departamentin e Auditimit të Brendshëm. Për më tepër, Turk Ekonomi Bankasi A.Ş. kryen auditime specifike për aktivitetet e caktuara, bazuar në planet e para-përgatitura të auditimit.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm të Bankës është i pavarur dhe si i tillë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit dhe me iniciativën e vet, nëse e sheh të nevojshme ose të përshtatshme.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm vepron si një funksion i sigurisë, duke i ndihmuar Bankës për të përmbushur objektivat e saj duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të efektivitetit të mjedisit të kontrollit, duke përfshirë proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Është përgjegjësi e Auditimit të Brendshëm për të vlerësuar nëse mjedisi i kontrollit siguron se rreziqet që mund të lindin nga aktivitetet e Bankës menaxhohen në mënyrën e cila mundëson një nivel të pranueshëm të uljes së rrezikut.

Aktivitetet e auditimit kryhen nga departamenti i auditimit të brendshëm sipas planit të auditimit, i cili përgatitet të paktën një herë në vit duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës. Ai miratohet më pas nga Komiteti i Auditimit të Bankës. Plani azhurnohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të integruar linja të reja të biznesit. Në të njëjtën mënyrë, auditori i brendshëm përgjegjës zhvillon dhe regjistron një plan të fokusuar në rrezik për çdo detyrë të auditimit, i cili analizon pikat e brendshme të rrezikut dhe përfshin objektivat, fushëveprimin, kohën dhe ndarjen e burimeve.

Puna e Departamentit të Auditimit të Brendshëm kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të hartuara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm, i cili është organi drejtues për profesionin e auditimit të brendshëm në të gjithë botën, dhe me praktikat e auditimit të TEB A.Ş..



PAJTUESHMËRIA

Kontrolli i Brendshëm

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm siguron se në TEB SH.A. është krijuar një mjedis i shëndoshë i kontrollit të brendshëm, merret me koordinimin e nevojshëm në këtë drejtim dhe garanton se aktivitetet zhvillohen rregullisht, në mënyrë efikase, efektive dhe në përputhje me strategjinë e menaxhimit dhe politikat e Bankës, si edhe me rregullat dhe rregulloret në fuqi. Pas ndryshimit organizativ gjatë vitit, funksionet e kontrollit të brendshëm dhe rrezikut operacional tani janë të strukturuar veçmas. Brenda fushëveprimit të kontrollit të brendshëm, kontrollet e përditshme, javore, kontrollet mujore dhe tremujore të aktiviteteve kritike në degë dhe departamentet e zyrës qendrore kryhen nga njësia e kontrollit të degës dhe njësia qendrore e kontrollit.

Kontrolluesi kryen kontrollet e tij/saj në pajtim me listat e kontrollit të cilat janë të përgatitura paraprakisht dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe të jashtme. Listat e kontrollit rishikohen nëse ndodhin ndryshime në rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe/ose të jashtme.

Pikat e kontrollit në listat e kontrollit përdoren për:

- Verifikimin e respektimit të duhur të rregullave dhe procedurave të brendshme dhe përputhjen e rregullave të brendshme me rregulloret ligjore dhe respektimin e tyre;
- Kontributi për ruajtjen e aseteve;
- Vlerësimi i mjaftueshmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të përditshme; dhe
- Kontributi në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të lidhura me aktivitetet afariste aktuale dhe të propozuara të ardhme të organizatës, duke përfshirë produktet e reja.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm i raporton direkt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit në baza tremujore.

Rreziku operacional dhe vazhdimësia e punës

Menaxhimi i rrezikut operacional në TEB Sh.A. do të themelojë një sistem për monitorimin e rrezikut operacional, të përshtatshëm për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të tyre në mënyrë që efektivisht të identifikohet, vlerësohet, monitorohet dhe kontrollohet/zvogëlohet rreziku operacional. Departamenti i Rrezikut Operacional është përgjegjës për të ndihmuar departamentet e tjera për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe kontrollin/zvogëlimin e rrezikut operacional; zbatimin e metodave me qëllim të identifikimit, vlerësimit, zvogëlimit (përfshirë kontrollet e brendshme) dhe monitorimit të rrezikut operacional; organizimin e trajnimeve të rrezikut operacional për të gjithë personelin sidomos ata përgjegjës për të raportuar ndonjë incident të njësisë së rrezikut operacional dhe vazhdimësisë të biznesit; dhe vlerësimin e të gjitha proceseve s i përket rrezikut operacional dhe identifikimit të proceseve që kanë rrezik.

Menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit, pavarësisht nga lloji dhe arsyeja e tij, përbëhet tërësisht nga planet që sigurojnë vazhdimësinë e funksioneve kritike të punës së bankës në rast të ndërprerjes së punës ose në rast fatkeqësish. Njësia e Rrezikut Operacional dhe Vazhdimësisë së Biznesit ka vazhduar aktivitetet e saj të përcaktimit, matjes dhe raportimit të rrezikut në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm. Rezultatet e aktiviteteve të njësisë së rrezikut operacional dhe vazhdimësisë së biznesit rishikohen periodikisht dhe vlerësohen nga Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të TEB-it në emër të Bordit të Drejtorëve.

Rezultatet e Njesisë për Rrezikun operacional dhe Vazhdimësinë e Punës shqyrtohen dhe vlerësohen periodikisht nga Komiteti i TEB-it për Menaxhimin e Rrezikut dhe njësia i raporton Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit në çdo tre muaj.

Pajtueshmëria

Ne jemi të përkushtuar për aktivitete bankare të përgjegjshme dhe për të vepruar me integritet dhe përgjegjësi në çdo gjë që bëjmë. Në TEB, ne besojmë se në krijimin e vlerës për klientët tanë, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë, mënyra se si ne kryejmë afarizmin është po aq e rëndësishme sa qëndrueshmëria e rritjes së biznesit tonë.

Nënkuptohej se respektimi i ligjeve dhe zbatimi i rregulloreve dhe standardeve dhe udhëzimeve më të larta ndërkombëtare është pjesë e identitetit tonë dhe formon themelin për mënyrën se si ne bëjmë biznes. Në të njëjtën kohë, ne kemi vendosur standarde të larta të integritetit të biznesit dhe sjelljes etike për qëllim rritjen e efektivitetit të kornizës së pajtueshmërisë. Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të vazhdueshme në kërkesat rregullative të mjedisit në Kosovë, ku menaxhimi i pajtueshmërisë është duke u bërë prioritet kryesor. Këtë vit në 2013, ne jemi ballafaquar me shumë sfida, por ne vlerësojmë kontrollin e rritur nga qeveria dhe ndryshimet rregullative. Fryma jonë ekipore, përkushtimi dhe përmirësimi i qëndrueshëm i efikasitetit tonë të gjitha kanë për qëllim ruajtjen e integritetit të institucionit tonë financiar.

Ne presim që punonjësit tanë të veprojnë me ndershmëri, me përgjegjësi, në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë profesionale, në shërbim të interesave më të mira të klientëve dhe për të respektuar integritetin e tregjeve. Kodi ynë i sjelljes, i përbërë nga vlerat tona, sjellja dhe kërkesat etike në biznes, formon bazën për mënyrën se si punonjësit tanë duhet të sillen me kolegët dhe klientët tanë, partnerët afaristë, aksionarët dhe autoritetet. Dispozitat e sjelljes etike në biznes në kodin e etikës kanë për qëllim menaxhimin e konfliktit të interesit, parandalimin e abuzimit të tregut dhe luftimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera ekonomike.

Ne jemi të përkushtuar për të respektuar ligjet e rrepta, rregulloret dhe udhëzimet për të luftuar shpëlarjen e parave, financimin e terrorizmit dhe aktet tjera kriminale. Ne analizojmë klientët tanë dhe transaksionet e tyre për të parandaluar që emri ynë dhe produktet dhe shërbimet tona të mos keqpërdoren për shpëlarjen e parave, financimin e terrorizmit ose qëllime të tjera kriminale. Për ta siguruar këtë, ne zbatojmë masa të përpikta të përkrahura nga sistemet automatike të monitorimit dhe proceset “njihe klientin tënd” (NKT).

Procesi ynë NKT vepron si bazë për mënyrën se si ne menaxhojmë rreziqet që mund të shfaqen nga lidhja e marrëdhënies me një klient të ri ose nga ofrimi i shërbimeve një klienti ekzistues. Ai na ndihmon ta mbrojmë Bankën nga përfshirja në aktivitete që përfshijnë shpëlarjen e parave, financimin e terrorizmit dhe krime të tjera ekonomike. Procesi fillon me një vlerësim para pranimit të çdo klienti të mundshëm të ri dhe vazhdon në formën e rishikimeve të rregullta, sipas procedurave të përcaktuara dhe duke përfshirë vlerësimin e njerëzve apo subjekteve që janë pronarët e fundit përfitues.

Masat parandaluese dhe zbatimi i kontrolleve të hollësishme na ndihmojnë të mbajmë respektimin rigoroz të ligjeve dhe rregulloreve. Prandaj, në vitin 2013 ne kemi realizuar disa projekte të rëndësishme për të forcuar infrastrukturën tonë të TI dhe në qasjet ndër-funksionale për etikën e punës, shpëlarjen e parave dhe konfliktin e interesit, dhe do të vazhdojmë me projekte të ngjashme në të ardhmen.

Me qëllim të promovimit të programit tonë të pajtueshmërisë dhe për të siguruar ndërgjegjësimin dhe respektimin nga punonjësit tanë, ne kemi zgjeruar programin tonë të trajnimit për të përfshirë mësimin elektronik (e-learning) dhe module të veçanta për temat kryesore të pajtueshmërisë. Modulet janë në dispozicion për të gjithë punonjësit dhe mund të përshtaten për nevojat e linjave të biznesit në bazë të kërkesave specifike të punës dhe do të shërbejnë për të plotësuar gamën e gjerë të programeve të brendshme të trajnimit që trajtojnë tema të pajtueshmërisë. Shumica e disiplinave të mbuluara nga modulet profesionale janë të bazuara në konceptet e përbashkëta të transparencës.

Departamenti ynë i Pajtueshmërisë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit. Qëllimi i tij është të menaxhojë rrezikun e pajtueshmërisë në mënyrë të duhur për të siguruar që aktivitetet bankare janë në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret përkatëse.

Duke parashikuar ndikimin e sfidave të sotme financiare dhe situatave të paparashikueshme që mund të shfaqen, departamenti ynë i pajtueshmërisë vazhdimisht dhe në mënyrë proaktive planifikon, përmirëson dhe identifikon masat parandaluese.





TEB Sh.A

Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2013

I përkthyer në gjuhën shqipe nga raporti origjinal në gjuhën angleze. Raporti në gjuhën angleze është i verifikuar. Në rast të çfarëdo mos përputhjeje ndërmjet versionit të gjuhës angleze dhe asaj shqipe, raporti në gjuhën angleze është i vlefshëm.

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	3-4
PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	9-76



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të TEB Sh. a.

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të TEB Sh. a të cilat përmbajnë pasqyrën e gjendjes financiare më 31 Dhjetor 2013, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrolleve të brendshme të nevojshme për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit; përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e vlerësimeve të arsyeshme kontabël në rrethanat përkatëse.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfituar siguri të arsyeshme për mungesën e gabimeve materiale në pasqyrat financiare.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e evidencave të auditimit që mbështesin shumat dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak mashtrimesh apo gabimesh. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të përcaktuar procedurat e auditimit që i përshtaten rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të mbështetur opinionin tonë.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat përcjellëse financiare japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të TEB Sh. a më 31 Dhjetor 2013 si dhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

PricewaterhouseCoopers - Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k
Prishtinë,
14 Mars 2014

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2013	Më 31 Dhjetor 2012
PASURITË			
Paraja e gatshme dhe gjendja me bankat	4	81,152	43,871
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës		-	-
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	17,749	28,322
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	266,060	222,777
Pasuritë financiare të gatshme për shitje	8	825	608
Pasuritë afatgjata materiale	11	4,453	2,835
Pasuritë, prona dhe impiantet	12	675	526
Pasuritë tjera financiare	9	1,345	984
Tatimi i shtyrë		-	-
Pasuritë tjera	10	142	249
Gjithsej pasuritë		372,401	300,172
DETYRIMET			
Detyrimet për klientët	13	327,232	270,369
Detyrimet tjera financiare	14	1,456	1,154
Detyrime të tjera	15	997	617
Detyrimet tatimore në të ardhura	25	-	-
Huamarrjet	16	16,322	6,424
Gjithsej detyrimet		346,007	278,564
KAPITALI			
Kapitali aksionar	17	24,000	23,000
Fitimi /(Humbja) e akumuluar		2,394	(1,392)
Gjithsej kapitali		26,394	21,608
Gjithsej detyrimet dhe kapitali		372,401	300,172

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga menaxhmenti ekzekutiv i bankës me 18 Shkurt, 2014, dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Z. Ayhan Albeyoglu
Drejtori Menaxhues

Z. Dukagjin Shylemaja
Zëvendës Drejtori Menaxhues

Shënimet shpjeguese nga faqja 1 deri ne 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënim	Për vitin që mbaroi më 31 Dhjetor 2013	Për vitin që mbaroi më 31 Dhjetor 2012
PASURITË			
Të hyrat nga interesi	18	30,549	24,995
Shpenzimet e interesit	19	(9,660)	(7,271)
Të hyrat neto nga interesi		20,889	17,724
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	20	6,328	5,134
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	21	(1,229)	(1,070)
Të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet		5,099	4,064
Fitimi neto nga kursi i këmbimit		209	252
Të hyrat tjera operative		98	30
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	7	(7,387)	(4,299)
Humbjet dhe provizionet tjera per Zhvleresim	7	(223)	31
Shpenzimet e personelit	22	(6,102)	(-5,053)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit		(1,844)	(1,922)
Shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera operative	23	(6,535)	(6,018)
Fitimi para tatimit		4,204	4,809
	24		
Tatimi në fitim		(418)	(518)
Fitimi neto i vitit		3,786	4,291
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse		3,786	4,291

	Kapitali aksionar	Humbja e akumuluar	Gjithsej aksionarëve
Gjendja më 1 janar, 2012	21,500	(5,683)	15,817
Capital subscribed	1,500		1,500
Fitimi neto per vitin	-	4,291	4,291
Të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse	-	4,291	4,291
Gjendja më 31 Dhjetor, 2012	23,000	(1,392)	21,608
Kapitali aksionar i lëshuar	1,000	-	1,000
Fitimi neto për vitin	-	3,786	3,786
Të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse	-	3,786	3,786
Gjendja më 31 Dhjetor, 2013	24,000	2,394	26,394

	Shënim	Për vitin që mbaroi më 31 Dhjetor 2013	Për vitin që mbaroi më 31 Dhjetor 2012
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		4,204	4,809
Zhvlerësimi	11	1,382	1,610
Amortizimi	12	462	312
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë dhe zërat jashtë-bilancor	6,7	7,610	4,268
Shlyerja e pasurive afatgjata materiale		(51)	35
Të hyrat nga interesi	18	(30,549)	(24,995)
Shpenzimet e interesit	19	9,660	7,271
		(7,282)	(6,690)
Rritja e rezervës së detyrueshme me BQK		(6,090)	(6,138)
Rritja e kredive dhe paradhënieve për klientët		(50,269)	(52,263)
Rritja në pasuritë tjera financiare		(361)	-
Rritja në pasuritë tjera		107	(359)
Rritja e detyrimeve ndaj klientëve		56,862	85,199
Zvogëlimi në detyrime të tjera financiare		302	(250)
Rritja në detyrime të tjera		380	115
		(6,351)	19,614
Interesi i arkëtuar		28,281	23,275
Interesi i paguar		(8,381)	(4,856)
Paraja e gjeneruar nga aktivitet operative		(13,549)	38,033
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurisë së preکشme		(3,025)	(1,348)
Blerjet e pasurisë së paprekshme		(611)	(365)
Të hyrat nga shitja e pasurisë së preکشme		25	16
Blerja e pasurive financiare të disponueshme për shitje		(217)	(608)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese		(3,828)	(2,305)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare			
Të hyrat nga huatë		9,898	(4,595)
Kapitali i ri i lëshuar		1,000	1,500
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare		10,898	(3,095)
Rritja në para të gatshme dhe ekuivalentët e saj		20,619	32,633
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj me 1 Janar, 2013		48,949	16,316
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 31 Dhjetor, 2013	4.1	69,568	48,949

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Në pajtim me rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), TEB Sh.a. (Banka), me 19 Dhjetor, 2007 ka marrë licencën për aktivitete bankare, dhe në Janar 2008 ka filluar operacionet e saj. Zyra Qendrore e regjistruar e bankës gjendet në Prishtinë, Kosovë. Banka operon si bankë komerciale dhe si bankë për kursime, për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në Kosovë, përmes rrjetit të saj prej 26 (2012:23) degëve në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Banka kontrollohet nga TEB Holding, e vendosur në Turqi (kompania amë), e cila ka në pronësi 100% të aksioneve të zakonshme me 31 Dhjetor 2013 (31 Dhjetor 2012: 100% të aksioneve të zakonshme). Aksionarët e TEB Holding janë BNP Paribas dhe Çolako lu Group, secili në pronësi nga 50.00% të aksioneve.

Zyra Qendrore e regjistruar e bankës gjendet në rrugën Agim Ramadani, No. 15, 10000, Prishtinë, Kosovë.

Pasqyrat financiare të bankës për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor, 2013 janë aprovuar me 18 Shkurt, 2014 nga Menaxhmenti Ekzekutiv i bankës.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Deklarata e përputhshmërisë

Banka përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahas kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (KISNRF) dhe pararendësit e tij.

Pasqyrat financiare SNRF të bankës përbëhen nga pasqyrat e gjendjes financiare, pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së pasasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, përveç ri-vlerësimit të instrumenteve financiare. Politikat parësore kontabël janë të shpalosura si më poshtë.

2.3 Valuta funksionale

Në pajtim me SNK 21, valuta funksionale e Bankës është EUR pasi është valuta e mjedisit primar ekonomik ku banka operon dhe reflekton substancën ekonomike të ngjarjeve.

2.4 Të hyrat dhe shpenzimet e interesit

Të hyrat dhe shpenzimet e interesit regjistrohen në pasqyrën e të hyrave për të gjithat interesat të cilat bartin instrumente në baza akruale duke e përdorur metodën e Yield-it efektiv.

2.5 Tarifa dhe komisioni

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifa dhe komisioni të dala nga ofrimi, pra shfrytëzimi i shërbimeve bankare, regjistrohen në pasqyrën e të hyrave ashtu siç janë mbledhur, pra, momentin kur shërbimet janë ofruar, shfrytëzuar.

Tarifat për menaxhimin e kredisë për kreditë, të cilat kanë të ngjarë se do të zvogëlohen, shtyhen (tok me kostot direkte përkatëse) dhe njihen si një përshtatje në normën efektive të interesit të kredisë.

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifa dhe komisioni poashtu përfshijnë tarifatat nga letrat e garancionit dhe letrat e kredisë të lëshuara nga banka në të mirë të klientëve, pastaj tarifatat që burojnë nga ngarkesat e bankës vendore dhe ndërkombëtare, dhe nga shërbimet tjera që banka ofron.

2.6 Instrumentet financiare

i. Klasifikimi

Pasuritë financiare klasifikohen në kategoritë në vijim: pasuritë financiare të disponueshme për shitje, kredi dhe llogaritë e arkëtueshme. Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga qëllimi për të cilin u blenë instrumentet financiare dhe karakteristikat e tyre.

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme janë instrumente financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregjet aktive.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

i. Klasifikimi (vazhdim)

Pasuritë financiare të disponueshme për shitje janë ato të synuara për mbajtje për një periudhë të papërcaktuar kohore, të cilat mund të shitën për nevoja të likuiditetit apo të ndryshimeve në normat e interesit, për nevojë të kursit të këmbimit apo çmimeve të ekuitetit.

ii. Matja

Pasuritë financiare njihen fillimisht me vlerë fer të tyre plus kostot e transaksionit, nëse ka. Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen në vlerën fer plus kostot e transaksionit, nëse ka. Pas njohjes fillestare, ato më pas maten me kosto të amortizuar duke shfrytëzuar metodën e normës efektive të interesit. Kostoja e amortizuar llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Premiumet dhe zbritjet, përfshirë kostot fillestare të transaksionit, janë të përfshira në vlerën kontabël të instrumentit përkatës dhe të amortizuar në bazë të normës efektive të interesit, aty ku është e zbatueshme.

Metoda e interesit efektiv është metodë e kalkulimit të kostonë së amortizuar të një pasurie financiare dhe të alokimit të të hyrave të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është normë e cila saktësisht zbrit rrjedhjet e ardhshme të parasë së vlerësuar (përfshirë të gjitha tarifat në pika të paguara apo pranuar, të cilat formojnë një pjesë përbërëse të normave efektive të interesit, kostot financiare dhe premiumet apo zbritjet tjera) përmes jetëgjatësisë së pritur të pasurisë financiare, apo, ku është e mundshme, një periudhë më e shkurtër.

iii. Instrumentet specifike

Paratë dhe ekuivalentët e parasë

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj janë zëra të cilat për një kohë të shkurtër mund të shndërrohen në para të gatshme (më pak se 3 muaj të maturimit origjinal) dhe të cilat i nënshtrohen një rreziku të papërfillshëm të ndryshimit në vlerë. Shumat të cilat kanë të bëjnë me fonde të natyrës restriktive janë të përjashtuara nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar.

Rezervat e detyrueshme për likuiditet

Në pajtim me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbush kushtin e minimumit të likuiditetit mesatar. Kushti i likuiditetit llogaritet në baza javore si 10% të bazës së depozitave, e definuar si mesatarja totale e detyrimeve depozitare ndaj publikut jo-bankar në EUR dhe valuta tjera, përgjatë ditëve të punës të periudhës mirëmbajtëse. Pasuritë me të cilat banka mund të përmbushë kushtin e likuiditetit janë depozitat e EUR në BQK dhe 50% EUR ekuivalent të parasë së gatshme në valuta të gatshme për konvertim. Depozitat me BQK-në nuk mund të jenë më pak se 5% e bazës depozitare të zbatueshme. Pasi pasuritë përkatëse likuide nuk janë të disponueshme për të mbuluar operacionet ditore të bankës, ato janë përjashtuar nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj për qëllim të pasqyrës së rrjedhës së parasë.

Pasuritë financiare të disponueshme për shitje

Në njohjen fillestare, pasuritë financiare të disponueshme për shitje regjistrohen me vlerë fer plus kostot e transaksionit, nëse ka. Më vonë ato mbahen me vlerë fer. Vlerat fer të raportuara janë ose çmimet e vëzhguara të tregut apo vlera të llogaritura me një teknikë vlerësimi të bazuar në tregun aktual të vëzhgueshëm. Fitimi dhe humbjet që dalin nga ndryshimet në vlerë fer të pasurive financiare të disponueshme për shitje njihen përmes të hyrave tjera gjithëpërfshirëse në pozicionin “rezervat e rivlerësimit nga instrumentet financiare të disponueshme për shitje” deri sa pasuria financiare të çregjistrohet apo paaftësohet. Në këtë kohë, fitimi apo humbja kumulative, paraprakisht e njohur në të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse transferohet në fitim apo humbje përmes ri-klasifikimit. Interesi i kalkuluar përmes metodës së normës efektive të interesit dhe fitimi dhe humbja nga valutat e huaja në pasuritë monetare të njohura si të disponueshme për shitje njihen si fitim apo humbje.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

Kreditë dhe paradhënie

Klasifikohen si kredi dhe llogari të arkëtueshme, të cilat maten me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e një pasuri financiare apo obligimi financiar është shuma me të cilën matet apo apo obligimi financiar në njohjen fillestare, minus ri-pagesat e kryegjësë, plus ose minus amortizimi kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv apo çfarëdo dallimi në mes të shumës fillestare dhe shumës së maturimit, dhe minus ndonjë reduktim (përmes shfrytëzimit të ndonjë llogarie të lejuar) për paaftësim apo që nuk mund të mblihet. Kreditë dhe avanset raportohen si neto llogaritë e lejuara për zhvlerësimin në kreditë për të pasqyruar shumat e vlerësuara për mbledhje.

iv. Çregjistrimi

Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale në rrjedhë të parasë nga pasuritë financiare skadojnë, apo kur pasuritë financiare transferohen si dhe cilësitë transferuese për çregjistrim. Transaksioni trajtohet si transfer i një pasurie financiare, me ç'rast transferohet i gjithë risku dhe shpërblimi i pronësisë. Kur banka as nuk e transferon dhe as mbanë substancialisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasurisë financiare, banka do të përcaktojë nëse ka mbajtur kontrollin mbi pasurinë financiare. Një obligim financiar ç'regjistrohet nga pasqyra e pozitës financiare vetëm atëherë kur të shuhet - kur obligimi i specifikuar në kontratë paguhet, apo anulohet apo skadon, me fjalë tjera, kur obligimi i specifikuar në kontratë paguhet, apo anulohet apo skadon.

v. Zhvlerësimi i pasurive financiare

Një vlerësim bëhet në çdo datë të bilancit të gjendjes nëse ka tregues objektiv se një pasuri financiare apo një grup i pasurive financiare mund të paaftësohet. Nëse dëshmi të tilla ekzistojnë, përcaktohet shuma e vlerësuar e kthyeshme dhe çfarëdo humbje nga zhvlerësimi i asaj pasurie, bazuar në neto vlerën aktuale të rrjedhës së pritur të ardhshme të parasë, dhe evidentohet dallimi në mes të shumës që mund të rikthehet dhe shuma e bartur si në vijim:

Kreditë dhe paradhëniet për konsumatorë raportohen me kosto të amortizuar neto të llogarisë së lejuar për të pasqyruar shumat e vlerësuara të rikthyeshme.

Provizioni i rrezikut të kredisë për humbjen e kredisë krijohet këtu, nëse ka dëshmi objektive se banka nuk do të mund të mbledh shumat sipas kushteve fillestare kontraktuale. Shuma e shpenzimeve është dallimi në mes të vlerës kontabël dhe shumës së vlerësuar të rikthyeshme, e kalkuluar sipas vlerës aktuale të rrjedhave të pritura të parasë përfshirë edhe shuma e rikthyeshme nga garantuesit dhe kolaterali, të zbritura sipas normës fillestare efektive të interesit të instrumentit.

Llogaritë e lejueshme bëhen kundruall vlerës kontabël të kredive dhe avanseve të identifikuar si të humbura në bazë të shqyrtimeve të rregullta të balanceve të ngelura për të zvogëluar këto kredi dhe avanse në shumat e tyre të rikthyeshme. Llogaritë e lejueshme për kreditë e humbura poashtu mbulojnë humbjet aty ku ka dëshmi objektive se humbjet potenciale janë prezente në komponentët e portofolit kreditor në datën e bilancit të gjendjes. Këto janë vlerësuar në bazë të shablloneve historike të humbjeve në secilin komponent, dhe klasifikimet kreditore të bëra për huamarrësit pasqyrojnë mjedisin aktual ekonomik nën të cilin huamarrësit operojnë.

Banka së pari vlerëson nëse ka dëshmi objektive për paaftësim individual të pasurive, me rëndësi individuale, dhe individualisht apo kolektivisht për pasuritë financiare të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse banka përcakton se nuk ka dëshmi objektive për paaftësim të pasurisë financiare individualisht të vlerësuar, qoftë i rëndësishëm apo jo, përfshin pasurinë në një grup të pasurive financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor, dhe i vlerëson kolektivisht për paaftësim.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiar (vazhdim)

v. Zhvlerësimi i pasurive financiare (vazhdim)

Pasuritë të cilat janë individualisht të vlerësuara për paaftësim dhe për të cilat një humbje e zhvlerësimit është evidentuar apo vazhdon të evidentohet, nuk përfshihen një vlerësimin kolektiv të paaftësisë.

Shuma e humbjes matet si dallimi në mes të vlerës kontabël të pasurisë dhe vlerës aktuale të rrjedhës së vlerësuar të ardhshme të parasë (përfshijtur humbjet e ardhshme të kredive të cilat nuk janë bërë), të zbritura në normën fillestare efektive të interesit të pasurisë financiare. Vlera kontabël e pasurisë reduktohet përmes shfrytëzimit të një llogarie të lejuar dhe shuma e humbjes evidentohet në fitim apo humbje. Kalkulimi i vlerës aktuale të rrjedhës së vlerësuar të ardhshme të parasë të një pasurie financiare të kolateralizuar poashtu reflekton rrjedhën e parasë e cilat mund të rezultojë nga kostoja më e vogël e konfiskimit për marrjen dhe shitjen e kolateralit, pavarësisht se a është konfiskimi i mundur apo jo.

Për qëllim të vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut kreditor (me fjalë tjera, në bazë të procesit notues të bankës, i cili merr parasysh llojin, industrinë, lokacionin gjeografik, llojin e kolateralit, borxhin aktual dhe faktorët tjerë relevant). Këto karakteristika janë relevante për vlerësimin e rrjedhës së ardhshme të vlerësuar të parasë për grupet e pasurive të tilla, që janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat sipas kushteve të kontraktuara të pasurisë që vlerësohet.

Humbja nga zhvlerësimi kreditor dhe i llogarive të arkëtueshme kontabël me kosto të amortizuar përcaktohen individualisht sipas ekspozimit total të klientëve, që tejkalon shumën prej 50 mijë EUR. Pjesa e ngelur e pasurive financiare kontabël me kosto të amortizuar provizionohet sipas rregulloreve të BQK, pas këto rregulla mjaftueshëm justifikojnë nivelin e provizioneve me një perspektivë prudenciale. Procesi për vlerësimin e paaftësimeve merr parasysh ekspozimin kreditor në vonesë më shumë se 60 ditë. Në rast se vlera neto e rikthyeshme për një pasuri financiare është më e ulët se vlera kontabël e pasurisë, atëherë ka nevojë për evidentimin kontabël të zhvlerësimit.

Norma fillestare efektive të interesit përdoret gjatë kalkulimit të shumës së rikthyeshme të një pasurie financiare, e cila përbëhet nga vlera neto aktuale e rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të para të nxjerra nga mbledhjet e kredive apo nga likuidimi i kolateralëve. Vetëm hipotekat të cilat TEB-i i ka prioritet për likuidim janë marrë parasysh përgjatë përcaktimit të komponentit të vlerës së kolateralit të shumës së rikthyeshme.

Kategoritë e klasifikimit janë si në vijim:

Kategoria A- Standard

Të gjitha kreditë apo shërbimet tjera të drejtpërdrejta kreditore dhe ekspozimet jashtë bilancore që bartin një rrezik normal bankar. Informacionet në dispozicion në lidhje me ekspozimet kreditore, performansën e llogarisë së klientit, dhe të dhënat financiare që të gjitha këto dëshmojnë se shlyerja e ekspozimit është mjaft e sigurtë dhe nuk ka ndonjë vështirësi (apo obligimi është i siguruar plotësisht me kolateral të përshtatshëm). Kredia është aktive, apo delikuenca nuk është vonuar më shumë se tri dhjetë – 30 ditë nga data e kthimit apo maturimit të kredisë. Mbitërheqjet duhet të jenë brenda limitit të caktuar, ose vetëm përkohësisht të tejkalojnë limitin prej 5% ose më pak se 30 ditë, si dhe rrjedha e parasë në llogarinë rrjedhëse është e mjaftueshme për të shlyer bilancin e mbitërheqjes brenda 30 ditëve nga data e skadimit të mbitërheqjes.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiar (vazhdim)

v. Zhvleresimi i pasurive financiare (vazhdim)

Kategoria B- Vëmendje e posaçme (ose Vrojtuese) – Ky klasifikim duhet të përdoret për të identifikuar dhe monitoruar ekspozimet që përmbajnë dobësi apo dobësi potenciale të cilat në rastin e rishqyrtimit, nuk e rrezikojnë kthimin e kredisë apo nuk reflektojnë ndonjë potencial për ndonjë humbje, por të cilat, po qe se nuk adresohen apo nuk korrigjohen mund të rezultojnë në keqësimin e kredisë në nën standard apo klasifikim më të ashpër. Në rast se ka mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar që është e pafavorshme, apo këto kredi vonohen më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë atëherë bankat duhet t'i klasifikojnë këto kredi si "Kredi me vëmendje të posaqme", si dhe ato kredi që janë vazhdimisht në mbetje të borxhit në tejkalim të 5% të linjave të aprovuara për më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë .Kjo kategori e klasifikimit është përpiluar që t'ju mundësojë bankave që të identifikojnë dhe adresojnë marrëdhëniet shumë të dobëta që në fazën e hershme.

Kategoria C - Nën-standard - Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, janë definuar qartë dobësitë e kredisë të cilat rrezikojnë pagesën e kredisë në një kurs normal. Një kredi Nën Standard është ajo kredi e cila në bazë të analizave të të dhënave financiare si dhe faktorëve të tjerë, nuk është e mbrojtur për momentin nga vlera e shëndoshë si dhe nga kapaciteti i pagesës së huamarrësit apo garantuesit ose vlera e kolateralit. Kërket mbështetje nga ana e garantuesve përgjegjës dhe të aftë për të kthyer kredinë gjë që do të përfshinte edhe negociata të vazhdueshme para se likuidimi i kredisë të kërkojë një klasifikim Nën standard. Nevoja për të kërkuar mbështetjen e kolateralit si mjet për të shlyer obligimin duhet të jetë bazë për një klasifikim Nën Standard.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet Nën Standard, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 60 ditëve që nga data e skadimit të kredisë .
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 60 ditë pa e paguar këtë tejkalim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të paguar këstet e kredisë sipas kontratës (duke përfshirë edhe interesin) për më tepër se 60 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 60 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria D-Dyshimtë

Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, përmbajnë të gjitha dobësitë të cilat janë të qenësishme në kreditë Nën Standarde, por të cilat theksojnë që ekzistojnë mundësitë e forta që pjesa e rëndësishme e shumës së këstit nuk do të paguhet. Ka mundësi të humbjes, mirëpo shuma e saktë nuk mund të definohet saktësisht në rastin e shqyrtimit apo kjo varet edhe nga shfaqja e ndonjë veprimi apo rasti në të ardhmen. Ndonëse mundësia e humbjes është jashtëzakonisht e lartë, për shkak të faktorëve të rëndësishëm dhe të pazgjidhur specifik, por të cilët mund të funksionojnë për të mirën dhe përforcimin e kredisë, klasifikimi i saj si humbje e përafërt mund të shtyhet deri sa të përcaktohet një status më i saktë. Shembuj të faktorëve të tillë përfshihen por nuk janë të limituar në bashkimin, përvetësimin, ristrukturimin e kapitalit, si dhe furnizimin me kolaterale të reja apo plane të reja të rifinancimit. Garantuesve që nuk bashkëpunojnë apo atyre që janë në një gjendje të dobët financiare nuk duhet të konsiderohen si të aftë për të mbështetur kredinë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiar (vazhdim)

v. Zhvlerësimi i pasurive financiare (vazhdim)

Mbështetje në çfarëdo kolaterali të disponueshëm që nuk do të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar shumën gjithashtu mund të arsyetojnë klasifikimin e dyshimtë.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet si i dyshimtë, të paktën nëse kriteret në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 90 ditëve që nga data e skadimit .
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 90 ditë pa e paguar këtë tejkalim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 90 ditë.
- (d) Nëse ka mungesë në gjendjen financiare të klientit që ka shkaktuar kapital negativ.
- (e) Nëse afati i kthimit/përfundimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 90 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria E- Kreditë e këqija (humbje) –janë ato ekspozime të cilat të bazuara mbi një analizë të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, kanë vlerë të vogël ose do të kërkojnë një periudhë shtesë për të realizuar ndonjë vlerë dhe nuk janë më të arsyeshme që të mbahen në librat aktive të bankës.

Një ekspozim mund të konsiderohet si i ekspozim i keq (humbje) nëse ndonjë nga kriteret në vijim aplikohet:

- (a) Nëse depozitat/rrjedha e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e mbitërheqjes të papaguar brenda 180 ditëve nga data e skadimit të mbi tërheqjes.
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar të kredisë mbi 5% apo më shumë për mbi 180 ditë pa e paguar këtë mbitërheqje apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 180 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit/data e skadimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 180 ditë për arsye të mospagimit.

Zhvlerësimi dhe provizionet për pjesën e ngelur të portofolit të kompanive, pronarëve apo klientëve individual (llogaritë e arkëtueshme nga klientët të cilët individualisht nuk janë relevant) dhe për të arkëtueshmet nga klientët individualisht të rëndësishëm (përveç bankave) për të cilët nuk ka dëshmi të zhvlerësimit, kalkulohen në bazë grupore (qasja e portofolit). Huatë në grupe më tutje ndahen në këto kategori, kompani dhe grupe pronarësh të klientëve me pakicë në bilanc të gjendjes. Të gjitha këto tri grupe më tutje ndahen në pesë nën-kategori, A, B, C, D dhe E.

Kur një kredi konsiderohet si e pambledhshme, atëherë shlyhet (write off) ndaj provizioneve përkatëse për zhvlerësimin e kredisë. Kreditë e tilla shlyhen pasi të ndërmerren të gjitha procedurat e nevojshme të kompletohen dhe shuma e humbjes të përcaktohet. Rikthimet e mëpasshme e shumave që më herët janë shlyer i kreditohet fitimit apo humbjes.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiar (vazhdim)

v. Zhvleresimi i pasurive financiare (vazhdim)

Nëse shumat e provizionit për zhvleresimin e kredisë zvogëlohet më pas për shkak të ndonjë ngjarje pas regjistrimit, atëherë lirimi nga provizioni i kreditohet fitimit dhe humbjes.

Pasuritë financiare të gatshme për shitje – Banka vlerëson në secilën datë të bilancit të gjendjes nëse ka dëshmi objektive se pasuritë financiare të gatshme për shitje janë të dëmtuara. Në rast se investimet e ekuitetit janë të klasifikuara si të gatshme për shitje, atëherë zvogëlimi domethënës apo i zgjatur në vlerën fer të sigurisë nën koston e tij konsiderohet si dëshmi objektive e zhvleresimit. Nëse ekzistojnë dëshmi të tilla, atëherë humbja kumulative hiqet nga të hyrat tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në fitim dhe humbje. Humbjet nga zhvleresimi i njohur në fitim dhe humbjet në instrumentet e ekuitetit nuk janë kthehen përmes fitimit dhe humbjes, dhe rritet domethënës në vlerë fer pas zhvleresimit regjistrohen në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse.

Nëse në një periudhë pasuese vlera fer e një instrumenti debitor e klasifikuar si të gatshme për shitje rritet, dhe rritja objektive mund t'i atribuohet një ndodhie që ka ngjarë pas regjistrimit të humbjes nga zhvleresimi në fitim dhe humbje, humbja nga zhvleresimi kthehet përmes fitimit dhe humbjes.

Për përcaktimin e humbjeve nga zhvleresimi në instrumentet debitor merren parasysh këta faktorë:

- Dështimi apo delikuenca në pagimin e interesit dhe kryegjësë;
- Vështirësi likuiditeti të emetuesit;
- Shkelja e marrëveshjes apo kushteve të kontratës;
- Bankrotimi i emetuesit;
- Përkeqësimi i gjendjes ekonomike dhe të tregut; dhe
- Përkeqësimi në klasifikimin kreditor të lëshuesit më ulët se niveli i pranueshëm.

Humbjet nga zhvleresimi i njohur në fitim dhe humbje matet si dallimi në mes të vlerës kontabël të pasurisë financiare dhe vlerës të drejtë aktuale të tij. Vlera fer aktuale e instrumentit është çmimi i tij i tregut apo rrjedhat e ardhshme të diskontuara të parasë, aty ku nuk mund të merret çmimi i tregut.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Valutat e huaja

Transaksionet në valuta tjera përkthehen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi dhe humbjet nga këmbimi i huaj i cili rezulton nga marrëveshjet e transaksioneve të tilla, dhe nga përkthimi i pasurive dhe detyrimeve monetare në valuta të huaja evidentohen në fitim dhe humbje (si fitim dhe humbje neto e shkëmbimit të huaj).

Zerat jo-monetare të cilat maten në aspektin e kostos historike në një valutë huaj nuk ri-konvertohen.

2.8 Pasuritë, prona dhe impiantet

Pasuritë, prona dhe impiantet mbahen me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi, aty ku është e nevojshme. Çdo vit, banka vlerëson nëse ka indikatorë se pasuritë mund të jenë dëmtuara. Nëse ekzistojnë indikatorë të tillë, atëherë vlerësohen shumat e rikthyeshme. Shuma e vlerësuar e rikthyeshme është më e lartë se vlera fer e një pasurie minus koston për ta shitur dhe vlera e saj në përdorim. Kur vlera kontabël e një pasurie është më e madhe se shumata e vlerësuar e saj e rikthyeshme, atëherë shënohet në shumën e rikthyeshme dhe diferenca i ngarkohet fitimit dhe humbjes.

Fitimet dhe humbjet e pronës, objekteve dhe pajisjeve përcaktohen sipas referimit në vlerën e tyre kontabël dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultateve operative për atë periudhë. Riparimet dhe mirëmbajtjet i ngarkohen fitimit dhe humbjet aty ku ka pasur shpenzime.

Zhvlerësimi zbatohet duke përdorur metodën e direkte, përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të dobishme të çdo gjëje të pronës dhe pajisjeve. Zhvlerësimet e mëtutjeshme zbatohen në muajin pasues të blerjes ndërsa për largimin e tyre deri në muajin e largimit nga librat kontabel. Zhvlerësimi nuk fillon derisa pasuritë të jenë të gatshme për shfrytëzim.

Normat vjetore të zhvlerësimit të përdorura për secilën kategori të pronës, ndërtesave dhe pajisjeve janë:

Kategoria e pasurive	Normat e përdorura të zhvlerësimit
Përmirësimi i objekteve të marrë me qira	5 vite apo afati i qirasë, cila do që është më e shkurtër
Mobiljet dhe pajisjet tjera	3-5 vite
Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse	3-5 vite
Automjetet motorike	5 vite

2.9 Pasuritë afatgjata materiale

Pasuritë fizike të fituara nga Banka mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet nga dëmtimi, aty ku është e nevojshme. Amortizimi zbatohet në bazë të metodës lineare me normë vjetore prej 20%.

Shpenzimet e mëpasshme në pasuritë e kapitalizuara jo-fizike kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme fizike të mishëruara në pasuritë fizike përkatëse. Të gjitha harxhimet tjera janë shpenzime të shkaktuara. Amortizimi nuk fillon derisa pasuritë të jenë të gatshme për shfrytëzim.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.10 Pasuritë e konfiskuara

Pasuritë e konfiskuara paraqesin pasuritë financiare dhe jo-financiare të fituara nga banka në zgjidhjen e kredive në vonesë. Pasuritë së pari njihen me vlerë fer atëherë kur merren dhe vendosen në hapësira, dhe pajisje, pasuri tjera financiare apo inventare në kuadër të pasurive tjera varësisht nga natyra e tyre dhe nga qëllimi i bankës përkitazi me rikthimin e këtyre pasurive, dhe më pas rivleresohen dhe merren parasysh në pajtim me politikat kontabël për këto kategori të pasurive.

2.11 Zhvleresimi i pasurive jo-materiale

Një humbje nga zhvleresimi njihet sa herë që vlera kontabële e një pasurie tejkalon shumën e tij të rikthyeshme. Shuma e rikthyeshme e një pasurie është më e lartë se vlera fer e saj minus kostoja për shitje dhe vlera në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera aktuale e rrjedhave të vlerësuar të ardhshme të pasasë të pritura nga shfrytëzimi i vazhdueshëm dhe nga hedhja e tij.

2.12 Detyrimet për bankat

Detyrime ndaj bankave janë të regjistruara kur paratë ose asetet tjera janë dhënë avanc në bankë nga bankat palëve tjera. Detyrimet jo-derivative realizohen me kosto të amortizuar.

2.13 Detyrime për klientët

Detyrimet për klientët janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, shtetit apo bizneseve dhe mbahen me kosto të amortizuar.

2.14 Huamarrjet

Huamarrjet fillimisht regjistrohen me vlerë fer, neto të kostove të transaksionit. Huamarrjet më pas mbahen me kosto të amortizuar. Çdo interes apo tarifë që ka të bëjë me fondet e marura hua është shpenzim sipas normës efektive të interesit dhe e paraqitur në fitim dhe humbje për periudhën.

Kostot e huamarrjes të cilat drejtpërdrejt i atribuohen blerjes, ndërtimit apo prodhimit të një pasurie kualifikuese, regjistrohen si pjesë e kostos të asaj pasurie. Të gjitha kostot tjera të huamarrjes evidentohen si një shpenzim në periudhën në të cilën janë bërë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.15 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim kalkulohet në bazë të rregulloreve të zbatueshme në Kosovë duke përdorur norma tatimore në datën e bilancit të gjendjes. Efektive nga 1 Janari 2010, norma e tatimit në të hyrat e korporatës është 10% në pajtim me rregulloret e Kosovës për tatim aktualisht në fuqi, Ligji 03/L-162 mbi tatimin në të ardhura të korporatës.

Ngarkimi me tatim në të ardhura në fitim dhe humbje për vitin përbëhet nga tatimi aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual kalkulohet në baza të fitimit të pritur të tatueshëm për vitin, duke përdorur norma tatimore të zbatueshme apo substancialisht në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Fitimi i tatueshëm dallon nga fitimi i raportuar në fitim dhe humbje, ngase përjashton zërat e të ardhurave apo shpenzimeve që janë të tatueshme apo që zbriten në vitet tjera, dhe përjashton zërat që kurrë nuk tatohen apo zbriten. Tatimet tjera, përveç tatimit në të ardhura, regjistrohen në kuadër të shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë në të ardhura llogaritet duke përdorur metodën e obligimit të bilancit të gjendjes për diferencat e përkohshme që dalin nga baza e tatimeve të pasurive dhe detyrimeve, dhe shumat e tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar. Pasuritë e tatimit të shtyrë regjistrohen deri në atë masë që ka të ngjarë se fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i disponueshëm, ndaj së cilave diferencat e përkohshme mund të shfrytëzohen. Pasuritë e tatimit të shtyrë zvogëlohen deri në atë masë sa që nuk ka të ngjarë se përfitimet përcjellëse tatimore do të realizohen.

Detyrimet dhe pasuritë e tatimit të shtyrë maten me normë tatimi që pritet të zbatohet në periudhën kur pasuria realizohet apo obligimi vendoset në bazë të normave tatimore të cilat janë në fuqi apo substancialisht në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Detyrimet dhe pasuritë e tatimit të shtyrë bëhen net kur ekziston e drejta ligjërish të zbatueshme për net pasuritë aktuale tatimore ndaj detyrimeve tatimore, dhe kur ato ndërlidhen me tatimet në të ardhura të imponuara nga ndonjë autoritet tatimor.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.16 Angazhimet e zërave jashtë-bilancor dhe ngjarjet e paparashikuara

Në kuadër të punës së saj, banka ka hyrë në zotime jashtë-bilancore, si garancionet, zotimet për të dhënë kredi, letër kredi dhe transaksione me instrumente financiare. Provizionet për humbje në zotime dhe detyrimet e mundshme mirëmbahet në nivelin adekuat për të absorbuar humbjet e ardhshme të mundshme. Menaxhmenti përcakton provizionet adekuate në bazë të shqyrtimit të zërave individual, përvojës së fundit të humbjes, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të rrezikut të kategorive të ndryshme të transaksioneve dhe faktorëve tjerë përkatës.

Kontratat për garancione financiare janë kontrata të cilat kërkojnë nga emetuesi të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për ndonjë humbje të shkaktuar nga një debitor specifik që ka dështuar të paguajë me kohë sipas kushteve të borxhit. Garancionet e tilla financiare i jepen bankave, institucioneve financiare dhe entiteteve tjerë në emër të klientëve për të siguruar kredi, mbitërheqje dhe shërbime tjera bankare.

Garancionet financiare në datën e lëshimit regjistrohen me vlerë fer, e cila është ekuivalente me shumën e tarifës së pranuar. Tarifa amortizohet në fitim dhe humbje përgjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën e linjës së drejtë. Detyrimet e bankës në garancione më pas maten sipas: matjes fillestare, minus amortizimi i kalkuluar për të regjistruar të hyrat nga tarifa përgjatë periudhës së garancionit, apo vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të permbushur obligimin.

Garancioni për kompletim – janë kontrata që kërkojnë nga emetuesi të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një shpenzim të shkaktuar ngase një debitor i caktuar ka dështuar të kryej punën me kohë, në pajtim me kontratën.

Garancionet në datën e lëshimit regjistrohen me vlerë fer e cila është e barabartë me shumën e tarifës së pranuar. Tarifa amortizohet në fitim dhe humbje përgjatë periudhës së kontratës, duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e bankës nën garancion më pas maten sipas:

- Matja fillestare, minus amortizimi i kalkuluar për të regjistruar të hyrat nga tarifa përgjatë periudhës së garancionit; apo
- Vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të permbushur obligimin.

2.17 Provizionet

Provizionet njihen kur banka ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh ekonomike që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të matet me besueshmëri. Provizionet maten sipas vlerësimit më të mirë të menaxhmentit mbi shpenzimet e kërkuara për të permbushur obligimin në ditën e bilancit të gjendjes dhe zbritet për të prezantuar vlerën aty ku efekti është material.

2.18 Përfitimet e te punesuarve

Banka paguan kontribute për planin pensional të administruar nga Trusti Pensional i Kosoves (TKPK) në baza të obligueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që kontributet të paguhen. Kontributet regjistrohen si shpenzime për përfitim të te punesuarve atëherë kur ato duhet të paguhen.

2.19 Qiratë operative

Pagesat e bëra për qiratë operative i ngarkohen shpenzimeve me menyre lineare përgjatë kohës së qirasë. Kur një qira operative përfundon para skadimit, çdo pagesë e bërë qiradhënësit përmes penalizimeve regjistrohet si një shpenzim në kohën kur të ndodh shkëputja.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.20 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Në zbatimin e politikave kontabël të bankës, të cilat janë të përshkruara në shënimin 3, nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozimeve mbi vlerat kontabël të pasurive dhe të detyrimeve, të cilat nuk janë të gatshme nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet përcjellëse bazohen në shpenzimet historike dhe në faktorë tjerë të cilët konsiderohen relevant. Rezultatet aktuale mund të jenë ndryshe nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen vazhdimisht. Ndryshimet në vlerësimet kontabël regjistrohen në periudhën në të cilën është ndryshimi, nëse ky i fundit prek vetëm atë periudhë, apo në periudhën e ndryshimt dhe periudhat pasuese, nëse ndryshimi prek periudhën aktuale dhe ato të ardhshme.

a) Zhvlerësimi i kredive të klientëve

Në konstatimin se a janë kreditë e klientëve të rëna në vlerë në baza individuale, kjo kërkon vlerësimin e vlerës aktuale të rrjedhave të pritura të parasë nga kreditë e klientëve, përfshirë shumat e ri-kthyeshme nga hipotekat e shkallës së parë. Menaxhmenti i bankës përdor gjykimin e tij në vlerësimin e rrjedhave të pritura të parasë nga portofoli kreditor dhe nga ri-kthimi i hipotekave të shkallës së parë. Rezultatet mund të jenë shumë të ndryshme. Supozimet kyçe të shfrytëzuara në vlerësimin e huas së klientit bazohen në pozitën, profitabilitetin, pjesën në treg dhe vlerën e kolateralit, si burime kryesore të rrjedhës së pritur të parasë. Rrethanat e ngjashme, që mbizotërojnë në regjionin e klientit merren parasysh, si p.sh. efikasiteti i gjykatës.

Aty ku neto vlera e rrjedhave të pritura të parasë dallon me +/-1%, humbja nga zhvlerësimi do të vlerësohet 23 mijë EUR më ulët apo 23 mijë EUR më lartë (2012: 18 mijë EUR).

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET

Standardet e reja dhe interpretimet e tyre si më poshtë kanë hyrë në fuqi për bankën me 1 Janar 2013:

SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" (lëshuar në maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1 janarit 2013), i cili zëvendëson të gjitha udhëzimet për kontroll dhe konsolidim në SNK 27 "Pasqyrat Financiare të konsoliduara dhe individuale" dhe në CIS-12 "Konsolidimi – entitetet për qëllime të veçanta". SNRF 10 ndryshon përkufizimin e kontrollit në mënyrë që të njejtat kritere të zbatohen për të gjitha bjësitë e ekonomike për të përcaktuar kontrollin. Standardet nuk kanë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta", (lëshuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1 janarit 2013), i cili zëvendëson SNK 31 "Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta" dhe CIS-13 "Entitetet e Kontrolluara Bashkarisht – Kontributeve jomonetare nga Sipërmarrësit". Ndryshimet në përkufizime e kanë reduktuar numrin e llojeve të marrëveshjeve të përbashkëta dhe ndërmarrjeve të përbashkëta. Rregulla ekzistuese e zgjedhjes së konsolidimit proporcional për njësitë e ekonomike të kontrolluara bashkarisht është eliminuar. Kontabiliteti i dyfishtë është i detyrueshëm për pjesëmarrësit në sipërmarrjet e përbashkëta. Standardet nuk kanë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 12 "Shënimet shpjeguese mbi interesat në njësi të tjera ekonomike", (lëshuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1 janarit 2013) zbatohen për njësitë ekonomike që kanë një interes të një filialim një marrëveshje të përbashkët, një pjesëmarrje ose një njesi ekonomike të pakonsoliduar të strukturuar. Ajo zëvendëson kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të gjetura më parë në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje". SNRF 12 kërkon që njësitë ekonomike të japin informacione shpjeguese që i ndihmon lexuesit të pasqyrave financiare të vlerësoj natyrën, rreziqet dhe efektet financiare të lidhura me interesin e njësisë ekonomike në filiale, pjesëmarrje, marrëveshje të përbashkëta dhe subjektet e pakonsoliduara të strukturuar. Për të përmbushur këto objektiva, standardi i ri kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese në një numër fushash, duke përfshirë gjykimet e rëndësishme dhe supozimet e bëra në përcaktimin nëse një njesi ekonomike kontrollon ose në mënyrë të konsiderueshme ndikon në interes të saj në subjekte tjera dhënie e informacioneve shpjeguese zgjeruar në pjesën e interesave jo-kontrolluese në aktivitetet e grupit dhe flukset e parave, përmbledhur informatat financiare të filialeve me interesa jo-kontrolluese materiale, dhe informacioneve të dhëna të detajuara të interesave në subjektet e pakonsoliduara të strukturuar. Banka nuk pret që të ketë ndonjë ndryshim apo efekt material në pasqyrat e saj financiare.

SNRF 13 "Matja e Vlerës së Drejtë", (lëshuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1 janarit 2013), i cili ka për qëllim të përmirsojë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe të përmirsojë qëndrueshmërinë e kompleksitetit duke dhënë një përkufizim të saktë të vlerës së drejtë. Banka nuk pret që të ketë ndonjë ndryshim apo efekt material në pasqyrat e saj financiare.

SNK 27 "Pasqyrat Financiare Individuale" dhe SNK 28 "Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkët", (rishikuar në Maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1 janarit 2013), të cilat u ndryshuan nga SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta". Standardet nuk kanë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (vazhdim)

SNK 28 "Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" (rishikuar në maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013). Ndryshimi i **SNK 28 si rezultat i projektit të Bordit mbi sipërmarrjet e përbashkëta**. Kur u diskutuat projekti, Bordi vendosi që të përfshijë kontabilitetin për ndërmarrjet e përbashkëta duke përdorur metodën e kapitalit neto në **SNK 28**, sepse kjo metodë është e aplikueshme për të dy ndërmarrjeve të përbashkëta dhe bashkëpunëtorët. Me këtë përjashtim, udhëzimet e tjera mbetën të pandryshuara. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në **SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" (lëshuar në qershor 2011, në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2012)** ndryshuan daljen e zërave të paraqitur në kapitalin neto. Ndryshimet kërkojnë që njësitë ekonomike për zëra të veçantë të paraqiten në kapitalin neto në dy grupe, të bazuara nëse janë apo jo ata mund të riklasifikohen në fitim ose humbje në të ardhmen. Titulli sugjeres i përdorur nga **SNK 1** ka ndryshuar në "pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse". Standardi i ndryshuar rezultoi me paraqitjen e ndryshuar të pasqyrave financiare, por nuk kanë ndonjë ndikim në matjen e transaksioneve dhe bilanceve.

Ndryshuar **SNK 19 "Përfitimet e punonjësve" (publikuar në qershor 2011, në fuqi për periudhat që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013)** ka bërë ndryshime të rëndësishme në njohjen dhe matjen e shpenzimeve të përcaktuara për përfitimet e pensione dhe përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve, dhe për dhënien e informacioneve shpjeguese për të gjitha përfitimet e punonjësve. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në pasivin neto të përcaktuar të përfitimit (aseteve), kur ato ndodhin, si në vijim: (i) koston e shërbimit dhe interesi neto në fitim ose humbje, dhe (ii) rimatje në kapitalin neto. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

"Dhënia e informacioneve shpjeguese - Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare" - Ndryshimet në **SNRF 7** (nxjerrë në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013). Ndryshimi kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese që mundësojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të konsoliduara të një njësie ekonomike për të vlerësuar efektin ose efektin potencial të marrëveshjeve të ndërlidhura, duke përfshirë të drejtat e kompensimit.

Përmirësimet në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (i lëshuar në maj 2012 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2013v). Përmirësimet konsistojnë ndryshimet e pesë standardeve. **SNRF 1** u ndryshua (i) që të qartësojë se një njësi ekonomike që vazhdon përgatitjen e pasqyrave financiare sipas **SNRF**-ve mund të ose në mënyrë të përsëritur zbatojë **SNRF 1** apo të aplikoni të gjitha **SNRF** në mënyrë retrospektive, si dhe nëse entiteti nuk e ka ndaluar aplikimin e tyre, dhe (ii) për të shtuar një përjashtim nga zbatimi i **SNK 23** "kostot e huamarrjes", në mënyrë retrospektive nga adoptuesit për herë të parë. **SNK 1** është ndryshuar për të sqaruar se shënimet shpjeguese nuk janë të nevojshme për të mbështetur bilancin e tretë bilancin e paraqitur në fillim të periudhës së mëparshme kur është parashikuar për shkak se ajo është ndikuar materialisht nga një riparqitje retrospektive, ndryshimet në politikat kontabël ose riklasifikimeve për qëllime prezantimi, ndërsa shënimet shpjeguese do të kërkohej kur një njësi ekonomike vendos vullnetarisht për të dhënë deklarata të tjera krahasuese. **SNK 16** u ndryshua për të sqaruar që pajisjet për shërbim që janë përdorur për më shumë se një periudhë klasifikohet si pronë, impiante dhe pajisje në vend të inventarit. **SNK 32** u ndryshua për të sqaruar se pasojat e caktuara tatimore të shpërndarjeve tek pronarët duhet të kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave siç kërkohej gjithmonë nga **SNK 12**. **SNK 34** u amendua për të sjellë kërkesat e saj në përputhje me **SNRF 8**.

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (vazhdim)

SNK 34 tani kërkon dhënien e një mase të totalit të aktiveve dhe detyrimeve për një segment shfrytëzimi vetëm nëse informata përkatëse i jepet rregullisht vendimmarrësve dhe ka pasur një ndryshim material në ato masa që nga pasqyrat e fundit financiare vjetore. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

"Ndryshimet në Tranzicionin udhëzues në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12 " (publikuar në qershor të vitit 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2013) . Ndryshimet qartësojnë udhëzimet e tranzicionit në "Pasqyrat e Konsoliduara Financiare " SNRF 10 . Njësitë ekonomike që adoptojnë SNRF 10 duhet të vlerësojë kontrollin në ditën e parë të periudhës vjetore në të cilën SNRF 10 është e miratuar , dhe në qoftë se konkluzioni konsolidimi nën SNRF 10 ndryshon nga SNK 27 dhe CIS 12, periudhën që menjëherë paraprinë krahasues (pra , viti 2012) është riparaqitur , përveç nëse e pazbatueshme . Ndryshimet gjithashtu sigurojnë lehtësim shtesë tranzicionit në SNRF 10 , SNRF 11 " Marrëveshjet e përbashkëta " dhe SNRF 12 "Shpalosja e interesave në entitetet tjera " , duke kufizuar kërkesën për të siguruar informacion rregulluar krahasues vetëm për periudhën që menjëherë paraprinë krahasues . Më tej, ndryshimet heqin kërkesën për të paraqitur informacion krahasues për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me subjektet e pakonsoliduara të strukturuar për periudha para 12 SNRF zbatohet për herë të parë. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Standardet tjera të rishikuara dhe interpretime: IFRIC 20 "Heqje Shpenzimet në fazën e prodhimit të një Miniera Sipërfaqësore", konsideron kur dhe si për të llogaritur përfitimet që rrjedhin nga aktiviteti nxjerrje në industrinë e minierave. Interpretimi nuk kishte ndikim në pasqyrat financiare të Bankave. Ndryshimet në SNRF 1 "adoptimit për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Kredi Qeveritare", të cilat janë lëshuar në Mars 2012 dhe janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2013, japin adoptuesit për herë të parë e lëshuar nga SNRF zbatimin e plotë retrospektiv të kontabilitetit kërkesat për kredi nga qeveria në nën normat e tregut. Ky interpretim nuk është i aplikueshëm për operacionet e Bankës.

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (vazhdim)

3.1 SHPALLJET E REJA TË KONTABILITETIT

Disa standarde të reja dhe interpretime janë lëshuar që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014 ose më vonë, dhe të cilat Banka nuk i ka miratuar në fillim.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare: Klasifikimi dhe Matja".

Karakteristikat kryesore të standardit të lëshuar në nëntor 2009 dhe ndryshuar në tetor 2010, Dhjetor 2011 dhe nëntor 2013 janë:

- Aktivet financiare janë të nevojshme për të klasifikohen në dy kategori të matjes: ata që do të maten me vlerën e drejtë, dhe të atyre që do të matet më pas me koston e amortizuar. Vendimi duhet të bëhet në njohjen fillestare. Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e instrumenteve të saj financiare dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të instrumentit.
- Një instrument matet më pas me koston e amortizuar vetëm nëse ajo është një instrument borxhi dhe nëse që të dyja (i) objektivi i modelit të biznesit të njësisë ekonomike është që të mbajë aktivin për të mbledhur flukset monetare kontraktuale, dhe (ii) flukset kontraktuale të aktivit përfaqësojnë pagesa të principalit dhe vetëm interesin (që do të thotë, ajo ka vetëm "karakteristika themelore të kredisë"). Të gjitha instrumentet e tjera të borxhit duhet të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- Të gjitha instrumentet e kapitalit duhet të maten me vlerën e drejtë. Instrumentet e kapitalit neto që janë të mbajtura për tregtim do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për të gjitha investimet e tjera të kapitalit të një zgjedhje definitive mund të bëhet në njohjen fillestare, për të njohur fitimet e përcaktuara dhe të realizuara nga vlera e drejtë dhe humbjet përmes kapitalin neto dhe jo fitit ose humbjes. Nuk duhet të ketë riciklimit të fitimeve të vlerës së drejtë dhe të humbjeve në fitim ose humbje. Këto zgjedhje mund të bëhen në një bazë instrument-nga-instrument. Dividendët duhet të paraqiten në fitim ose humbje, për aq kohë sa ato përfaqësojnë një kthim të investimit.
- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë bartur të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshim i rëndësishëm është që një njësi ekonomike do të kërkohej që të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë të detyrimeve financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në kapitalin neto.
- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës kanë ndryshuar që të mbrojnë kontabilitetin më afër me menaxhimin e riskut. Standarti i lejon subjektet afariste që të zgjedhin zgjedhin politikën kontabël midis aplikimit kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të SNRF 9 dhe duke vazhduar të zbatojë SNK 39 për të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktualisht nuk e trajton kontabilizimin e mbrojtjes makro.

Ndryshimet e bëra në SNRF 9 në nëntor 2013 bien si date e detyrueshme efektive, duke e bërë kështu zbatimin e standardit vullnetar. Banka nuk do të miratojë versionin ekzistues të SNRF 9.

"Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare" - Rishikimi i SNK 32 (publikuar në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014). Amendamenti ka shtuar udhëzime të aplikimit të SNK 32 për të trajtuar mospërputhjet e identifikuar në zbatimin e disa prej kritereve të kompensimit. Kjo përfshin sqarimin e kuptimit të "aktualisht ka detyrimisht të drejta për kompensim" dhe se disa sisteme të shlyerjes bruto mund të konsiderohet ekuivalent me shlyerje neto. Banka nuk pret që ndryshimet të kenë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (vazhdim)

3.1 SHPALLJET E REJA TË KONTABILITETIT

***"Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 - Subjektet e Investimeve"* (publikuar më 31 tetor 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2014).** Amendamenti futi një përkufizim të një njësie ekonomike të investimeve si një njësi ekonomike që (i) fiton fonde nga investitorët me qëllim të siguruar të shërbimeve të menaxhimit të investimeve, (ii) angazhohet për investitorët e saj për qëllime të biznesit që është për të investuar fonde vetëm për vlerësimin e kapitalit ose të ardhurat e investimeve dhe (iii) masat dhe vlerësimin e investimeve të saj mbi bazën e vlerës së drejtë. Një njësi ekonomike investim do të jetë e nevojshme për të llogaritur për degët e saj me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, dhe për të konsoliduar vetëm ato degë që ofrojnë shërbime që kanë të bëjnë me aktivitetet e investimeve të njësisë ekonomike. SNRF 12 u amendua për të futur informacione shpjeguese të reja, duke përfshirë edhe gjykime të rëndësishme të bëra në përcaktimin nëse një njësi ekonomike është një njësi investim dhe informacion në lidhje me mbështetjen financiare apo tjetër në një filial të pakonsoliduar. Banka nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

IFRIC 21 - "Vënie taksash" (lëshuar më 20 maj 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2014). Interpretimi sqaron kontabilizimin e një detyrimi për të paguar një taksë që nuk është tatimi në të ardhura. Ngjarje detyruese që i jep të rritet në një detyrim është ngjarja identifikuar nga legjislacioni që krijon detyrimin për të paguar taksë. Fakti që një njësi ekonomike është ekonomikisht detyruar të vazhdojë të veprojnë në një periudhë të ardhshme, ose përgatit pasqyrat e saj financiare në kuadrin e vijimësisë supozim, nuk krijon një detyrim. Të njëjtat parime të njohjes të zbatohet në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore. Aplikimi i interpretimit të pasiveve që lindin nga skemat emisionet tregtare është fakultative. Banka nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare. Ndryshimet në SNK 36 - "Dhënie informacionesh shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo-financiare" (të publikuara në maj 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2014, aplikimi më herët është e lejuar nëse SNRF 13 zbatohet për të njëjtën periudhë të kontabilitetit dhe krahasuese). Ndryshimet kanë hequr kërkesën për të ditur shumën e rikuperueshme kur një CGU përmban emër të mirë ose aktiveve jo-materiale të pakufizuar për kohën e jetuar, por nuk ka pasur asnjë dëmtim. Banka nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

***Ndryshimet në SNK 39. "Novacion i derivateve dhe vazhdimin e kontabilitetit mbrojtës"* (publikuar në qershor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2014)** Amendamentet do të lejojnë kontabiliteti mbrojtës për të vazhduar në një situatë ku një derivativ, që i është caktuar si një instrument mbrojtës, është e ripërtirë (dmth. palët kanë rënë dakord për të zëvendësuar kundërparti e tyre origjinale me një të re) për të kryer pastrimin me një palë qendrore, si rezultat i ligjeve dhe rregullore, nëse plotësohen kushtet specifike. Banka nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

***Ndryshimet në SNK 19 - "Definuar planet e përfitimit: kontributet e punonjësve"* (lëshuar në nëntor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë 1 korrik 2014).** Ndryshimi i lejon njësitë ekonomike për të njohur kontributet e punonjësve si një reduktim të kostos së shërbimit në periudhën në të cilën shërbimi punonjësi është dhënë, në vend të atribuar kontributet për periudhat e shërbimit, në qoftë se shuma e kontributeve të punonjësve është i pavarur nga numri e viteve të shërbimit. Ndryshimi nuk pritet të ketë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Përveç nëse ndryshe përcaktohet më sipër, standardet e reja dhe interpretimet nuk pritet të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në pasqyrat financiare të Bankës.

4. PARAJA E GATSHME DHE GJENDJA ME BANKAT

	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
Paraja në dorë	17,289	12,839
Llogaritë rrjedhëse me bankat	2,212	3,043
Depozita brenda një nate	-	1,062
Bonot e thesarit me Bankën Qendrore	140	259
Paraja e mbajtur në Bankën Qendrore		
Llogaria rrjedhëse	32,178	3,424
Rezerva e obligueshme	29,333	23,244
Gjithsej paraja e gatshme dhe gjendja me bankat	<u>81,152</u>	<u>43,871</u>

4.1 PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASË

	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
Paraja në dorë dhe në banka	19,641	17,203
Gjendja pa restriksione me BQK	32,178	3,424
Depozita me maturim më pak se 3 muaj (shënim 6)	17,749	28,322
Gjithsej paraja dhe ekuivalentet e parasë	<u>69,568</u>	<u>48,949</u>

5. KREDI DHE PARADHËNIE PËR BANKAT

	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
Afatizimet	17,749	28,321
Interesi akrual	-	1
Totali i kredive dhe paradhënieve për bankat	17,749	28,322
Afatshkurter	17,749	28,322

Interesi vjetor i fituar i afatizimeve në normat në vijim luhatet në mes të:

2013	2012
për Euro 0.10 % to 1.50 %	për Euro 0.5 % to 1.25 %
për USD 0.3 % to 1.255%	për USD 0.2 % to 2.5%

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Kreditë të klientëve	209,128	166,020
Mbitërheqjet	47,073	45,315
Kreditë kartelat	26,893	21,109
	283,094	232,444
Provizionet per humbjet nga kreditë	(17,034)	(9,667)
Gjithsej kreditë e klientëve	266,060	222,777
Afatshkurtër	80,290	63,883
Afatgjatë	185,770	158,894

Mbitërheqjet paraqesin kredi suazore afat-shkurter dhe kredi konsumuese.

Me 31 Dhjetor, 2013, kreditë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë të hyrat nga interesi akrual prej 2,096 mijë EUR (2012: 1,713 mijë EUR).

Lëvizjet në shpenzimet e zhvlerësimit per humbjet nga kredite janë si në vijim:

	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
Rezervimet për humbjet nga kreditë me 1 Janar	9,667	5,379
Shpenzimi gjatë vitit	7,387	4,299
Huatë e shlyera	(19)	(11)
Gjithsej rezervimet për humbjet nga kreditë e klientëve më 31 Dhjetor	17,034	9,667

Ngarkimi i fitimit dhe humbjes për shpenzimet e rezervimeve për humbjet nga kreditë është i detajuar si më poshtë:

	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
Shpenzimet e për humbjet nga kreditë e klientëve	7,387	4,299
Gjithsej ngarkimet e fitimit dhe humbjes për shpenzimet e rezervimeve për humbjet nga kreditë e klientëve	7,387	4,299

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Provizionet e ngarkuara individëve:	4,145	2,673
Kreditë e klientëve	2,255	1,366
Mbitërheqjet	72	15
Kreditë kartelat	1,818	1,292
Provizionet e ngarkuara personave juridik:	12,889	6,994
Kreditë e klientëve	10,147	6,178
Mbitërheqjet	2720	816
Kredit Kartelat	22	-
Gjithsej	17,034	9,667

Më poshtë është paraqitur një analizë e industrisë të bruto portofolit të kredive për personat juridik para provizioneve:

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
	%age	%age
Ndërmarrje me shumicë	24.86%	28.46%
Prodhimet	7.39%	8.37%
Konsumi	7.88%	7.38%
Shërbimi	2.25%	2.42%
Hotele dhe restorante	1.87%	1.86%
Bujqësi	0.57%	0.34%
Ndërtimtari	3.47%	4.30%
Tjera	51.70%	46.87%
	100.00%	100.00%

Me 31 Dhjetor, 2013, 10 huamarrësit më të mëdhenj përbënin 8.8% (2012: 11.27%) të gjithë portofolit kreditor. Në kreditë për klientët janë të përfshira kreditë e dëmtuara me një balanc prej 18,520 mijë EUR, me 31 Dhjetor, 2013 (2012: 11,538 mijë EUR).

7. SHPENZIMET E REZERVIMEVE PËR HUMBJET E TJERA

Ngarkimi i fitimit dhe humbjes për shpenzimet e rezervimeve për humbjet e tjera është dhënë në detaje si më poshtë.

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Provizione per garancione	205	-
Provizione per pushimet e pashfrytezuara	15	31
Provizione per rastet gjyqsore	3	-
Gjithsej ngarkimet e fitimit dhe humbjes për shpenzimet e rezervimeve për humbjet e tjera	223	31

8. PASURITË FINANCIARE TË GATSHME PËR SHITJE

Pasuritë financiare të disponueshme për shitje prej 825 mijë EUR me 31 Dhjetor, 2013 (2012: EUR 608) paraqesin bonot e thesarit nga Banka Qendrore e Kosovës. Bonot e thesarit qeveritar për zbritje kanë maturitet që shtrihen nga 24 Prill, 2013 deri më 10 December, 2014 me yields që shtrihet nga 0.46% deri 2.26%.

9. PASURITË TJERA FINANCIARE

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
	-	
Mirëmbajtja e llogarive rrjedhëse dhe tarifat e kreditë kartelës	1,088	854
Pasuritë tjera financiare	174	57
Llogaritë e arkëtueshme nga institucionet tjera financiare	83	72
Llogaritë e arkëtueshme nga punonjësit	-	1
Gjithsej pasuritë tjera financiare	1,345	984
Afatshkurtër	1,345	984

10. PASURITË TJERA

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
		-
Shpenzimet e parapaguara	67	73
Kolaterali i konfiskuar në huat e pakthyeshme	63	63
Llogaritë e tjera të arkëtueshme	12	113
Gjithsej pasuritë tjera	142	249
Afatshkurtër	142	249

11. PASURITE THEMELORE

	Toka	Riparimet e objekteve të marra me qira	Mobilet, orenditë dhe pajisjet	Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse	Automjetet	Gjithsej
Kostoja:						
Me 1 Janar, 2012	-	2,683	151	4,148	688	7,680
Shtesat gjatë vitit	-	381	15	859	93	1,348
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	(76)	(31)	(107)
Me 31 Dhjetor, 2012	-	3,064	166	4,931	750	8,911
Shtesat gjatë vitit	1,200	505	82	1,023	215	3,025
Heqjet nga përdorimi	-	-	(3)	(7)	(41)	(51)
Me 31 Dhjetor, 2013	1,200	3,064	166	4,931	750	8,911
Zhvlerësimi i akumuluar:						
Me 1 Janar, 2012	-	1,649	105	2,461	323	4,538
Shpenzimet për vitin	-	602	24	839	145	1,610
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	(66)	(6)	(72)
Me 31 Dhjetor, 2013	-	2,251	129	3,234	462	6,076
Shpenzimet për vitin	-	425	34	797	126	1,381
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	(7)	(19)	(26)
Me 31 Dhjetor, 2013	-	2,676	163	4,024	569	7,432
Neto vlera kontabël:						
Me 31 Dhjetor, 2012	-	813	37	1,697	288	2,835
Me 31 Dhjetor, 2013	1,200	893	81	1,923	355	4,453

12. PASURITE AFATGJATA MATERIALE

	Softuer
Kostoja:	
Me 1 Janar, 2013	1,520
Shtesat	365
Me 31 Dhjetor, 2012	1,885
Shtesat	611
Me 31 Dhjetor, 2013	2,496
Amortizimi i akumuluar:	
Me 1 Janar , 2012	1,047
Shpenzimet për vitin	312
Me 31 Dhjetor, 2012	1,359
Shpenzimet për vitin	462
Me 31 Dhjetor, 2013	1,821
Neto vlera kontabël:	
Me 31 Dhjetor, 2012	526
Me 31 Dhjetor, 2013	675

Të gjitha pasuritë e paprekshme janë pasuri të fituara dhe të amortizuara përgjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme.

13. DETYRIME PËR KLIENTËT

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Depozitat pa afat		
Individët	93,360	67,315
NVM (Ndërmarrjet të vogla dhe të mesme)	41,396	28,355
Korporatave & Ndërmarrjeve Komerciale	29z,219	33,122
	<u>163,975</u>	<u>128,792</u>
Depozitat me afat		
Individët	109,458	87,807
NVM (Ndërmarrjet të vogla dhe të mesme)	31,915	23,865
Korporatave & Ndërmarrjeve Komerciale	21,884	29,905
	<u>163,257</u>	<u>141,577</u>
Gjithsej detyrimet për klientët	<u><u>327,232</u></u>	<u><u>270,369</u></u>
Afatshkurtër	290,970	246,281
Afatgjatë	36,262	24,089

Me 31 Dhjetor, 2013, detyrimet ndaj klientëve përfshijnë shpenzimet akruale të interesit prej 3,659 mijë EUR (2012: 2,402 mijë EUR). Analiza sipas klasit të biznesit për afatizimet dhe llogaritë rrjedhëse është si në vijim:

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Sektori	% e gjithsej borxhit ndaj konsumatorëve	% e gjithsej borxhit ndaj konsumatorëve
Individët	62%	57%
Ndërmarrjet dhe personat tjerë juridik	38%	43%
	<u>100%</u>	<u>100%</u>

14. DETYRIME TJERA FINANCIARE

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Llogaritë e pagueshme për bonusin e kredit kartelave	524	416
Transferet në pritje të klientëve	496	365
Borxhi i furnitorëve	336	242
SMS banking-mobile	83	97
Parapagimi për kreditë kartela	17	34
Gjithsej detyrimet tjera financiare	1,456	1,154
Afatshkurtër	1,456	1,154

15. DETYRIMET TJERA

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Provizionet për garancionet	403	198
Tatimet e mbajtura të pagueshme	216	224
Tatimi ne burim i pagueshëm	71	61
Tarifa e shtyrë	87	57
Kontributet e pagueshme për paga	44	35
Tatimi në të hyrat e personelit	32	27
TVSH dhe tatimet tjera të pagueshme	33	9
Provizionet për cështjet gjyqësore	3	-
Llogaritë tjera të pagueshme	93	6
Provizionet per pushimet e pa shfrytezuara	15	-
Gjithsej detyrimet tjera	997	617
Afatshkurtër	997	617

16. HUAMARRJET

	31 Dhjetor, 2013	31 Dhjetor, 2012
Huamarrjet e varura	11,000	6,500
Fondet tjera të marra hua	5,500	-
Tarifat e paguara paraprakisht të shtyra	(213)	(90)
Interesi akrual	35	14
Gjithsej huamarrjet	16,322	6,424
Afatshkurtër	3,000	-
Afatgjatë	13,322	6,424

(i) Huaja 1 nga IFC

Përgjatë vitit 2010, TEB. sh.a. ka hyrë në marrëveshje kredie me IFC – International Finance Corporation (Korporata Financiare Ndërkombëtare) në shumë prej 6,500 mijë EUR. Qëllimi i kredisë ishte pajisja e bankës me Tier 2 kapital, dhe të mundësohet shfrytëzimi i të hollave për financimin e aktivitetit të përgjithshëm huadhënës. Kredia do të paguhet me një pagesë në 10 vjetorin e datës së disbursimit. Interesi do të paguhet çdo gjashtë muaj. Bilanci me 31 Dhjetor, 2013 ishte 6,424 mijë EUR (Dhjetor 31, 2012: 6,424 mijë EUR). Garantues për këtë kredi është TEB Holding A.S.

(ii) Huaja 2 nga IFC

Përgjatë vitit 2013, TEB. sh.a. ka hyrë në marrëveshje kredie me IFC – International Finance Corporation (Korporata Financiare Ndërkombëtare) në shumë prej 4,500 mijë EUR. Qëllimi i kredisë ishte pajisja e bankës me kapital te rendit Tier 2 , dhe të mundësohet shfrytëzimi i të hollave për financimin e aktivitetit të përgjithshëm huadhënës. Kredia do të paguhet me një pagesë në 10 vjetorin e datës së disbursimit. Interesi do të paguhet çdo gjysëm vjetor. Bilanci me 31 Dhjetor, 2013 ishte 4,416 mijë EUR. Garantues për këtë kredi është TEB Holding A.S.

Fondet tjera te huazuara

(i) Huaja nga EBRD

Përgjatë vitit 2013, banka ka hyrë në marrëveshje huamarrëse me EBRD në shumë prej 2,500 mijë EUR. Qëllimi i kësaj huaje ishte financimi i kredive me qellim te kursimit te energjisë elektrike.

(ii) Huaja nga Demir-Halk Bank

Përgjatë vitit 2013, banka ka hyrë në marrëveshje huamarrëse me Demir-Halk Bank në shumë prej 3,000 mijë EUR. Qëllimi i kësaj huaje ishte rritja e likuiditetit te bankës gjate vitit 2013.

17. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar dhe i paguar i bankës me 31 Dhjetor, 2013 përbëhej nga 2,400 mijë aksione të zakonshme me PAR vlerë prej 10 EUR secili (2012: 2,300 mijë aksione ordinere)

Një përmbledhje e pronësisë së aksioneve të bankës është si në vijim:

Aksionari	Me 31 Dhjetor, 2013		Me 31 Dhjetor, 2012	
	Përqindja e pronësisë	Shuma	Përqindja e pronësisë	Shuma
TEB Holding A.S.	100%	24,000	100%	23,000
	<u>100%</u>	<u>24,000</u>	<u>100%</u>	<u>23,000</u>

Natyra e aksioneve është e zakonshme dhe nuk kanë të drejta, preferenca apo restriksione. Kapitali fillestar është paguar në para të gatshme.

18. TË HYRAT NGA INTERESI

	Për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor, 2013	Për vitin që përfundoi 31 Dhjetor, 2012
Të hyrat nga kreditë	30,504	24,920
Të hyrat nga bankat	33	60
Të hyrat nga pasuritë financiare të disponueshme për shitje	12	15
Gjithsej të hyrat nga interesi	<u>30,549</u>	<u>24,995</u>

Të hyrat nga interesi në vitin 2013 përfshijnë EUR 254 mijë (2012: 154 mijë) akruale në pasuritë e dëmtuara financiare.

19. SHPENZIMET PËR INTERES

Kapitali aksionar i autorizuar dhe i paguar i bankës me 31 Dhjetor, 2013 përbëhej nga 2,400 mijë aksione të zakonshme me PAR vlerë prej 10 EUR secili (2012: 2,300 mijë aksione ordinere)

Një përmbledhje e pronësisë së aksioneve të bankës është si në vijim:

	Për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor, 2013	Për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor, 2012
Interesi në depozitat me afat	7,441	5,354
Interesi në depozitat e kursimit	1,680	1,567
Interesi në huatë e marra	539	350
Gjithsej shpenzimet e interesit	9,660	7,271

20. TË HYRAT NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	Për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor, 2013	Për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor, 2012
Kredit Kartelat	3,128	2,550
Pagesat ndërkombëtare	877	812
